

KOMUNIKIMI POLITIK I BERISHES

Nga artikulli te ‘Bashkimi’ te fjalimi si President (1990-1992)

Alfred Lela

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të të detyrimeve të programit të doktoratës në Shkenca Sociale, me profil në Shkencat e komunikimit, për marrjen e gradës shkencore *Doktor*.

Udhëheqës shkencor: PhD/ Lorena Licenji

Numri i fjalëve: 53, 736

Tiranë, tetor 2016

DEKLARATA E AUTORESISE

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim është shkruar prej meje; nuk është paraqitur asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim; dhe, nuk është botuar asnjëherë, i plotë apo me pjesë. Punimi nuk përmban material të shkruar nga dikush tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara sipas rregullave të shkrimit akademik.

Alfred Lela

ABSTRAKT

Komunikimi politik i Sali Berishës, në një fazë që përbën kalimin e tij nga një intelektual kritik me regjimin komunist, në udhëheqës të Lëvizjes së Dhjetorit për rrëzimin e komunizmit, dhe deri te fjalimi i parë i tij si i pari President i Shqipërisë paskomuniste, përbën fokusin e këtij punimi.

Hulumtimet shkencore bëhen me anë të analizës së diskurit duke përdorur qasjen cilësore. Pyetja kërkimore merret me tehun ideologjik të komunikimit politik të Berishës, domethënë: a ka qenë i djathtë diskuri i tij?

Për të arritur në përfundime, së pari është kryer një vendosje e piketave kontekstuale: cila ishte fryma e kohës? Nga anonte komunikimi kombëtar dhe ndërkombëtar? Cilët ishin aktorët dhe faktorët e përfshirë në zhvillimet e kohës?

Së dyti, është hartuar një tabelë ideologjike e asaj se çfarë është e majtë dhe çfarë është e djathtë, dhe është trajtuar, me anë autorësh të njohur, përplasja e vjetër dhe e re mes kësaj dikotomie ideologjike. Studies të ideologjisë si Norberto Bobio, Robert Nisbet, Roger Scruton, Edmund Burke e të tjerë, kanë qenë ndër më prominentët në shpërfaqjen e kësaj analize dhe këtij identifikimi.

Për të shkuar përtej kontekstit të kohës dhe pikëprerjeve ideologjike, ose më saktë duke marrë kuptime prej tyre, punimi ka kaluar në fazën tjetër, më të rëndësishmen dhe thelbësoren, analizmin e asaj nëse është konteksti apo teksti që e luan rolin më të madh në komunikimin politik të një lideri.

Dy qasje janë përdorur në ndihmë të kësaj analize: *gjuha që interpreton* dhe *gjuha që ndërton* të studiuesve të analizës së diskurit James Paul Gee dhe Norman Fairclough. Të dy autorët i përkasin analizës së diskurit, por ndahen te ajo se gjuha që interpreton nuk bën gjë tjetër veçse fotografon apo interpreton kontekstin, ndërkohë që e kundërta

ndodh me gjuhën që ndërton. Kjo e fundit e mundëson, e ngre, e krijon kontekstin apo realitetin.

Në një kontekst politik të brendshëm, komunist apo të majtë, të siguruar nëpërmjet propagandës dhe terrorit, dhe një konteksti politik ndërkombëtar, ku antikomunizmi është fryma e kohës, çfarë bën Berisha nëpërmjet komunikimit politik?

Nëpërmjet skanimit të artikujve dhe fjalimeve të Sali Berishës në shtypin e kohës, që nga një analizë e hershme e shtatorit 1990 në gazetën ‘Bashkimi’, e deri te fjalimi i parë si President i Republikës, kemi pikasur dhe shfaqur gjurmë që identifikojnë një lider politik që përziën sa kontekstet, diskuret ashtu dhe ideologjitë.

ABSTRACT

Sali Berisha's political communication, in a period that consist of him transitioning from a critical intellectual during the communist regime, to the leader of December Movement that overthrew the regime, and then to his first speech as the first President of post-communist Albania, is the focus of this study.

The scientific research is done through discourse analysis, using the qualitative approach. The research question deals with the ideological axes of Berisha's political communication, more precisely: has his discourse been right wing?

First, to attain the conclusion, contextual milestones were set: what was the *Zeitgeist*? Which way the national and international communication were leaning? Who were the actors and factors involved in those times' developments?

Second, an ideological table of what is left wing and right wing was drafted, and, through well-known authors, the new and old clash between this ideological dichotomy was addressed. Foremost scholars on ideology such as Norberto Bobio, Robert Nisbet, Roger Scruton, and Edmund Burke, were scrutinized for the purpose of this analysis and identification.

To go beyond the context of time and ideological crossing-points, or, to be more precise, by taking meanings from them, the study has passed onto the next phase, the most important and the most essential: analyzing if the context or the text plays a bigger role in a leader's political communication.

For this, the analysis is based on two approaches: *the language that interprets and the language that builds*. The first one a theory elaborated by James Paul Gee and the second by Norman Fairclough. Both authors belong to discourse analysis, the difference being that language that interprets does nothing but photographs or interprets the

context, meanwhile the opposite occurs with the language that builds. The latter enables, builds and creates contexts and reality. In an internal, communist, or left wing, political context, secured through propaganda and terror, and an international political context, where anti-communism is the *Zeitgeist*, what does Berisha do through the political communication?

Per scanning of Sali Berisha's speeches and articles in the media of that time, from an early analysis published by the newspaper Bashkimi in 1990, to the first speech as President of Republic, we have noted and traced the traits that identify a political leader that mixes contexts, discourses and ideologies.

KUSHTESE

-Gilman Bakallit: mikut që nuk është më, por është... megjithatë.

-Të gjithë atyre nxënësve që nuk u bënë dot studentë: fëmijëve të familjeve të përndjekura nga regjimi komunist, por edhe gjithë atyre shqiptarëve të cilëve 'nuk u doli e drejta e studimit'. Mohimi i kësaj të drejte ka qenë pjesë e tragjedisë së tyre personale e familjare më së pari, por, padyshim, duhet parë edhe si dramë kombëtare.

FALENDERIME

E Henri Çilit ka qenë shtysa e parë, e përsëritur *in perpetuum*, që të filloja Doktoraturën.

Falemnderit atij dhe kolegëve të UET: Gilman Bakallit, Lorena Licenjit, Belina Budinit,

Irena Myzqearit. Mark Markut, falemnderit për mbështetjen, me këshilla dhe literaturë.

Ina, *my best friend*, më ka ndihmuar, si përherë dhe me gjithçka. Miku im amerikano-

shqiptar, Mark Kozmo, më ka dhënë një dorë të çmuar me anglishtëzimin e artikujve

dhe konferencave që më janë dashur të paraqes për përmbushjen e kriterëve të

doktoraturës. Edi dhe Suzannah, më kanë siguruar një strehë të ngrohtë e dashuri, në

shtëpinë e tyre në Boston, ku kam shkruar një pjesë të punimit.

Të gjithëve u jam mirënjohës!

ABSTRAKTI

KUSHTESA

FALENDERIME

Përmbajtja e Lëndës

Kapitulli I Hyrja

1.1 Objekti i studimit: Komunikimi politik i Sali Berishës.....	5
1.2 Problematikat e përgjithshme e punimit.....	7
1.3 Hipotezat e ngritura.....	8
1.4 Metodologjia e punimit: Qasjet empirike dhe teorike.....	9
1.5 Kufizimet metodologjike dhe vështirësitë e hasura.....	10
1.6 Struktura e punimit.....	13

Kapitulli II Analizë dhe kritikë e literaturës

2.1 Teoria e ‘gjuhës që ndërton’	15
2.1.1 Mjetet kërkimore.....	17
2.1.2 Diskuret: çfarë-t dhe kush-ët.....	18
2.2 Teoria e ‘gjuhës që interpreton’	18
2.2.1 Agjentët dhe ngjarjet sociale: individi dhe struktura.....	21
2.3 Retorika, efekti estetik dhe ideologjik.....	24
2.3.1 Sa retorika kemi?.....	26
2.3.2 Rregullat e retorikës.....	28
2.3.3 Konteksti retorik.....	32
2.3.4 Si bëhet analiza retorike.....	33

2.4. 5 Akte të fjalës.....	36
----------------------------	----

Kapitulli III Konteksti Historik dhe një vështrim Postum i

Tranzicionit

3.1 Hyrje.....	38
3.2 Konteksti global: Washington-i, Moska dhe Vatikan-i si termostat i ndryshimi.....	41
3.3 Dekada e Thatcher-it.....	43
3.4 Perëndimi tjetër.....	44
3.5 Lindja komuniste në fund të eksperimentit.....	44
3.6 Shqipëria: një revolucion pa autorë?.....	48
3.6.1 Komunistët e moderuar të së majtës dhe të së djathtës.....	52
3.6.2 Kujtimet si rinivelime të tranzicionit.....	52
3.6.3 Katovica, konspiracioni në vend të teorive.....	56
3.6.4 Tirania e anti-intelektualizmit.....	58
3.7 Autoritarizmi vazhdon.....	62
3.7.1 Tranzicioni si kronikë.....	69
3.8 Përfundime I: Demokratizimi i Huntington: a është Shqipëria e përputhshme me të?.....	77
3.8.1 Përfundime II: Rrezik i majtë apo i djathtë?.....	87

Kapitulli IV Analizë Empirike

(Ku dallon e majta nga e djathta: Shqyrtime)

4.1 Dallesa sipas Bobbio.....	93
4.3 Fundi i historisë’, por jo i diadës.....	102
4.3.1 Kriteret dalluese.....	104

4.3.2 Kritere të tjera.....	106
4.4 Barazia dhe liria si kriter themeltar.....	109
4.5 Impulsi konservator.....	111
4.6 Prona: ngulitur në të drejtën romake.....	113
4.7 Tradita: të djathtëve u pëlqen të jetojnë në të shkuarën?.....	115
4.8 Autoriteti: i kodeve shoqërore, jo tirania e shtetit	116
4.9 Feja: rreziku i një kishe nacionaliste.....	118
4.10 Roger Scruton dhe tre ligjet e politikës.....	119

Kapitulli V

5.1 Vështrim mbi katër ‘gjuhët’ e Berishës.....	123
5.2 Artikulli që paraqet Berishën si <i>political personae</i>	125
5.3 Fjalorët e Berishës intelektual.....	134
5.4 Vështrim krahasues: diskuri i një ‘disidenti’ dhe një Presidenti.....	141
5.5 Fjalorët e Berishës politikan.....	147
5.6 Analizë ideologjike e diskurit të programit të një partie të qendrës së djathtë.....	150
5.7 Berisha i krahasuar: teksti dhe konteksti.....	154
5.8 Analizë e diskurit ideologjik të programit të një partie të djathtë.....	160

Kapitulli VI

6.1 Çfarë ndërton Berisha me anë të gjuhës (7 <i>detyrat ndërtuese</i> të James Paul Gee)	181
6.2 Çfarë interpreton Berisha me anë të gjuhëve që flet (konteksti i Fairclough).....	184

6.3 Berisha vs Zogu: rasti i ideologjisë që ndërton gjuhën.....	185
6.4 Në gjurmët e Berishës retorik.....	188
PERFUNDIME.....	192

Gjuha është njëfarë gjurmëgishti ideologjik e cila-nëse dijmë ta interpretojmë-zbulon autorin e vet edhe kur ai mundohet ta fshehë. Prandaj na duhet të hulumtojmë te retorika dhe jo përtej saj. –Richard Toye

KAPITULLI I

KOMUNIKIMI POLITIK I SALI BERISHËS

1. 1 Objekti i studimit

Sali Berisha ka qenë një prej protagonistëve, me gjasë më përcaktuesi, të politikës shqiptare të pas-komunizmit. Ai ishte, me radhë, një prej intelektualëve të parë shqiptarë që u artikulua për hapjen e vendit; një prej përkrahësve fillimisht, dhe më pas pjesëmarrësve të Lëvizjes së Dhjetorit; një prej themeluesve të partisë së parë opozitare, asaj Demokratike- shumë shpejt kryetar i saj; dhe më vonë President i vendit në periudhën 1992-1997; lider i opozitës në vitet 1997-2005; Kryeministër i Shqipërisë 2005-2013; dhe, prej vitit 2013 e në vazhdim deputet i PD dhe i konsideruar, me të drejtë, lider historik i kësaj force.

Ky dominim i skenës nga Berisha, afërmendsh është kryer edhe me anë të komunikimit, më saktë të atij që mund të konsiderohet si *politik*. Me komunikim politik në këtë punim do të kemi parasysh të gjitha aktet, verbale ose jo, që kanë si qëllim jo vetëm shprehjen e një qëndrimi apo ideje, por edhe përpunimin e një opinionit, që këtu do ta quajmë *opinion publik*, por në një kuptim më të ngushtë, të një, le të themi *instrumentalizimi politik*, do ta konsiderojmë si *elektorat*. Në kuptimin që komunikimi i kryer me këtë masë ose audiencë bëhet për qëllime politike, dhe jo si komunikim në vetvete.

Ky lloj komunikimi, i bartur nga politikani Sali Berisha, është edhe objekti i këtij studimi. Dy gjëra mund të thuhet për Berishën: ai është ose i anatemuar ose i adhuruar, dhe ndoshta në të njëjtën masë, si anatema ashtu dhe adhurimi kanë prodhuar

keqkuptime të mëdha në lidhje me figurën e tij. Konsideroni këtë: Nga një kërkim mekanik në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, por edhe burime të tjera të botimeve apo bibliografisë, rezulton se librat që trajtojnë subjektin Sali Berisha janë ose të natyrës së parë, anatemës, ose të së dytës, adhurimit¹.

Ka edhe një mori tekstesh të tjera, pjesa më e mirë e të cilëve do të shyrtohen në këtë punim, të cilët, edhe pse nuk janë shkruar posaçërisht për Berishën, e kanë, në mos si personazh të paktën si përvijim. Asnjëri prej këtyre librave, megjithatë, nuk është i strukturuar dhe as i ka pretendimet e një punimi shkencor: tekstet janë kryesisht të zhanrit të publicistikës apo memuaristikës. Përjashtim këtu bën libri i Elez Biberajt “Shqipëria në tranzicion”, i cili është një vështrim historik, por mund të konsiderohet studim i qasjes metodologjike descriptive (përshkruese).

Të natyrës polemike, anatemuese apo laudatore, janë edhe tekstet e botuara në gazeta, qofshin kronika, artikuj, komente, analiza, reportazhe e të tjera. Lënda e nxjerrë nga shtypi periodik do të jetë pjesë e hulumtimeve për komunikimin politik të Berishës. Ajo që ka munguar megjithatë është një vështrim kritik dhe analitik i komunikimit. Kritik, jo në kuptimin e të marrit të pozicionit të kritizerit për qëllime politike, kulturore,

¹ Fahri Balliu: *Berisha përmes Kasandrave*, (1996), Ombra GVG, Tiranë.

Hysamedin Feraj: *Pamundësia e kozmopolitizmit shqiptar: nën shembullin Nano-Berisha*

Musa Tartari: *Berisha, prijësi popullor*, (2000) "Pelioni", Tiranë.

Nikollë Lesi: *Si i njoha Nanon dhe Berishën*, (2005), Gjergj Fishta, Tiranë.

Ramiz Lushaj: *Me Sali Berishën një epokë e re. Vlerësime, vështrime, ravijëzime*, (2009), "Emal" Tiranë.

Petro Dhimitri: *Verdikti i popullit--Me Berishën drejt Evropës! 1996 Shtëpia Botuese Marin Barleti*, Tiranë.

Mujë Buçpapaj: *Partia Demokratike dhe çështja kombëtare*, (1999), Shtëpia Botuese "Koha" Tiranë.

Ylli Polovina: *Nano dhe Berisha*, (1996) Shtëpia Botuese "Progresi" Tiranë.

Leka Borshi: *Berisha nuk ka gabuar, shmangie nuk do të thotë gabim*, (1999).

Petro Dhimitri: *Kundër komunizmit, "Jo" edhe Berishës! (1995) Shtëpia botuese "Monroe", New Jersey.*

shoqërore e të tjera, por një vështrim i krahasuar duke interpretuar *diskurin e Berishës* me anë instrumentesh të analizës së ligjërit.

Kjo mungesë, apo këto mungesa-jo të gjitha por një pjesë- janë edhe pretendimi i këtij punimi. Sigurisht, studimi nuk e organizon veten rreth kësaj mungese: me fjalë të tjera nuk është mbushja e këtij hendeku qëllimi shkencor, social apo kritik i tij.

1.2 Kriteret e punimit

Kriteret janë disa dhe më poshtë vijojnë më të rëndësishmit:

Kriteri i rëndësisë së objektit të studimit: Gjykojmë se studimi i komunikimi politik të Sali Berishës hedh dritë mbi një pjesë të madhe të prirjeve të komunikimit politik në Shqipëri përgjatë tranzicionit. Berisha është, në njëfarë mënyre, *monada*, njësia bazë e këtij komunikimi.

Kriteri historik: Duke qenë se periudha e studiuar këtu, 1900-1992, përbën fillesat e një historie të re për Shqipërinë, asaj që njihet si *tranzicioni*, punimi do të piketojë edhe atë *gjuhë të kalimit* që është përdorur gjatë kësaj kohe. Në rrafsh historik kjo do të thotë, një lidhje mes kontekstit kohor dhe social dhe asaj që mund të quhet *lingua franca* e saj.

Kriteri ideologjik: Duke qenë se analiza e diskurit të Berishës do të shtrihet edhe brenda një rrezeje ideologjike- a ka qenë i djathtë ky komunikim?- kjo përbën edhe një implikim ideologjik të punimit. Gjurmët ideologjike janë interesante, sidomos gjykuar edhe njëherë nga konteksti: një Shqipëri që ka dalë nga një diktaturë dhe ideologji komuniste totalitare, pra e ekstremit të majtë.

1. 3 Hipoteza: argumentet kryesore

Argumeni kryesor i punimit, mbështetur si te konteksti, periudha 1990-1992, ashtu dhe te teksti, i shkruar ose i folur, parashtrohet pretendimin se Berisha ka qenë zotërues në diskurin politik të periudhës së shqyrtuar. Duke pasë thënë këtë, duhet theksuar se pjesë e këtij argumentimi është edhe fakti se ai, jo vetëm është përcaktuar nga konteksti, por edhe e ka përkufizuar atë. Jemi në situatën e një ndikimi miks (*mixed influences*): aq sa rrethanat ndikojnë ligjëruesin, po ashtu ndodh e kundërta.

Pyetja themelore kërkimore që shtrojmë në këtë punim është: *A ka qenë i djathtë komunikimi politik i Sali Berishës në periudhën 1990-1992?*

Teza kryesore, e cila është në të njëjtën kohë përgjigje e pyetjes kërkimore të këtij studimi, është:

A. *Sali Berisha ka komunikuar politikisht i zotëruar kryesisht nga variablat e Lirisë, Kombit, Zotit dhe, Familjes. Në këtë rrafsh, atë të vlerave të larta, neutrale, përgjithësuese, ai është një komunikues që i përgjigjet spektrit ideologjik të djathtë ose konservator. Por, pyetja mbetet e papërligjur krejtësisht me një përgjigje, nëse nuk konsiderojmë edhe vlerat akute të komunikimit politik të Berishës, si për shembull referencat politiko-historike të tij (Noli, Zogu etj), problemi i pronës; së djathtës tradicionale shqiptare, e të tjera. Në kësi rastesh *Berisha anon majtas*. Si rrjedhojë, mund të konkludohet se ka një ambiguitet, apo çka që do të përkufizojmë në vazhde të këtij studimi si *ideologji e përzier* (mixed ideology).*

Hipoteza e artikuluar më lart do të ishte e pambështetur nëse nuk do të trajtonte apo merrte parasysh edhe bazamentin social, politik e historik që e mundëson atë. Prej këtejt rrjedhin dy hipoteza të tjera ose nënteza:

B. Komunikimi politik i Berishës përcaktohet nga **konteksti** që do të thotë janë rrethanat që e përcaktojnë tekstin dhe verbin e tij.

C. Komunikimi i politikanit Berisha, gjithashtu, përkufizohet nga individi Berisha, që do të thotë nga prejardhja, mbrujtja e tij në familje, krahinë, leximet, edukimi e rrethana të tjera sociale.

1.4 Metodologjia e punimit: Qasjet empirike dhe teorike

Studimi mbështetet në qasje të ndërthuruara (kombinuara) metodologjike ku bëhen bashkë analiza e tekstit dhe e kontekstit (rrafshi kohor dhe rrethanor ku janë shtrirë ngjarjet).

Fillimisht synohet konstrukti shoqëror e politik i kohës dhe rrethanave në të cilin ka vepruar subjekti i studimit, pra konteksti;

Më pas analizohet teksti i folur ose i shkruar duke kryqëzur të dhënat empirike me ato teorike.

Drejtimi i parë, realizohet kryesisht përmes qasjes metodologjike përshkruese (descriptive) duke sjellë një kronikë të detajuar të autorëve të ndryshëm, një gërshetim i protagonistëve të ngjarjeve me dëshmitarët e tyre. Kjo bëhet për të vendosur në sfond të aktivitetit të subjektit të studimit relievin e ngjarjeve dhe të përthyerjeve kombëtare e ndërkombëtare, politike e shoqërore, kulturore e antropologjike. Pa to interpretimi i diskurit apo një analizë e tekstit do të ishte një qëllim në vetvete dhe do të ngjante më shumë me një ekskursion estetik narrativ.

Drejtimi i dytë lidhet drejtpërdrejt me atë që quhet *analizë teksti* dhe bën një ‘zbritje’ në narrativë duke parë imtësisht gjuhën, figuracionet, diskurin dhe metadiksurin, apo atë

që quhet *retorikë*, dhe ku ajo ndërtohet me qëllim joshjeje, apo rrjedh prej bindjes. Analiza e tekstit mbështetet në rrymat e ndryshme të shkollave të retorikës, aty ku qëllimi është figuracioni apo shkallëzimi i përdorur për të synuar kodimin e mesazhit, apo në rastin kur kërkohet formulimi i një fjalori të së djathtës, apo të së majtës, te kategorizmi apo ndarja ideologjike që autorë të ndryshëm i kanë bërë këtyre dy dikotomive.

Instrumentet e përdorur për të arritur te analiza e objektit të studimit janë dy:

a. Grumbullimi, hulumtimi dhe përzgjedhja e intervistave, fjalimeve, konferencave për shtyp dhe artikujve të shkruar nga Sali Berisha gjatë periudhës të marë në shqyrtim në këtë punim. Për këtë është shfrytëzuar arkiva e Bibliotekës Kombëtare në zërat e shtypit periodik, duke marrë parasysh këtu gazetatat më të njohura të kohës si Drita, Zëri i Rinisë, Bashkimi, Rilindja Demokratike, Zëri i Popullit, Tribuna Demokratike apo Republika.

Të rëndësishëm për kërkimin janë edhe librat e autorëve të ndryshëm, shqiptarë ose të huaj, që flasin për këtë periudhë kohore. Sa u takon autorëve shqiptarë, kriteri kryesor ka qenë përfshirja e tyre, e drejtpërdrejtë ose si dëshmitarë, në ngjarjet që shenjuan ndërrimin e sistemeve politike. Për autorët e huaj është përdorur kriteri i autoritetit.

b. Analiza cilësore e teksteve, duke synuar një dekodim të formacioneve gjuhësore apo ideologjike, në funksion të ndërtimit të një *identikiti të diskutit*.

Të rëndësishme në këtë aspekt janë fjalët kyçe, strukturat e ligjërit, figuracionet e gjuhës, fjalët e reja, diskuri teknik, shkencor, politik, religjioz, krahinor etj., i cili ndihmon në ndërtimin e një profili politik e shoqëror, gjë që e bën më të kuptueshëm dhe më pak abstrakt vetë ligjërimin, duke qartësuar objektin e studimit.

1.5 Kufizimet metodologjike dhe vështirësitë e hasura gjatë kërkimit

Studimi i komunikimit politik të një lideri paskomunist, në pamje të parë duket një gjë e lehtë. Kjo për faktin se aksesimi publik ka qenë më i lehtë dhe mjetet e informimit publik pas rënies së komunizmit kanë qenë më të shumta.

Vështirësia e parë, megjithatë, lidhet me pyetjen kërkimore, e cila rreket të hulumtojë mbi baza ideologjike dhe për më shumë në të djathtë të spektrit. Duhet kujtuar se Shqipëria në periudhën 1990-1992, objekt i këtij studimi, po dilte e shfityruar nga një diktaturë e majtë e tipit stalinist. Historia e së djathtës tradicionale, jo vetëm ishte ‘zhdukur’, me anë vrasjesh ose ekzili të eksponentëve; me anë të manipulimit të historisë, por edhe me anë të ‘turpërimit’ dhe fshirjes së çdo gjurme të saj në mjetet e propagandës së regjimit, shtypin periodik, filmat e Kinostudios, tekstet akademike apo letrare, e me radhë.

Një nocion i së djathtës në këtë periudhë ishte *tabula rasa*. Kjo mungesë është transferuar drejtpërdrejt edhe në literaturën e 20 viteve që pasuan dhe që njihen si *periudha e tranzicionit*. Ka pak literaturë për të djathtën shqiptare, nuk ka monografi apo tekste të tjera për figura të së djathtës, përjashto Mbretin Zog. Tekste për eksponentë të së djathtës, edhe kur ekzistojnë janë kryesisht përshkrime, ose të *viktimizimit* ose të kundërvënies: dmth synojnë të profilizojnë dikë nëpërmjet një kontrasti moral të llojit *e mira/e keqja*.

Në revistat e viteve '30 gjen skajime të ideologjisë së djathtë, por një pjesë tyre janë ura simpatie për fashizmin.

Studimit i mbetet të bazohet te literatura e huaj, e cila në mënyrë universale jep dallimet mes së djathtës e së majtës. Duke qenë se jemi në lëmin e shkencave shoqërore, dallesat nga një vend në tjetrin nuk mund të rrafshohen nga një ligj universal. Kjo, sigurisht,

prodhon shkëputje (ruptures) edhe në komunikim, aty ku ky studim synon të hulumtojë për gjurmë të së djathtës (ose të së kundërtës së saj).

Një vështirësi e dytë ka të bëjë me mungesën e studimeve apo botimeve të ngjashme. Përveç një studimi të Belina Budinit (2009) për një politikan të së majtës, mungojnë interpretime të tjera të komunikimit politik. Shkolla shqiptare e studimit është lindore, në kuptimin se interesohet për tema të mëdha universale që rreken të hulumtojnë ‘internetin’, ‘integrimin’, ‘historinë’, ‘ndërkulturoren’, e me radhë. Janë ato që Antonio Gramshi i quante ‘ravgime mbi natyrën e gjithësisë’.

Vështirësia e tretë qëndron tek fokusimi kohor, pra periudha e shkurtër e marrë në analizë nga ky studim. Edhe pse Eco (2006:f.29) poroset se sa më shumë të kufizohet shtrirja e temës, aq më mirë punohet, dhe aq më shumë rritet saktësia, shpesh kjo sjell pengesa, edhe për shkak të vështirësive të përmendura më lart. Por, edhe për arsye se komunikimi politik i asaj kohe bëhej nëpërmjet mjetesh të kursyera të informimit. Gazeta e Partisë Demokratike, që duhej të ishte tribuna e komunikimit të Berishës, nuk ishte e përditëshme; gazeta më e madhe në vend Zëri i Popullit i takonte kundërshtarit ideologjik (në mos armikut); ndërsa Televizioni shtetëror, ende me orare të kufizuara transmetimi, vazhdonte të ishte zëdhënës i propagandës zyrtare, lexo komunistëve në pushtet.

Një vështirësi e katërt lidhet me studimin e një personazhi aktiv politik dhe me paragjykimet, pozitive apo negative, të ndikuara edhe nga pikëpamjet e autorit të këtij studimi. Luhatja para një droje se instrumentet e kërkimit dhe vetë pyetja e zgjedhur do të hedhin dritë të panevojshme apo negative mbi objektin e studimit (që është komunikimi politik i një subjekti politik në këtë rast, Sali Berisha). Me fjalë të tjera, devijimi i shkencës, pandërgjegjshëm, për qëllime ose trusni të aktualitetit.

1.6 Struktura e studimit

Kapitulli I merret me parashtrimin e objektit të studimit dhe me kriteret e rëndësisë së objektit të studimit. Për të kaluar më tej te hipoteza dhe argumentet kryesore. Më pas vijohet me metodologjinë e punimit dhe cilat janë, në funksion të saj, qasjet empirike dhe teorike. Pjesë e Kapitullit I janë edhe kufizimet metodologjike dhe vështirësitë e hasura gjatë kërkimit, të cilat pasohen nga struktura e studimit.

Pak a shumë, ky kapitull përbën kolonat bashkë me themelet e asaj që mund të quhet *shtëpia e studimit*.

Kapitulli II ndërtohet mbi një analizë dhe kritikë të literaturës së përzgjedhur për të ngritur shtratin teorik ku do të mbivendosen, përgjatë kapitujve përmbyllës, si gjetjet empirike ashtu dhe Përfundimet. Këtu përcaktohen autorët dhe teoritë përkatëse që do të përvijojnë një fill teorik për pjesën tjetër të studimit.

Kapitulli III merret me kontekstin historik: cila ishin zhvillimet në Shqipëri, Europën Lindore dhe në vendet që konsiderohen si Fuqi të Mëdha, domethënë përkufizuese të ‘tektonikave’ politike botërore. Ky kapitull, në gjykimin tonë, është i nevojshëm në mos i domosdoshëm, edhe se konturet që dalin aty ‘vërtetojnë’ ose ‘hedhin poshtë’ tezën apo teorinë se, konteksti e përcakton komunikimin, dhe jo individi.

Kapitulli IV bën përvijimin e ideologjisë së djathtë dhe të majtë duke përdorur instrumentin e krahasimit të të dyjave, duke siguruar kështu një kufi mes tyre, por njëkohësisht, edhe kufizimet e njërës dhe tjetrës, apo qoftë edhe faktin e mbivendosjes së tyre, apo përzierjes. Për të hetuar natyrën e dikotomisë është marrë në shqyrtim një autor ‘klasik’ i dallesës, Norberto Bobbio; veç të tjerash edhe për faktin se libri është

botuar në vitin 1993, kohë që përkon me zhvillimet dhe komunikimin politik që angazhon studimin tonë. Duke qenë se hulumtimi ka në qendër identifikimin e shenjave të djathta në komunikim (ose mungesën e tyre), janë thirrur në ndihmë, me literaturë mbështetëse dhe përkufizuese, dy studiues të së djathtës: Robert Nisbet me ‘Konservatorizmi’ dhe Roger Scruton me ‘Si të jesh i djathtë’.

Kapitulli V ‘përplas’ analizën teorike me gjetjet empirike, vë përballë shtratin teorik me diskurin e përgjithshëm, apo gjuhën individuale, duke gjetur shenja që do të përbëjnë më pas bazën e Përfundimeve. Në këtë kapitull, përveç një hulumtimi cilësor bëhen edhe gjetje sasiore, duke krahasuar disa ‘fjalorë’ të Berishës nxjerrë nga artikulli i tij debutues në periodikun ‘Bashkimi’, i cili e paraqet atë si *political personae*.

Kapitulli VI i cili përmbyll këtë studim bën një analizë diskuri dhe retorike duke u mbështetur te *teoria e gjuhës që ndërton* e James Paul Gee, dhe te studiues të njohur të retorikës, që nga Aristoteli e këtej.

Përfundimet janë edhe përmbyllja e këtij studimi.

KAPITULLI II

ANALIZË DHE KRITIKË E LITERATURËS

2.1 Teoria e gjuhës që ndërton

Njëra prej degëve të analizës së diskurit, e quajtur *përshkruese*, përkufizon si qëllim kryesor të vetin përshkrimin e asaj se si gjuha funksionon: sipas kësaj qasjeje nga vetë funksioni i gjuhës nxirret edhe kuptimi i saj. Përqasja *kritike* e analizës së diskurit i sheh gjërat nga një kënd i ndryshëm. Duke tejkaluar synimin e funksionit të gjuhës, apo dhe të shpjegimeve të përimita, kjo qasje ka dëshirën e të folurit dhe të ndërhyrjes, pjesëmarrjes në çështjet sociale apo politike. Ky është, pak a shumë, përkufizimi i ofruar prej studiuesve, i kësaj metode.

Një prej tyre, James Paul Gee, mbron mendimin se gjuha ka kuptim vetëm *në* e *përmes* praktikave sociale, dhe se me anë të gjuhës ne *ndërtojmë gjëra*. Me anë të shkrimit dhe të folmes, sipas Gee (2010: 17), ne gjithmonë konceptojmë ose ndërtojmë shtatë gjëra ose zona të ‘realitetit’. Ai i emërton “shtatë detyra ndërtuese” të gjuhës të cilat janë:

1. Domethënia

Ka gjëra në jetë, që janë pranuar, nga thujtja e gjithë, si domethënëse; për shembull lindja ose vdekja e një fëmijë. Për gjëra të tjera, na duhet të përdorim gjuhën për t’i bërë domethënëse ose për ta ulur shkallën e kuptimit të tyre, të sinjalizojmë të tjerët se si e shohim domethënien e tyre.

2. Praktikë (Veprimtaritë)

Me praktikë, Gee ka parasysh një sjellje shoqërisht të njohur ose institucionalisht dhe kulturalisht të mbështetur, që përfshin veprime sekuenciale ose të kombinura në mënyra të caktuara. Gjërat që bëjmë në jetë janë, zakonisht, aktivitete, si për shembull të mësuarit e një gjuhe etj.

3. Identitete

Këtu kemi të bëjmë me përdorimin e gjuhës si mjet njohës kur marrim përsipër një rol, apo i mveshim vetes një identitet. Shpesh ne ndërtojmë identitete për të tjerët, sepse kështu ndërtojmë një identitet për veten. Dallimet krahinore që theksojmë me anë të gjuhës janë identitete të tilla.

4. Marrdhënie

Gjuha përdoret edhe për të sinjalizuar llojin e marrdhënies që kemi, duam të kemi, po përpiqemi të kemi me dëgjuesit, lexuesit apo njerëz të tjerë, grupe apo institucione rreth të cilave ne po komunikojmë. Ne e përdorim gjuhën për të ndërtuar marrdhënie shoqërore.

5. Politika (shpërndarja e të mirave sociale)

Ne e përdorim gjuhën për të përcjellë një këndvështrim mbi natyrën e shpërndarjes së të mirave sociale, që do të thotë, ndërtimin e një perspektive mbi të mirat sociale.

6. Lidhje

Ne e përdorim gjuhën për t'i bërë gjëra të caktuara relevante ose jo me gjëra të tjera, që do të thotë për të ndërtuar lidhje relevance (rëndësie).

7. Sisteme Shenjash dhe Dijesh

Ka shumë gjuhë të ndryshme, si rusisht, anglisht, italisht etj. Ka shumë varietete të ndryshme të çdo gjuhe: gjuha e juristëve, e biologëve, e artistëve etj. Ka gjithashtu *detyra ndërtuese* (building tasks) që nuk janë gjuhë, si ekuacionet, grafikët, imazhet etj. Këto të gjitha janë sisteme të ndryshme shenjash.

2.1.1 Mjetet kërkimore

Për të mundësuar një analizë të funksionimit të këtyre *detyrave ndërtuese* (building tasks), James Paul Gee thekson nevojën për *mjete* dhe gjithashtu identifikimin e këtyre mjeteve. Ai qartëson se përdorimi i këtyre *mjeteve kërkimore* (tools of inquiry) kryesisht bëhet për të kuptuar se si njerëzit ndërtojnë *identitete* dhe *praktika* dhe, në të njëjtën kohë se si ata njohin ose pranojnë identitete dhe praktika që të tjerët ndërtojnë rreth tyre. Mjetet kërkimore, përveç identiteteve, mund të përdoren edhe për detyra të tjera ndërtuese.

Me mjete kërkimore do të kemi parasysh:

a-*gjuhët shoqërore*. Njerëzit përdorin stile apo varietete të ndryshme të gjuhës për të ngritur dhe njohur identitete të ndryshme në rrethana të ndryshme; ata gjithashtu përdorin varietete të ndryshme të gjuhës për t'u përfshirë në të gjitha *detyrat ndërtuese*. Këto varietete Gee i quan *gjuhë sociale* (shoqërore). Për shembull vernakularja dhe teknikja janë dy gjuhë të ndryshme shoqërore².

b) *Diskuret*. Njerëzit ndërtojnë identitete dhe aktivitete (veprimtari), jo vetëm përmes gjuhës, por duke përdorur gjuhën bashkë me 'gjëra' të tjera jo gjuhësore.

² *Mjetet e kërkimit* janë kryesisht përkthime të tekstit të James Paul Gee dhe vetëm ndonjë ndërhyrje e vogël është e imja. Kjo, për të mos cënuar përkufizimet.

c) *Bashkëbisedimet*. Ndonjëherë, kur flasim apo shkruajmë, fjalët tona jo vetëm sugjerojnë apo lidhen me fjalët e dikujt tjetër, por ato sugjerojnë dhe lidhen me tema, debate apo motive që kanë qenë fokusi i shumë bisedave dhe shkrimeve në një grup të caktuar me të cilin ne jemi familjarë, apo me shoqërinë në tërësi. Këto tema, debate, apo motive luajnë një rol në atë se si gjuha interpretohet.

d) *Intertekstualiteti*. Kur flasim apo shkruajmë, fjalët tona shpesh sugjerojnë ose lidhen, në njëfarë mënyre, me ‘tekste’ të tjera apo tipa të caktuar ‘tekstesh’, dhe me tekst kam parasysh fjalë që njerëz të tjerë kanë thënë ose shkruar.

2.1.2 Diskuret: Çfarë-t dhe kush-ët

Për të kuptuar diskuret, Gee paraqet si të vlefshme një ‘teknikë’ të dy studiuesve të tjerë, Eieder dhe Prat, sipas të cilëve një shprehje ka kuptim vetëm nëse komunikon një *kush* dhe një *çfarë*. Ajo që Gee thotë se kupton me ‘kush’ është një identitet shoqërisht i pozicionuar, pra ai “lloj personi” që kërkon të jetë dhe të ngrihet këtu dhe tani. Ndërsa kuptimi që ai i jep ‘çfarë’ është një praktikë shoqërisht e pozicionuar të cilën shprehja (utterance) vetë e ndihmon që të ndërtohet.

Përfundimisht, ne mund të theksojmë se kush-ët dhe çfarë-ët nuk janë në të vërtetë të ndarë dhe të ndashëm. Ti je ai që je pjesërisht përmes asaj që po bën dhe, ajo çfarë je duke bërë, pjesërisht, njihet për atë që është nga kush po e bën atë. Kështuqë, është më mirë, në fakt, të thuash se shprehjet komunikojnë një kush-bën-çfarë të integruar, e megjithatë shpesh të shumëfishtë ose heteroglosik (Gee, 2010: 30).

2.2 Teoria e gjuhës që Interpreton

Analiza e diskurit bëhet në shumë mënyra. Ndarja më e madhe është mes qasjeve që bëjnë një analizë të detajuar të tekstit, dhe qasjeve që nuk e bëjnë këtë gjë. Për të bërë

një dallim, Norman Fairclough (2003) përdor termin ‘analizë diskuri e orientuar kah teksti’ (textually oriented discourse analysis).

Fairclough është munduar të tejkalojë një ndarje mes teorive sociale që priren të mos i analizojnë tekstet, dhe studimeve që fokusohen te gjuha e teksteve, por nuk përfshihen në çështjet e teorive sociale. Me një fjalë, të kontekstit. Fairclough i konsideron të paplota studimet e diskurit të cilat nuk marrin parasysh kontekstin social që ndodh ndërkohë që njerëzit shkruajnë apo flasin. Ai i mëshon gjithashtu idesë se, analiza e tekstit nuk është vetëm analizë gjuhësore; ajo përfshin edhe atë që ai quan ‘analizë ndërdiskurisë’, që do të thotë hulumtimi i teksteve në terma të diskureve, zhanreve dhe stileve mbi të cilat mbështeten dhe artikulojnë.

Tekstet kanë efekte shoqërore:

Tekstet, si element i ngjarjeve shoqërore, kanë efekte shkakësore-do të thotë ato sjellin ndryshime. Më së pari, tekstet mund të sjellin ndryshime në njohuritë tona (ne mësojmë gjëra prej tyre), besimet, qëndrimet, vlerat, e me radhë. Ata kanë gjithashtu efekte shkakësore afatgjata-dikush mund të argumentojë, për shembull, se eksperiencia e gjatë e reklamës dhe teksteve të tjera komerciale, kontribuon në formësimin e identiteteve të njerëzve si ‘konsumatorë’, ose në ndryshimet në marrdhëniet industriale, e me radhë. Efektet e tyre mund të përfshijnë ndryshime në botën materiale, si psh në dizajnin urban, apo arkitekturë, dhe dizajnimin e llojeve të ndryshme të ndërtesave (Fairclough, 2003: 9).

Fairclough, studiues me bindje të majta, i mëshon lidhjeve shkakësore tekst-shoqëri, edhe për të provuar ndryshimet e sjella nga gjuha në atë që ai quan ‘kapitalizmi i ri’, dhe që përbën një prej fashave të forta të studimeve të tij. Megjithatë, shkencat shoqërore bashkëkohore kanë qenë dhe janë nën ndikimin e madh të paradigmes se bota sociale është shoqërisht e ndërtuar: këto teza kanë marrë emrin *konstruktivizmi social*. Teori brenda kësaj paradigme i mëshojnë rolit të fortë të teksteve, pra gjuhës dhe diskurit, në sendërtimin e shoqërisë.

Mendimi i Fairclough është se këto teori janë më shumë idealiste se realiste. Kjo sepse, edhe nëse elementë të botës sociale, të tillë si institucionet shoqërore, vëren ai, janë të konstruktura shoqërisht, pasi ky proces përfundon, ato kthehen në realitete të cilat e afektojnë dhe kufizojnë ndërtimin tekstual të shoqërisë.

Pasi bën këtë dallim, Fairclough jep një term të ri, **interpretimin**, të cilin duhet ta ndajmë nga **ndërtimi**, gjë që konstruktivistët shoqërorë nuk e bëjnë. Me anë të tekstit ne mund të interpretojmë (shenjojmë, imagjinojmë etj) botën shoqërore në mënyra të ndryshme, por nëse shenjimet apo interpretimet tona kanë *efektin e ndryshimit* të saj, kjo varet nga faktorë të ndryshëm kontekstualë-përfshirë mënyrën në të cilën është ndërkohë realiteti shoqëror, kush e interpreton atë, e me radhë (po aty: 10).

Një efekt shkakësor, që na intereson edhe ne për qëllimet e këtij studimi, është ai ideologjik. Bëhet fjalë për efektin e teksteve në ngulitjen, mbështetjen apo ndryshimin e ideologjive, një shkakësi e studiuar nga Eagleton dhe van Dijk, ndërmjet të tjerësh. Ka dy qëndrime ndaj ideologjive, vëren Fairclough, dhe ato janë *kritike* dhe *përshkruese*. E para e sheh ideologjinë si një modalitet të pushtetit, ndërsa e dyta si pozicionim, qëndrim, besim, perspektivë etj., të grupimeve sociale, pa ndonjë referencë me lidhjet e pushtetit dhe dominim ndërmjet grupesh të tilla.

John Thompson (1990: 6-7), bën pjesë tek të parët dhe e sheh ideologjinë si ‘kuptim në shërbim të pushtetit’. Sa i takon Fairclough, ai pranon se, nëse ideologjitë janë përfaqësime të cilat me sa shihet ndihmojnë në raportet sociale të pushtetit dhe dominimit, atëherë edhe analiza e diskurit duhet kornizuar në këtë plan pra, *tekstet duhen parë në terma të efekteve që kanë në lidhje me pushtetin*.

Për t'iu kthyer teorisë së studiuesit dhe për të kuptuar se çka ndërmend saktësisht me **interpretim**:

*Interpretimi mund të shihet si një proces kompleks me disa aspekte të ndryshme, që variojnë. Pjesërisht ka të bëjë me **kuptimin**-të kuptuarit se çfarë, fjalë, fjali apo pjesë më të gjata të tekstit duan të thonë; të kuptuarit e asaj që kanë ndërmend folësit apo shkruarit. Por, është gjithashtu, pjesërisht, një çështje **gjykimi dhe vlerësimi**: për shembull, të gjykosh nëse dikush po e thotë diçka në mënyrë të çiltër apo jo, ose nëse e ka seriozisht; të gjykuarit e asaj nëse pretendimet eksplicite apo implicite që bëhen janë të vërteta; të gjykosh nëse njerëzit po flasin apo shkruajnë në forma të cilat përshtaten me lidhjet sociale, institucionale etj., brenda të cilave ngjarjet ndodhin, apo ndoshta në forma të cilat mistifikojnë këto lidhje. Më tej, ka edhe një element **shpjegues** te interpretimi-ne shpesh përpiqemi të kuptojmë pse njerëzit po flasin apo shkruajnë në një mënyrë a tjetër, dhe madje identifikojmë shkaqe sociale më pak imediate (Fairclough, 2003: 11).*

Ajo nga e cila duhet të ruhem, megjithatë, gjatë interpretimit, është *shterrueshmëria*: ne asnjëherë nuk mund ta përimtojmë, kuptojmë apo zbërthejmë një tekst deri në fund. Realiteti i teksteve, mëshon Fairclough, mund ta tejkalojë dijen tonë mbi to. Përfundimisht, nuk ka një gjë të tillë si një analizë diskuri që është e plotë, përfundimtare dhe e gjithëkohshme. Kjo edhe për një arsye tjetër, që është *përzgjedhshmëria*. Sa herë që marrim në dorë një tekst, me qëllimin e zbërthimit, ne jemi paragjykses ndaj tij; ne zgjedhim të bëjmë një pyetje dhe jo një tjetër, të hapim një kënd dhe jo një tjetër; të analizojmë një pjesë dhe jo një tjetër.

2.2.1 Agjentët dhe ngjarjet sociale; individi dhe struktura

Margaret Archer argumenton për një *formë dualizmi* që ndikon strukturat shoqërore. Ndryshe nga konstruktivistët socialë, që i mëshojnë idesë se *njeriun e përcakton shoqëria*, Archer mendon se strukturat shoqërore varen nga individët të cilët i përbëjnë (Archer, 1995). Pra, kemi *struktura dhe praktikat shoqërore* dhe, gjithashtu, sipas Archer e të tjerëve, edhe *agjentët socialë*, pra njerëzit e përfshirë në ngjarjet, apo zhvillimet shoqërore.

Fairclough, duke u bazuar te Archer dhe Sayer, përmbledhtazi i identifikon agjentët socialë si jo të lirë, në kuptimin që ata janë shoqërisht të kufizuar. Por, vlerëson ai, aksionet e tyre nuk janë absolutisht të përcaktuara nga shoqëria. Në këtë frymë, agjentët socialë kanë ‘pushtetet e tyre shkaksore’ të cilët nuk janë të reduktuar sipas pushteteve shkaksore të strukturave dhe praktikave sociale. Pra, ata mund të veprojnë edhe më vete. Kësisoj, agjentët socialë mund të ‘fabrikojnë’ tekstet e tyre.

Kur konsiderojmë strukturat sociale, na duhet të pranojmë njëfarë ambiguiteti të tyre apo misticiteti, i cili vjen nga fakti se ato janë, në të shumtën e rasteve, njësi abstrakte. Kur, për shembull, ne flasim për një klasë shoqërore, na duhet të bëjmë bashkë disa pjesëza në mendje për të formuluar një mozaik. Nëse duam të krijojmë një lidhje mes strukturave sociale dhe ngjarjeve, sipas Fairclough, ne nuk mund ta bëjmë këtë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për të dhënë një shpjegim duhet një enitet i tretë, gjithashtu abstrakt në njëfarë mënyre, që janë *praktikat sociale*. Ato që studiuesi i quan në këtë rast *ndërmjetësit*.

Çfarë janë praktikat sociale? Nëse shteti është një strukturë sociale dhe Lufta e dytë Botërore një ngjarje (event) atëherë ajo që mësojmë në shkolla për këtë luftë është ‘praktika sociale’, pra një rend në të cilin vendoset diskuri. (Teksti në vetvete është një event social).

Gjuha është, sigurisht, një nga strukturat sociale, në mos më e forta e tyre. Tekstet, megjithatë, ngulmon Fairclough, nuk janë thjesht efektet e potencialeve që përkufizohen nga gjuhët. Duke dhënë përkufizimin e një rendi diskursiv, ai e shquan atë si një rrjet të praktikave sociale në aspektin gjuhësor.

Elementët e rendit diskursiv nuk janë gjëra si emrat apo fjalitë (elemente të strukturës gjuhësore), por diskuret, zhanret dhe stilet. Këta elementë përzgjedhin mundësi të caktuara

të përkufizuara nga gjuhët dhe përjashtojnë të tjerat-ata kontrollojnë variabilitetin gjuhësor për zona të caktuara të jetës shoqërore. Kështuqë rendet diskursivë mund të shihen si organizime dhe kontrole shoqërore të variacionit lingusitik (Fairclough, 2003: 19).

Sipas kuptimit të Fairclough, diskuri e jep veten në tri forma, si pjesë e praktikave sociale: zhanre (forma të veprimit); diskure (forma të përfaqësimit); stile (forma të të qenit). Të shkruarit dhe të folurit është një prej mënyrave të veprimit dhe ndërveprimit, pra forma e parë. Sa i takon diskureve, ai sjell shembullin e Old Labour dhe Neë Labour në Britani për të përshkruar një mënyrë të veçantë të përfaqësimit të botës ose të një pikëpamjeje politike. Stilet, forma e tretë, kanë të bëjnë me mënyrën e të barturit të vetes, mënyrën e të folurit apo të të veshurit.

Këto të fundit, pra stili i të barturit të vetes apo i të veshurit, kanë të bëjnë me atë që Ëalter Benjamin i pari, e më pas Harvey (1990) e të tjerë, e quan *estetizim të politikës*, fenomen që sipas tyre është pikasur që me propagandën naziste, para dhe gjatë Luftës së dytë Botërore. Ky estetizim i politikës mund të thuhet se është shtrirë edhe përtej saj, duke u bërë, në njëfarë mënyre, *estetizim i identiteteve publike*. Roli që luan imazhi në jetën publike është sundues dhe interpretimi i imazhit mund të jetë një instrument me vlerë për të testuar teorinë e Fairclough të qasjes interpretative të diskurit.

Pra, aksioni i një politikani nuk është një mundësi për të analizuar vetëm tekstin e tij, por edhe imazhin: procesi i ndërtimit të imazhit, edhe pse në fillimet e veta në rastin e Shqipërisë së viteve '90, bëhet pjesë e rëndësishme e interpretimit të diskurit. Pra, identifikimi, jo vetëm nëpërmjet tekstit, por edhe shfaqjes. Sigurisht, për të kapur imazhin nuk duhen analizuar vetëm pamja e jashtme, qëndrimi, por një event në tërësinë e vet, këshillon Fairclough.

Kjo përfshin dizajnin pamor të vendit në të cilin mbahet një fjalim; mënyrën me të cilën vendi dhe vetë politikani, si pika qendrore e eventit, është filmuar; spin-in që është dashur për eventin nga spin doctors, të cilët synojnë të formësojnë mbulimin mediatik para dhe pas eventit. Gjithashtu mishërimin e politikanit, përfshirë qëndrimin, gjestet, shprehjet e fytyrës, lëvizjet e duarve dhe kokës, e me radhë. Por, edhe gjuha duhet parë brenda kësaj kornize të estetizimit-ajo gjithashtu është pjesërisht e hartuar për efekte estetike. Ne mund ta shohim këtë si pjesë e asaj që është e pashmangshme, të parit e gjuhës si **retorikë**, përfshirë, për shembull, modelimet sintaksore dhe leksikore të gjuhës; gjithashtu ritmin e saj si e folme (po aty: 130).

2.3 Retorika, efekti estetik dhe ideologjik

A është ideologjike retorika? Pra, a munden stilemat, shprehjet figurative, ligjërimi në tërësi, të shfaqen si një strukturë ideologjike, apo siç pyet Richard Toye (2013) ‘a janë aliteracioni, metafora, simileja, ironia, eufemizmi, litota dhe shumë elementë të tjerë të stilit, ideologjikisht të ndërrueshme apo të lëvizshme?’. Përgjigjia e vetë atij: një gjë e tillë duket e pamundur duke qenë se e majta dhe e djathta, racistët dhe antiracistët, feministët apo shovinistët, përdorin të gjithë bashkë të gjitha format e retorikës.

Sido që të jetë i ndërtuar arsyetimi i *puritetit të retorikës*, mjetet e saj nuk duket të jenë ideologjikisht të papërthyeshme. Më saktë, çdo ideologji krijon apo pasuron një korpus të vetin retorik. Edhe pse duket se retorika, politike apo ideologjike, mund ta ketë zanafillën te ajo që Richard Eeaver (1970) quan *gjuhë sermonike*, duke marrë një rol shëlbues e misionar, dogma ideologjike ka përpunuar dhe ka marrë kthesa të shumta duke e sfiduar edhe vetë dogmën fetare.

Toye, megjithatë, i mëshon idesë se në retorikë dallimi ekziston, por vetëm te përmbajtja dhe aspak te forma. Sipas tij, e djathta dhe e majta, racistët dhe anti-racistët, mund të përdorin metafora të ndryshme për të përshkruar kundërshtarët apo viktimat, por kjo mbetet një çështje kuptimi, përmbajtjeje dhe njohjeje (cognition), dhe jo përzgjedhja e një figure përkundër një tjetre. Duke i mëshuar idesë se retorika është formë dhe jo përmbajtje, ai na shtyn drejt pyetjes: çfarë është ideologjia; stil apo thelb?

Një studim retorik i një diskuri ideologjik në terma të përgjithshëm do të ndjekë të njëjtat parime si më poshtë: do të përqendrohet te ato figura të stilit që mund të përdoren për theksimin e gjërave tona të mira dhe gjërave të tyre të këqija, dhe e kundërta të të këqijave tona dhe të mirave të atyre, si për shembull hiperbolat, eufemizmat e me radhë. Për të mësuar se çfarë implikimesh ideologjike kanë shprehje të tilla figurative, ne sërish na duhet të shqyrtojmë kuptimet që ato organizojnë /formojnë (Toye, 2013: 59).

Implikimet ideologjike për të cilat flet Toye mund të gjenden me tepri në diskurin e revolucioneve dhe të revolucionarëve. Martin Luther që formuloi tezat protestante, duke sjellë një revolucion brenda Kishës, është një shembull. Revolucion i francez dhe formulimi etik dhe estetik i jakobinëve, është një tjetër. Revolucion i Bolshevik i tetorit është gjithashtu një demonstrim i implikimeve ideologjike. Të tilla sa, në fjalët e Toye-s “Retorika nuk është vetëm mjeti me anë të të cilit shprehen idetë, por edhe një mjet me anë të të cilit idetë gjenerohen.”

Revolucioni francez nuk shkatërroi vetëm strukturat politike ekzistuese; tentoi gjithashtu një revolucion gjuhësor. Revolucionarët e zhveshën gjuhën e tyre nga referencat e krishtera (megjithëse, jo nga të gjitha ngjyrimet fetare). Vive la nation iu mbivendos vive le Roi; madje edhe emrat e muajve u ndryshuan. Të obseduar me kërcënimin e kundërRevolucionit dhe komplotet, radikalët u specializuan në ‘retorikën e denoncimeve’ (po aty: 26).

Në këtë logjikë, studiuesit Alan Finlayson dhe James Martin sugjerojnë: një prej gjërave që është një ideologji, është ajo që quhet *stil i argumentimit*. Atëherë, idetë nuk shpërfaqen vetëm me anë të përmbajtjes, por edhe të formës, që do të thotë, nuk ka një hendek ndarës mes tyre, që do të thotë më tej: struktura retorike është në njëfarë mënyre ‘kompozitore’ e ideologjisë?

Retorika, rrjedhimisht, nuk është një gjë vetëm e formës; nuk është vetëm një mjet mbi të cilin vendoset një qëllim për ta përcjellë atë më pas drejt një publiku, audience apo elektorati. Retorika është mjet, mund të kthehet në qëllim, por çka është më thelbësorja: ajo mund të ketë forcë shndërruese. Toye veçon si tiparin më të rëndësishëm të retorikës, cilësinë dinamike të saj: Ajo shtyn përpra ndryshimin shoqëror, duke mos u bërë thjesht pasqyruese e tij.

Kjo dinamikë, kjo vetëdije e të qenit, si mjet ashtu dhe qëllim, e retorikës flet për një proces krijues, për një cikël të cilin Toye e etiketon shkatërrim kreativ. Sepse, retorika, dekodon dhe riciklon argumente të cilat, sado që mund t'i apelojnë historisë nuk janë kurrë e njëjta gjë në formën e tyre të vjetër si dhe në të renë. Inovatori u thërret vlerave të së shkuarës për të legjitimuar sjellje të reja dhe të dyshimta; konservatori detyrohet të ndryshojë gjithçka në mënyrë që gjithçka të mbetet e njëjta (Toye, 2013: 111).

2.3.1 Sa retorika kemi?

Aristoteli (2004) dallonte tre zhanre të Retorikës: *retorika ligjore*; *retorika e shfaqjes* (fjala e mbajtur në një funeral); dhe *retorika deliberative*, e cila përpiket që të bindë audiencën drejt një aksioni të veçantë (si shpallja e luftës, kalimi i një ligji etj).

Objekti i studimit tonë, komunikimi politik i Berishës, pavarësisht një periudhe të ngushtë, 1990-1992, dhe një 'hapësire deliberative' të ngushtuar nga roli i opozitarit në një mjedis ende ta paçliruar nga frika e diktaturës komuniste, përkon me të tria zhanret aristoteliane. *Retorika ligjore* e Berishës mund të gjendet në debatet apo fjalimet e parlamentit të dalë nga zgjedhjet e marsit 1991; *retorika e shfaqjes*, në 'përcjelljen' e protestuesve opozitarë të vrarë në Shkodër më 2 prill 1991, dhe *retorika deliberative* në shumë prej fjalimeve, debateve apo përballjeve me kundërshtarët politikë, apo ata brenda parties (dalja e ministrave të PD nga Qeveria e Stabilitetit).

Tri dallesa të tjera të famshme të Aristotelit, do të n'a ndihmojnë gjithashtu në dekodimin e komunikimit politik të Berishës; qoftë ai në formën e një fjalimi apo teksti. Ato janë *ethosi* (karakteri); *pathosi* (emocioni apo karakteri emocional i audiencës); dhe *logosi* (logjika). Ethosi varet në karakterin personal të folësit; pathosi në vendosjen e audiencës brenda një kornize të menduari; logosi në dëshminë apo në provën e jashtme që jepet nga vetë fjalët e fjalimit.

Praktika politike e fushatës, të paktën deri në fund të shekullit XVII, ndjek linjën e ethosit. Kandidatë ishin paraqitur para votuesve kryesisht mbi bazat e karakterit, duke i mëshuar idesë se ata ishin personat e duhur për atë punë, për atë përfaqësim, për atë besim. “Burri i mirë”, me kalimin e kohës u zëvendësua nga ‘oferta më e mirë’, pra nga politikat që politikani ofronte të ndiqte në shërbim të komunitetit, me pak fjalë një kalim në logos. Sipas Andreë Ë. Robertson pati një kalim nga retorika laudatore, lavdëruese e kandidatit, të retorika hortatore (nxitëse) e cila shtynte apo këshillonte votuesit që të mbështesnin një pikëpamje të veçantë.

Kalimi, megjithatë, nuk ka qenë i plotë; siç asnjë kalim nuk mund të jetë. Megjithëse *ideali i delibaracionit retorik*, term i Toye-t, ia ka lënë vendin asaj që mund të quhet *idealizimit të paketave politike*, lideri karizmatik është ende i kërkuar. Paketat, sado të plota të jenë, kërkojnë një shitës me gjuhë të mprehtë dhe rrezatim të fortë. Ky rrezatim ndodh edhe për shkak të momentit të duhur, atij që grekët e quanin *kairos*. Është ky moment që e mvësh me karizëm një fjalim të mbajtur me teknikë të lartë dhe fjalë të përzgjedhura. Në kuptimin që i jep kësaj Aristoteli, “arti i retorikës gjendet tek identifikimi i mundësive të paraqitura nga situata, jo në ndërthurjen sterile të shprehjeve figurative për hir të tyre”.

2.3.2 Rregullat e Retorikës

Edhe pse, në gjykimin e Sokratit, retorika nuk është një *techne* (mjeshtëri), por një dhunti, studiuesit kanë nxjerrë *pesë rregulla të retorikës*, pra kanë pranuar se ajo është diçka që mësohet.

E para, është *shpikja* apo gjetja, pika ngjizëse etj, e cila ka të bëjë me procesin e gjetjes së një argumenti të përshtatshëm për situatën apo mjedisin, pra një pasqyrim të asaj që është natyra e audiencës/audiencave.

E dyta është *përgatitja* e cila është në thelb një skematizim, shpërndarje, renditje e asaj që do të thuhet.

I treti është *stili* që do të thotë gjuha që do përdoret dhe këtu nuk bëhet fjalë për gjuhën e folur, por edhe atë të trupit.

E katërta, *kujtesa* e cila nuk ka të bëjë vetëm më të mbajturit mend të fjalimit apo pjesëve të tij, por edhe me brendësimin e argumenteve në mënyrë që fjalimi të ‘rikrijohet’ sa herë e lyp nevoja e rrethanave.

E pesta, *mbajtja e fjalimit*, është faza përmbyllëse dhe lidhet deri diku edhe me rregullin e tretë duke qenë se ka të bëjë me qëndrimin gjatë fjalimit (njëlloj stili) si theksi, tonaliteti i zërit. Pranohet gjerësisht se, përmbytja e fjalimit ka pak rëndësi nëse mbajtja, paketimi, vetë forma, nuk është e përgatitur me kujdes dhe e marrë seriozisht.

Nuk ka dyshime se natyra e fjalimit, thekson Tøye-it, qoftë ai ligjor, ekspozues apo deliberativ, gjithmonë do të përfshijë një thirrje drejt ethos-it, pathosit apo logosit (me fjalë të thjeshta: karakter, emocion apo logjikë) kategoritë e identifikuar nga Aristoteli.

Analiza retorike merret pikërisht me dekodimin e këtyre thirrjeve. Kritiku letrar Ëayne C. Both ka folur për konceptin e *autorit të nënkuptuar*, pra ç’do të thotë teksti rreth

autorit të vet. Në këtë rast duhet treguar kujdes sepse, shpesh, autori i vërtetë dhe autori i nënkuptuar mund të jenë dy njerëz të ndryshëm (bëhet fjalë këtu për një fjalimmbajtës që nuk është i njëjtë me fjalimshkruesin, megjithëse një fjalimshkrues për të qenë duhet të mbajë parasysh faktin se po shkruan për dikë tjetër dhe se kush është ky person).

Një nivel i analizës merret me atë që mund të quhet çështja 'makro' e retorikës: cila është natyra e një fjalimi; si është ndërtuar dhe mbajtur; a kërkon të ngacmojë arsyen, emcacionin apo karakterin? E së njëjtës rëndësi, megjithatë, janë mikro teknikat të cilat, fjali të thjeshtë pas fjalie të thjeshtë, dhe fjali pas fjalie, avancojnë (ose ndoshta pengojnë) synimet e përgjithshme të retoricienit (Toye, 2013: 46).

Një prej këtyre teknikave, të nivelit mikro, është edhe pyetja retorike, përkufizimi dhe kuptimi i së cilës është i thjeshtë. Ajo të lejon përkufizimin e një problemi dhe më pas të artikulojë një zgjidhje tënden për të. Gjithaq të rëndësishme, edhe pse të nivelit mikro, janë edhe metaforat politike, si për shëmbull *Perdja e hekurt* (për ndarjen ideologjike mes Perëndimit dhe Lindjes komuniste); *fitore me lumë votash*; *kandidatët pretext apo lopët e shenjta ideologjike*. Trikolona konsiderohet gjithashtu një teknikë efektive; e tillë është slogani i revolucionit francez *Liberte, Egalite, Fraternite* etj. Retorika politike njihet edhe antitezën si figurë të përdorur dhe të fortë në përçimin e një ideje. Pjesë e fjalorit politik është bërë kontrasti i fjalimit të JFK 'Mos pyet se ç'mund të bëjë atdheu për ty, por se ç'mund të bësh ti për atdheun'.

Siç thekson Richard Toye, te *Rhetoric, a short introduction*, "Mënyrat e të thënit pasqyrojnë dhe afektojnë mënyrat e të parit." Një mënyrë të thëni është edhe ai që quhet *metadiskuri*, rasti kur retoricienët i tregojnë audiencës se çfarë janë duke bërë; çfarë do të bëjnë, apo dhe çfarë kanë bërë. Një frazë e tillë e përdorur shpesh është 'siç demonstrova...'; siç thashë më lart...' etj. Teknika të tilla ndihmojnë me përçimin e një argumenti, sepse e bëjnë gati audiencën për mesazhin që do të vijë, apo ritheksojnë mesazhin që është dhënë ndërkohë. Po aq i bën gjërat edhe më të qarta. Një tjetër

metodë e përdorur nga retoricienët është parashikimi apo *prolepsis*, rast kur folësi i paraprin një objeksioni të audiencës duke e përmendur vetë atë dhe duke i dhënë përgjigje përforcuese që shkon në favor të tezës tënde.

Në fushën e minuar të retorikës dhe debatit politik, ajo figurë e të shprehurit që quhet *paralipsis* është gjithmonë ndihmëse. E tillë quhet praktika e tërheqjes së vëmendjes rreth një rasti apo problemi ndërkohë që hiqesh se nuk e merr në konsideratë apo se është ‘poshtë teje’. Një shembull i tillë mund të jetë një ves/problem i rivalit politik i cili theksohet me anë të një anashkalimi të tipit: ‘Nuk e shoh me vend që të ndalem te problemet në familje të kundërshtarit tim...’.

Teknikat, mund t’i quajmë edhe manipulative, e retorikës, përdoren në funksion jo vetëm të paraqitjes në njëfarë drite apo niveli të autorit të tyre, por sidomos të audiencës. Siç ka një autor të nënkuptuar ka edhe një audiencë të tillë.

Një folës që thotë ‘jemi mbledhur sot këtu për të salutuar heronjtë e rënë’ nënkupton se të gjithë të pranishmit janë aty për atë arsye, e cila në rastin e gazetarëve, të pranishmëve të rastësishëm mund të mos jetë e vërtetë. Duke i atribuar karakteristika audiencës, oratori shpreson ta kthejë audiencën aktuale në një të imagjinuar, ta konvertojë shikuesin indiferent në të përkushtuar emocionalisht. Këtë kemi në mendje kur themi se folësi po ‘ndërton’ audiencën në një mënyrë të caktuar-është përpjekja për të përdorur fjalë të cilat vendosen në një linjë realitetin me imagjinaren (po aty: 50).

Retorika, pavarësisht këtyre dhjetra teknikave eficiente verbale dhe logjike, është gjithashtu një fenomen fizik, thekson Toye. Një foto e Martin Luther King-ut, liderit të Lëvizjes së të Drejtave të njeriut në vitet ‘60 të shekullit XX, ndërton një ide të përmasës fizike të retorikës. Fotoja e King-ut nga një kënd pas shpinës së tij, me një masë të madhe njerëzish që duket sikur buron nga këmbët e Ëashington Mall-it, ndërton një narrativë të vetën. Siç vëren Toye, impakti i fotos afektohet nga teknologjia e përdorur për shpërndarjen e saj. Ai shton se “kompleksitetet e lidhjes me një audiencë shkojnë shumë përtej artizanatit të fjalëve të figurshme”.

Ajo që quhet *analizë retorike* apo narrative, dhe që do të ndimojë gjatë këtij punimi për të dekoduar komunikimin politik të Berishës, nuk ka të bëjë me ‘vërtetimin’ e asaj që subjekti thotë, me atë nëse janë të rrejshme apo të vërteta fjalët e tij. Synimi është tjetër: për të gjetur *identitetin* që dëshmon nëpërmjet fjalëve dhe, se si me anë të fjalëve subjekti e gjen kuptimin e mjedisit të vet.

Qëllimi i analizës retorike nuk është të ‘shkyçë’ një grup fjalësh për të shpërfaqur një kuptim që është i lindur apo prej natyre, por më saktë-pjesërisht- për të identifikuar kuptimin social të formulimeve apo simboleve në kontekste të dhëna (po aty: 59).

Te ‘identifikimi’ e sheh çelësin e retorikës moderne edhe Keneth Burke (1967), ndërkohë që si term shpjegues për retorikën e vjetër ai sheh ‘joshjen’ që bëhet nëpërmjet ndërtimit deliberativ të një teksti të folur apo të shkruar. Me ‘identifikim’ duhet kuptuar të përkuturit, ajo që quhet *common ground*, rasti kur një politikan gjen të përbashkëta me audiencën, të përbashkëta që mund të jenë kombëtare, lokale, personale, e të tjera. Ky identifikim bëhet drejtpërdrejt, por sidomos nëpërmjet simboleve.

Burke mendon se ‘retorika është e rrënjosur në përdorimin e gjuhës si një mjet simbolik i induktimit të bashkëpunimit në qenie që gjenetikisht reagojnë ndaj simboleve’. Shprehjet e figurshme, mendon ai, funksionojnë si shenja që retoricienët përdorin për të identifikuar –dhe për të joshur-veten me audiencën. Është përzgjedhja e simbolikës që e çon vëmendjen e audiencës në drejtime të ndryshme.

Me një gjuhë të tillë, me eufemizmin politik, George Orëell (1946) nuk pajtohej. Në esenë e tij të famshme *The politics of English language*, shkrimtari britanik del kundër ambiguitetit, kundër mungesës së qartësisë, kundër pyetjeve retorike të cilat i haste me shumicë në retorikën politike. Sipas tij gjuha politike ‘është skicuar për të bërë që gënjeshttrat të tingëllojnë të vërteta dhe vrasja e respektueshme, dhe për t’i dhënë dukjen e soliditetit erës së paqëndrueshme’.

2.3.3 Konteksti retorik

A ka vetëm fjalë politika, apo edhe një ritual, një rrethanë apo kontekst e cila ndikon apo dhe përcakton atë çfarë thuhet. Në një studim që shqyrton fjalimet në Britaninë e Madhe politologët Alan Finlayson dhe James Martin (2008) flasin për atë që ata quajnë *dimensioni simbolik ritual i politikës*. Sipas tyre konteksti afekton atë se cilat mesazhe retorike përdoren, por edhe si ato priten apo dekodohen nga publiku.

Me pak fjalë, të kuptuarit e një fjalimi, fjalie, deklarate apo çdo forme tjetër të shprehuri nuk mund të bëhet vetëm duke dekoduar tekstin, por duhen marrë parasysh edhe rrethanat në të cilat i njëjti tekst është ngjizur, shpallur, ndërmjetësuar dhe përthithur. Kontekst nuk do të thotë vetëm një vend si hapësirë gjeografike apo një kohë si hapësirë kronologjike, por edhe vetë sistemi politik që funksionon në atë moment të dhënë. Një fjalim në Romën e lashtë, një në Francën e Napoleonit, apo në Dhomën e Ulët Britanike ndryshon nga një tjetër në Senatin amerikan, Parlamentin shqiptar, Knestin izraelit, e me radhë.

Është ajo që thotë Toye (2013): *Mendime të njohura, të shprehura në kontekste të reja, mund të marrin kuptime të reja. Kultura dominante retorike jo vetëm ndikon atë që themi në publik, por edhe infiltro mendimet tona private. Kështu, kur ne kemi rastin të 'themi atë që mendojmë' kjo kulturë përforcohet si rezultat.*

A kemi atëherë tekst apo kontekst? Apo, a mund të flasim për 'lexim të imtësishëm', është pyetja që na duhet të bëjmë, duke ndjekur logjikën e Toye-it? A janë të dhënat e jashtme të pranueshme apo teksti flet për veten, duke e bërë irrelevant informacionin kontekstual? Ka një shkollë, apo rrymë mendimi të ashtuquajtur *kritikët e rinj* të mesit të shekullit XX, e cila i mëshon parashtrimit se konteksti është irrelevant.

Ë. K. Ëimsat dhe Monroe C. Beardsley (1946), dy përfaqësues të kësaj shkolle, në një sprovë të tyre parashtrojnë idenë se shpërfaqjet e asaj se çfarë kishte ndërmend autori

në një tekst, si ato që mund të gjenden në ditarët privatë, nuk ishin të përshtatshme për interpretim.

Roland Barthes-i (1978) nuk sheh dritë në deshifrimin e një teksti vetëm si të tillë, gjë që do të jepte ‘kuptimin e vetëm teologjik të tij’. Kjo shkollë mendimi ku autori nuk e ka shkruar tekstin, por janë rrethanat ose konteksti që e ka përcaktuar, erdhi të njëjti e të etiketohej si *post-strukturalizëm*. Ky lexim, theksojnë poststrukturalistët, e mundëson dekodimin apo më tej kuptimin, të dalë apo krijohet nga ai që bën leximin, jo nga ai që shkruan tekstin.

Rëndësinë e kontekstit e thellon studiuesi britanik Quentin Skinner, i cili i mëshon tezës se ‘vetëm duke ndërtuar kontekstin ideologjik dhe gjuhësor sundues në kohën kur autori shkruan, është i mundshëm identifikimi i asaj se ku ai autor po kërkonte të thyente konvencionet dhe rrjedhimisht ku do të kryente inovacione.’

Jemi pra në situatën që sugjeron autori i ‘Rhetorics...’:

Retorika është një fenomen social dhe receptimi i saj varet nga normat në veprim në shoqërinë në të cilën vepron. Nëse na duhet të kuptojmë politikën, ekonominë, sociologjinë, psikologjinë apo moralitetin e shoqërisë, atëherë nuk ka mënyrë më të mirë për të filluar se sa të shohim mënyrën me të cilën flet rreth këtyre gjërave-dhe në veçanti mënyrën me të cilën flet rreth mënyrës me të cilën duhet folur për këto gjëra.

2.3.4 Si bëhet analiza retorike

Studiuesit e retorikës i japin rëndësi vendimit se *çfarë do të analizosh*, pra një përzgjedhje autori ose lamie. Një hap i dytë konsideron *përzgjedhjen e një teksti të vetëm të cilin e përimiton deri në shterrim, ose alternativën, atë të shtrirjes së analizës mbi një tematikë përgjatë një periudhe*. Këshilla që jep Toye është *fokusimi*, mbështetur edhe nga Umbero Eco e të tjerë, pra mosrënien në ‘universalizëm’, pasi një individ i vetëm nuk mund të shtërrojë të gjithë literaturën që ka lidhje me një temë.

Nëse merret në shqyrtim një fjalim, në rastin tonë i Berishës, është mirë që kjo njësi e analizuar të krahasohet me të tjera në çështje të ngjashme, pra t'i sigurohet një *kontekst*. Gjithashtu ka vend *krahasimi me fjalime që përbëjnë retorikën politike të kohës*. Pa harruar nëse fjalimi ka patur në konsideratë edhe *audiencën ndërkombëtare* (kjo është e nevojshme në periudhën në të cilën studiohet Berisha, duke ditur një 'përbetim' perëndimor antikomunist dhe implikimet e tij).

Një këshillë tjetër ka të bëjë me *llojin e materialit retorik*: është tekst, audio apo video. Regjistrimet me zë apo me figurë të lejojnë të shpalosh të tjera shtresa analitike duke qenë se mund të marrësh parasysh gjestikulacionin, tonin (ulje-ngritjet e zërit), këndi i kameras, impostimi i intervistuesit, e të tjera. Kur bëhet fjalë për materiale të shtypura, fjala dhe konteksti janë të vetmet lëndë analitike. Megjithatë, përzgjedhja gjithmonë të bën punë: sa ç'mund të jetë penguese mungesa e të dhënave, po aq bëhet pengesë edhe dendësia e tyre.

Kur materiali të jetë siguruar apo përzgjedhur, duhet shkuar te *lloji i qasjes metodologjike*: sasiore apo cilësore. Nëse qasja cilësore të bën për vete, apo mendon se i zbërthen më mirë përfundimet që do të nxjerrësh nga materialet e përzgjedhura, qasja sasiore nuk duhet lënë mënjanë me gjithsejt. Ajo mund të përdoret në atë mënyrë që njihet si 'në terma të përgjithshëm'. Për shembull, në rastin e një analize të fjalimeve të Berishës është mirë të dihet se sa herë ka folur ai për Kosovën: Kalimthi apo sa herë i është dhënë rasti? Apo, cilat janë metaforat më të përdorura nga Berisha? Sa herë e përdor hiperbolën? Qoftë edhe çfarë lloj folësi është ai: sa herë në javë apo në vit parapëlqen të mbajë një fjalim apo një deklaratë për shtyp. Një mënyrë për të dekoduar tekstet, shumë e përdorur sot, është ajo me anë të një programi kompjuterik. Megjithatë dekodimi 'manual' të mundëson që nëpërmjet kontekstit, gjë që kompjuteri s'e bën dot,

të zbulosh cilësinë e një termi, si po përdoret ai. Marrim, për shembull, fjalën *liria*, shumë e përdorur nga Berisha. Duke e hulumtuar fjalën *liri* si pjesë të një fjalie mund të gjejmë nëse ajo është përdorur në kuptimin ‘e djathtë’, të *lirisë së sipërmarrjes, tregjeve të lira, konkurrencës së lirë* apo në një kuptim ‘të majtë’, të *lirive të njeriut, lirisë për divorc, lirisë për abort*, e të tjera.

Toye sugjeron edhe një matje të kompleksitetit të fjalive të një folësi, por ajo që ne do të përdorim është ndërtimi i një table ideologjike të ndarë në e majtë/e djathtë duke vendosur në secilën terma ideologjike korrespondues për të nxjerrë më pas një përkitje apo anim ideologjik të Berishës.

Një rrezik të cilin Toye sugjeron të shmangim është:

fjalët nuk ruajnë kuptime të qëndrueshme përgjatë kohës dhe kulturash të ndryshme. Për më shumë, të majtët mund t’ia dalin në përvetësimin e fjalëve të djathta dhe e kundërta. Tekstet atëherë nuk mund të trajtohen thjesht si ‘koleksione të fjalës’ që mund të vendosen në ‘dimensione politikash të paracaktuara’ në një mënyrë të pangatërruar. Analizat sasiore të të dhënave të fjalëve mund të ngrenë pyetje shumë interesante, por si një shtesë e leximit të përimit të teksteve, dhe jo si zëvendësues.

Nëse do të hartonim një oknolog të këshillave të Toye-it për studimin retorik të një teksti, do të vijonte si më poshtë:

- 1- Nisja me identifikimin e elementëve ligjorë, deliberativë apo laudatorë;
- 2- Përpiqu të dallosh mënyrën se si pjesë të veçanta bëjnë thirrje/apelle të veçanta-ndaj ethosit, pathosit dhe logosit;
- 3- Kur ka ambiguitete, theksoje;
- 4- Gjej shembuj të imazherisë;
- 5- Lokalizo shprehje të figurshme, dhe përpiqu të gjesh si si ato përparojnë (ose ndoshta e pengojnë) mesazhin e folësit;

- 6- Mbi të gjitha, përpiku të përcaktosh se për çfarë po flitet saktësisht-për shembull, një grup fjalësh neutrale e të zakonshme fshehin një sulm mbi një grup të jashtëm?
- 7- Reflekto mbi atë se ç'burime të tjera të dhënash- si boca fjalimesh, fotografi, ditarë apo gazeta- mund të të ndihmojnë në analizën tënde nëse do të ishin të gjindshme.
- 8- Është gjithmonë me vend për t'i parë debatet (formale ose jo), të paktën pjesërisht, në terma të *çfarë nuk thuhet*. Mospajtimet, në dukje të dhunshme, mund të fshehin faktin se kundërshtarët ndërluftues kanë rënë dakord, të paktën për atë që është e rëndësishme për t'u konfliktuar. Kjo gjithashtu mund të pasqyrojë një pakt të pashprehur, që ndonjëherë gjërat më mirë të jenë të papërmendura. Analiza retorike, rrjedhimisht, duhet të konsiderojë detin e konsensusit të heshtur që mund të rrethojë ishujt e kundërvënieve vullkanike.

2.3.5 Akte të fjalës

Politikanët, apo të gjithë ata që Toye-i i quan *retoricienë* nuk i fusin në përdorim fjalët sa për të përcjellë një gjë apo proklamuar një botëkuptim apo qëndrim, ata duan të bëjnë *gjëra me fjalët*. Këto 'gjëra' mund të jenë një apel për ndjekësit e tyre, një thirrje për kombin, një ftesë për një qëndrim apo miting, e me radhë. Veprime të tilla, që kryhen me anë të fjalës, kanë një cilësi të dyfishtë pasi janë akte dhe fjalë. Përndryshe quhen *speech acts*, një term, në fakt një teori, që u shpik nga studiuesi J.L. Austin, autori i librit të famshëm *How to do things with words*. Austin-i me tezën e tij kundërshtoi teorinë se fjala është aty sa për të përshkruar dhe se një formulim është i vërtetë ose i rrejshëm dhe nuk ka qëllime të tjera.

Një pikëpamje që e ndan edhe Umberto Eco, sipas të cilit ‘më shumë se një tërësi fjalësh që i përgjigjen një tërësie gjërash, ligjërimi politik është shembulli i përsosur i një ligjërimi që bën gjëra, që vepron teksa flet: premtan, kërcënon, mohon, miraton, bashkohet, riqarkullon, propozon, dikton, hedh poshtë e kështu më radhë’.

Sipas Marrone-s, (2008: 224) komunikimi është pjesë përbërëse, e domosdoshme, e çfarëdolloj veprimi politik duke qenë veprim edhe vetë. Ai thekson: kur flitet për komunikim politik në kuptimin semiotik, vetëkuptohet se aty përfshihen, veç karakteristikave të tij verbale tradicionale, si thirrjet ndaj zgjedhësve ose ligjërimet në Parlament, edhe ato aspekte që përdorin materiale të tjera shprehëse, si posterat zgjedhorë, mënyra e të veshurit e kandidatëve, gjestet, mediatizimi televiziv e të tjera si këto.

Barthes-i evidenton përfshirjen e fotografisë si pjesë e posterit zgjedhor, si vlerë semantike të përcaktuar: ajo krijon bashkëveprim mes kandidatit dhe zgjedhësit. Ideja e kësaj ndërthurjeje, sipas Barthes-it, ka të bëjë me atë se kandidati shfaqet si mundësi zgjedhjeje jo vetëm më anë të programit politik, por edhe një pranie fizike. Kjo prani fizike, kjo pozë dhe kjo mënyrë të veshuri, janë gjithaq pasqyra ku zgjedhësi sheh veten, ku ravijëzon një vetvete të shprehur dhe heroike. Në njëfarë mënyre, logjika e Barthes-it na sugjeron se zgjedhësi është duke zgjedhur vetveten ose një të ngjashmin e vet.

KAPITULLI III

KONTEKSTI HISTORIK DHE NJË VËSHTRIM POSTUM I TRANZICIONIT

Gjithashtu, duket se mungesat përbëjnë kyçin për të kuptuar fundin e komunizmit. Mos pandeh se ishte punë e Papës Gjon Pali II? Ose e idesë së Gorbaçovit për Glasnost dhe Perestrojka?, ose e ndërthurjes së tyre? Po, natyrisht, të tërë janë dakord në këtë pikë, po hidhi edhe një vështrim dyqanit. Aty nuk ekspozohet letër higjienike, dhe për një arsye të fortë: s’kishte fare. S’kishte pece për menstruacionet, as pelena, as pluhur larës – pa folur për kafënë, gjalpin ose portokallet. Për ta kuptuar pse dështoi komunizmi, duhet të dimë se ai nuk mund të prodhonte gjërat elementare që u nevojiteshin njerëzve. Ose ndoshta jo në sasi të mjaftueshme. Sa mund të zgjasin të tilla regjime? Ma merr mendja se suksesi i një sistemi politik matet edhe në bazë të mallrave të disponueshme për njerëzit e rëndomtë.

–Slavenka Drakulić, *Vizitë me ciceron në Muzeun e Komunizmit.*

3.1 Hyrje

Një autor amerikan identifikon një orë dhe datë të saktë, të cilat shënojnë atë që ai e quan ‘Vala e tretë e demokratizimit në botën moderne’.

Çuditërisht dhe si padashur, gjithçka filloi, shkruan ai njëzet e pesë minuta pas mesnate, në ditën e enjte, 25 prill 1974, në Lisbonë, Portugali, kur një radiostacion transmetoi këngën Grandola Vila Morena (Huntington, 2015: 21).

Transmetimi përbënte shenjën e sulmit për njësitë ushtarake, brenda dhe jashtë Lisbonës, mësymje që do të fillonte planin e grushtit të shtetit, përpiluar nga oficerët e rinj, në krye të Movimento das Forças Armadas (MFA).

A ka pasur në Shqipëri një shenjë të tillë, një protestë, një shkrim në gazetë, apo fjalim në shesh, që i ka hapur rrugë rrëzimit të komunizmit, në një vend të sunduar prej kësaj ideologjie për 46 vjet?

Autorë të shumtë, kryesisht shqiptarë, e më pak të huaj, që janë marrë me hulumtimin e kësaj rrjedhe ngjarjesh, nuk flasin për një moment të vetëm që mund të vendosë një shenjë nisjeje të shndërrimeve historike.

Ky kapitull, pjesë e një punimi që synon të vendosë piketa shkencore në komunikimin politik të një prej protagonistëve të kësaj kohe shndërrimesh, Sali Berishës, nuk kërkon të zbulojë këtë shenjë të vetme. Do të ndalemi në momentet kryesore të periudhës 1989-1991, e më pak edhe deri në zgjedhjet e 22 marsit 1992, për të hedhur një vështrim, si mbi kronikën, ashtu dhe mbi interpretimet që i janë bërë kësaj periudhe. Duke shfytëzuar për këtë pak nga shtypi i kohës, por kryesisht libra autorësh shqiptarë ose të huaj, dëshmitarë apo kronikanë të asaj kohe, pjesëmarrës apo spektatorë të atyre ngjarjeve përmbyesë në historinë e Shqipërisë.

Konteksti historik botëror do t'i prijë 'konteksteve' lokale dhe do të sigurohet përmes autorësh të njohur si Walter Laker (Europa në kohën tonë); J.M. Roberts, (Twentieth Century); Archie Brown (The rise and fall of communism), e të tjerë.

Pikëpamjet dhe pikëprerjet vendore (lokale) do të jenë më interesantet, por njëherësh më të vështirat për t'u 'kapur' apo analizuar përmes një 'aparati shkencor'. Kjo për arsye se autorët vendas (duhet ngulmuar te përkufizimi i tyre si autorë e jo si studiues), janë 'të dënuar' me kundërthënie (kontroversialitet) dhe kundërshti (kontradiksione). Kjo prej vetë statusit të tyre. Thua se të gjithë, Preç Zogaj (Fillimet); Besnik Mustafaj (Midis krimeve dhe mirazheve); Spartak Ngjela (Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare

1991-1996); Ramiz Alia (Jeta ime); Servet Pëllumbi (Përmbysja e komunizmit); Shinas Rama (Përrallat e tranzicionit), dhe Elez Biberaj (Shqipëria në tranzicion), kanë qenë dhe janë të përfshirë në ngjarjet e tranzicionit shqiptar, duke nisur që nga viti 1990 e më pas. Duke qenë aktorë të historisë, nuk ka rëndësi kryesorë, dytësorë apo episodikë, të rrëfyerit e saj mund të jetë i ngarkuar, si me emocionalitet ashtu dhe me njëanësi.

Sidoqoftë, Korpusi i teksteve të këtyre autorëve mund të konsiderohet si *lindja e tranzitologjisë shqiptare*. Duke veçuar këtu Elez Biberajn, i cili pavarësisht anagazhimeve apo përfshirjes, i sheh ngjarjet shqiptare me një ‘pikëprerje amerikane’.

Pavarësisht këtyre ‘mangësive’, pretendimet shkencore të këtij kapitulli i shpëtojnë dy elementë: së pari, metoda deskriptive, domethënë përshkrimi i konteksteve pa hyrë në analizë cilësore e sasiore; së dyti, fakti se të dhënat apo interpretimet e nxjerra prej autorëve vendas do të ballafaqohen me tezat e një studiuesi të njohur, profesorit të Harvardit, Samuel Huntington.

Gjithashtu, është e rëndësishme të mos harrohet çka ky kapitull është dhe çka nuk mund të jetë: një vështrim historik i *fillimeve shqiptare në liri dhe demokraci*; një kontekst i jashtëm dhe i brendshëm. Pra, një përpjekje, jo për të provuar, por për të thënë. Për të siguruar një sfond brenda të cilit mund të kuptohet aktiviteti i politikanit të cilin ka si synim studimi ky punim, Sali Berishën. Gjykojmë se, pa ndërtuar një kontekst, lëvrimi i tekstit apo ligjërimin të Berishës do të ishte një punë jo vetëm më e vështirë, por edhe e pambështetur.

Se sa i rëndësishëm ishte konteksti përbën një hipotezë së cilës i sillen rreth si autorët vendas, ashtu dhe të huaj. Por të gjithë ndahen te pyetja tjetër: Cili kontekst? Përgjigjet janë disa dhe jo më kot në krye të kapitullit është vendosur një fragment nga një libër i

një studiueseje të komunizmit, Slavenka Drakulić. Ja edhe një hipotezë tjetër: rënien e komunizmit nuk e solli asnjë kontekst historik. Papa as Reagan-i; Perestrojka as koha që kishte ardhur. Mungesat e gjërave themelore, si buka e letra higjienike e rrëzuan komunizmin, pretendon Drakulić.

Huntington ka një listë faktorësh dhe rrethanash që e shpjegojnë këtë ‘valë demokratizimi’ dhe, çka është më e rëndësishme, e shtrin teorinë e tij në një duzinë shtetesh në Europë, Amerikën e Jugut apo Qendore, e deri në Azi e Afrikë. Edhe pse Shqipëria përmendet vetëm njëherë në librin e tij; edhe pse shumë autorë argumentojnë se komunizmi shqiptar ka qenë i një lloji të veçantë, shembujt e shumtë i sjellin të shumta edhe pikëprerjet e rastit shqiptar me të tjerë, duke e nxjerre Shqipërinë nga kllapat e *sui generis*.

3.2 Konteksti global: Washington-i, Vatikani dhe Gorbaçovi si termostat i ndryshimit

Vitet ‘80 të shekullit të kaluar, mund të konsiderohen si faza përmbyllëse e Luftës së Ftohtë. Prej kësaj faze po përgatiteshin të dilnin ato vende që Gabriel Partosh i quan në librin e tij homonim *Bota që erdhi prej të ftohtit*. Ku bënte pjesë edhe Shqipëria. Akujt që po shkriheshin ngadalë i shpjegojnë edhe hapat e afrimit, apo shenjat mirëkuptuese mes liderëve të Fuqive të mëdha të kohës. “Një burrë me të cilin mund të punoj”, shprehej kryeministrja britanike Thatcher (1993) për Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkimit Sovjetik, Gorbaçov. Një komunist liberal, ndjekës i Doktrinës së Brezhnjev, Gorbaçov-i kishte ardhur në krye të BS në vitin 1985, në moshën 50 vjeçare, si më i riu i Politbyrosë sovjetike.

Liberalizmit, përhapës i të cilit ishte Perëndimi, ai i vuri përballë pasqyrat e një postsovjelizmi, *glasnost* dhe *perestrojka* (hapja dhe ristrukturimi). Në një fjalim në Pragë në vitin 1987, Sekretari i Parë i Politbyrosë foli me terma të përbashkët me Perëndimin duke përdorur togfjalëshin *ne europeanët* (Gorbachov: 1987: 195).

Po si, apo pse ndodhi ky ndryshim i Gorbaçovit, i cili, pavarësisht individualitetit, ishte gjithsesi një prodhim i shkollës sovjetike?

Është e qartë se Gorbacov-i erdhi në pushtet me një synim reformator: ai kërkonte të shmangte kolapsin e sistemit komunist duke ia hapur atë vizionit të tij personal të Leninizmit, një sistem më plural duke përfshirë inteligjencian në kombin politik (Roberts, 1999: 758).

Sekretari i parë sovjetik kërkonte dalje nga një komunizëm në tjetrin, ose në një formë më të butë e më të hapur të tij. Më shumë se kaq, shefi i botës komuniste po pranonte se perandoria ideologjike kishte dështuar, ekonomikisht dhe politikisht. Ajo nuk kish te mundësuar as shoqërinë pa shtet të komunizmit shkencor, dhe as mirëqenien materiale.

Me anë të Bashkimit Sovjetik, një tjetër historian përpiket ta shpjegojë të gjithë botën komuniste, hapësirën që u ishte nënshkruar ideve, dështimin e të cilave po pranonte, pas 70 vitesh provash fatkëqija Gorbaçovi. Sipas tij, ‘shteti sovjetik mbante çelësat të cilat mund të shkyçnin dyert përgjatë gjithë Europës Lindore. Nëse BS pushonte së qeni komunist, ishte e qartë se shpresat e mbijetesës së komunizmit në të gjitha vendet e Traktatit të Varshavës ishin minimale’ (Broën, 2009: 556)

Ronald Reagan, ai që e kish etiketuar si *perandori të së keqes* hapësirën gjeografike e politike që udhëhiqej nga Gorbacov-i, ishte Presidenti i Amerikës që prej vitit 1981. Një konservator i partisë Republikane, Reagan-i konsiderohet si një prej atyre që kanë ndikuar më shumë në rrëzimin e komunizmit. Gara e armatimeve, Strategic Defense Initiative, e pagëzuar Star Ëars nga media, që ai nisi me Bashkimin Sovjetik, çoi në

dobësimin ekonomik të perandorisë së majtë. Ishte Reagan-i që kërkoi të kundërtën në fund të viteve '80: nga gara e armatimeve u kalua në sfidën e çarmatimit.

Reagan-i e pati të dyfishtë fitoren: ai u fut në Shtëpinë e Bardhë në një Amerikë të flashkët ekonomikisht, gjendje e cila ndryshoi falë edhe injektimit të politikës së taksave të ulta që i dha krahë sipërmarrjes dhe rriti shpenzimet. Mandatin e dytë presidencial Reagan e fitoi me një përqindje të votës popullore të pahasur më parë apo më pas në zgjedhjet amerikane. Në nder të tij paketa stimuluese që nxori ekonominë nga zbatica u quajt *Reaganomics*³. Ai erdhi në Shtëpinë e Bardhë në mes të krizës së pengjeve të Iranit dhe u largua me Bashkimin Sovjetik dhe komunizmin të gjunjësuar.

3.3 Dekada e Thatcher-it

Kur Friedrich Hayek, ekonomisti liberal, doli nga nga zyra e kryeministres britanike, Margaret Thatcher, tha: *she's beautiful*⁴. Thatcher u kish dhënë ndërkohë anëtarëve të kabinetit librin e Hayeck-ut *The Constitution of Liberty* për ta përdorur si filozofi të qeverisjes Konservatore.

Ylli i madh i Thatcher-it megjithatë po zbehej në fund të viteve '90, edhe pse ajo i kishte dëshmuar, si kombit britanik edhe botës, me qëndrimet ndaj sindikatave vendase apo dhe në krizën e ishujve Falkland, një talent dhe forcë politike të pahasur që nga koha e Ëinston Churchill-it.

³ *Reaganomics*: një term popullor i përdorur si referim për politikën ekonomike të Ronald Reagan-it, të cilat u prirën nga ulje e gjerë taksash, ulje të shpenzimeve sociale, rritje të shpenzimeve ushtarake dhe dërrgullim të tregjeve të brendshëm.

⁴ Donald Frost, këshilltar i Margaret Thatcher: Fjala në Rrethin Liberal të Dardhës, tetor 2015. Marrë nga arkivat e Fondacionit për Liri Ekonomike.

Ashtu si Churchill-i ‘lideri që kish fituar luftën, por kish humbur zgjedhjet e pasluftës’, ajo nuk mund t’i ikte këtij fati. Siç vërehet me të drejtë ‘as Adenauer-i e as De Gaulle-i nuk i kishin shpëtuar kësaj sindrome historike’ (Laker, 2003: 384). Nga fundi i vitit 1990, Thatcher-i u shkarkua nga partia e vet për t’u pasuar në postin e kryeministrit nga John Major. Laburistët nuk do të vinin në pushtet edhe për thujtë dy mandate të tjera, deri në vitin 1997, nën drejtimin e Tony Blair-it, i konsideruar një ‘thatcherist’.

Theksi antikomunist i kohës vinte edhe falë profilit të Zonjës së Hekurt të 10 Downing Street. Me Reagan-in në Amerikë, Kohl-in në Gjermani dhe Papën Gjon Pali në Vatikan, ata u bënë katërshja vendimtare Konservatore, jo spektatorët, por protagonistët e rrëzimit të *perandorisë së kuqe*.

I tillë kish qenë ndikimi i Margaret Thatcher:

Në programin e ri të Laburistëve, të publikuar në maj të vitit 1990, lexuesit duhet të nxirrin sytë për të gjetur të paktën një herë fjalën “socializëm”. E tepërt të thuhet, jo të gjithë Laburistët kishin përkrahur idenë e një partie me të vërtetë popullore; disa shanë: “tradhti” dhe nuk ishte aspak e sigurt se mendësia e re do të mbijetonte kur Laburistët të rimerrnin pushtetin. Në retrospektivë, si të miqtë, ashtu dhe tek armiqtë nuk kishte dyshim: udhëheqës të tjerë europianë kishin ardhur e kishin ikur, por vitet ’80 kishin qenë dekada e Thatcher-it. (Laker, 2003: 385).

3.4 Lindja komuniste në fund të eksperimentit

Me përjashtim të Shqipërisë, njëfarë eksperimenti më vete në laboratorin ideologjik të socializmit botëror, vendet e Europës Lindore kishin ekzistuar si satelitë të Bashkimit Sovjetik. Regjimet në Varshavë, Sofje, Bukuresht, Pragë, Budapest ishin kukulla, fijet e të cilave drejtoreshin në Moskë. Përpyekjet për dalje nga kontrolli kishte patur dhe në çdo rast të shtypura pa mëshirë: Budapesti më i përgjakshmi, dhe Praga më fatkeqja.

Si e tillë, gjendja e artikulon vetë pyetjen, kush ngre kokë i pari? Polakët përmenden në krye, nga disa studiues, si shkëndija e parë dhe më e fortë e ndryshimit në Europën Lindore. Sipas njërit prej tyre polakët filluan të silleshin sikur jetonin në një vend të lirë (Ash, 1991: 42).

Një tjetër identifikon një përmasë shpirtërore të polakëve si çelësin që dekodon arsyet se pse ata i prinë apo i bënë dritë të parët ndryshimit të madh. “Në një shkallë të admirueshme polakët e kishin ruajtur integritetin e tyre patriotik duke ndjekur priftërinjtë, jo sunduesit e tyre” (Roberts, 1999: 754).

Ngado kthen kokën dhe vështron mbi ngjarjet, sheh se shpirtërorja, siç ishte rasti i Polonisë, apo ndonjë tjetër, ndërthuret diku dhe dikur me materialen. Një përpjekje e qeverisë polake për të rritur çmimin e mishit ngriti në këmbë punëtorët e udhëhequr nga Solidarnosti, lëvizja e Sindiktave që ishte bërë që në fillim të viteve '80, një pikë referimi për pakënaqësitë dhe shpresën e ndryshimit në të njëjtën kohë.

Grevat u përhapën me shpejtësi në mbarë Poloninë; brenda pak muajve Solidarnosti kishte dhjetë milionë anëtarë, pra, shumica e popullsisë së aftë për punë të Polonisë ishte bashkuar me të. Qeveria e Gierkut hyri në bisedime me grevistët, dhe u arrit një marrëveshje sipas së cilës do të garantohej furnizimi me ushqime, do të futej java pesëditore e punës dhe do të kryheshin reforma të thella ekonomike e politike. (Laker, 2003: 430).

Historia, siç është provuar shumë herë, kur vihet në lëvizje nuk di të ndalet më. Grevat, rezistenca, vetëdija e ndryshimit dhe vetë koha prodhuan faktin: Les Valesa, udhëheqësi i Solidarnostit, në dhjetor 1990, u bë president i Polonisë. Vendi i Papa Gjon Palit priste bashkëvuajtësit e tjerë të Lindjes komuniste të Europës që t'i bashkoheshin korit të lirisë.

Në tetor 1989, Gorbacovi vizitoi Berlinin lindor me rastin e 40 vjetorit të themelimit të Republikës Demokratike Gjermane. Në një fjalim ceremonial, por më shumë politik, shefi i komunizmit botëror foli për rendin aktual në Europë duke theksuar se, sa herë Perëndimi është munduar ta lëvizë hartën kjo e ka përkeqësuar situatën ndërkombëtare (Schmemmann, 1989: 5).

Gorbaçovi nuk dinte dy gjëra atë ditë: Vizita e tij ishte e fundit e një shefi komunist sepse nuk do të kishte përvjetor të 41-të të RDGj, dhe katër javë më vonë Muri i Berlinit do të shembej duke e ndryshuar njëherë e mirë hartën e Europës. Pa sjellë ndonjë implikim ndërkombëtar, siç ai parashikonte, por një rivendikim historik. Kombi gjerman do të bashkohej një vit më vonë në tetor 1990.

Ndryshimi kishte ardhur më shpejt dhe përtej parashikimit më optimist. Në harkun e një viti kishte ndodhur rrëzimi i Murit, dorëheqja e Hoeneker-it dhe ribashkimi i Gjermanive. Tre muaj para se të niste gjithë ky ortek i historisë ...

në verën e 1989, autoritetet komuniste të Moskës dërguan një emisar të lartë, Falinin, ish-ambasador në Gjermani, për të tërhequr vëmendjen e krerëve të Berlinit Lindor se gjërat nuk ishin aq qetë poshtë sipërfaqes. Byroja Politike e Gjermanisë Lindore e siguroi Kremlinin se gjithçka ishte nën kontroll dhe se nuk kishin nevojë për ndihmë. Disa muaj më vonë ata nuk ishin më në pushtet dhe shumë prej tyre ishin arrestuar (po aty: 436).

Efekti i jehonës e bëri punën e vet: revolucion i sukseshëm në Poloni dhe Gjermaninë Lindore i dha krahë opozitave në vende të tjera të Europës Lindore për tu ngritur kundër tiranisë. Ndihte edhe faki që edhe Politburotë komuniste e kishin humbur vetëbesimin. Në të gjitha kryeqytetet e Europës Lindore, përjashto nga kjo Bukureshti dhe Tiranën, udhëheqja e vjetër u dorëzua pa shenja të qëndresës ku përllogaritet edhe dhuna. Në Rumani, Securitate, ende një organ i fuqishëm i represionit bëri mësymjen e vet, por as përgjakja që do kulmonte me vrasjen nga turmat të Çausheskut dhe gruas së tij Elena, nuk e ndali dot atë që do vinte në formën e ndryshimit.

Laker e veçon Bullgarinë si ‘i vetmi vend i bllokut lindor që përjetoi një “revolucion nga lart” të tipit të vjetër, domethënë një puç të organizuar nga anëtarët e Byrosë Politike kundër njeriut që kishte drejtuar Bullgarinë për tridhjetë e pesë vjet’. Teodor Zhivkovi u ndal në habi kur më 10 nëntor 1989, në një mbledhje të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bullgare, një prej shokëve lexoi tekstin e asaj që u bë publike si dorëheqja e tij. Kortezi nuk munguan dhe anëtarët e Politburosë e falenderuan Zhivkovin për shërbimet ndaj popullit, partisë dhe Bullgarisë. Qershori 1990 ishte hera e parë e zgjedhjeve të lira në Bullgari që pas ardhjes në pushtet të komunistëve. Partia Komuniste, e shndërruar në Socialiste, mori 47 përqind të votave, mjaftueshëm për të siguruar shumicën parlamentare dhe për të mbajtur edhe një herë pushtetin në Bullgari. Qytetet e mëdha, përfshirë Sofjen, e lëkundën mazhorancën e ish-komunistëve, por votat e fshatit u mjaftuan për rikonfirmimin në pushtet. E njëjta gjë do të ndodhte edhe në Shqipëri në zgjedhjet e 31 marsit 1991.

Hungarezët shkuan gjithashtu në zgjedhje të lira dhe votuan për Arpad Gonz një ish disident, anëtar aktiv i revoltës së përgjakshme të vitit 1956, i burgosur për 6 vjet duke i shpëtuar një vendimi me burgim të përjetshëm. Ai u zgjodh kryetar parlamenti dhe president i Hungarisë. Zgjedhjet e vitit 1990 ishin të ashpra, por dy partitë kryesore u treguan të gatshme të bashkëpunonin.

Çekosllovakia u përfshi gjithashtu nga vala marramendëse e ndryshimeve. Në fjalët e e Vaclav Havel-it para një turme prej dyqindmijë vetësh: “Një ditë historianët do t’i quajnë këto ditë të jashtëzakonshme”. Në vitin 1990 ai erdhi në krye të vendit si president.

Jugosllavia ishte një tjetër histori. Ndryshimet e atjeshme ishin më të hershme krahasuar me të gjitha vendet e Europës Lindore. Nën lidërshtipin e Titos, republika federative ku bënëin pjesë serbët, kroatët, sllovenët, boshnjakët, maqedonasit, malazezët dhe shqiptarët me krahinë autonome të Kosovës, ishte pjesë e *aleancës së vendeve të paanagazhuara*, një *melting pot* i çuditshëm shtetesh që reklamnin se, nuk ishin as me Lindjen komuniste dhe as me Perëndimin kapitalist. Duke qenë vend më i hapur, që lejonte lëvizjen e lirë dhe tregtinë, disa reforma ishin kryer gjatë kohës së Titos e të tjera më pas. Megjithatë, vitet '89, '90 dhe 91, atë që vendeve të tjera të Lindjes ua sollën në formën e kërkesave për liri e demokraci, Jugosllavinë e ndeshi me ankthin dhe përgjakjen e separatizimit.

Protestat në rajonin e Kosovës vazhduan; në Mal të Zi u përmbys udhëheqja e partisë si pasojë e pakënaqësisë popullore. Mbi të gjitha, tensionet ndërmjet Serbisë dhe republikave të tjera u bënë më intensive. Sllovenia shpalli se do të largohej nga Federata jugosllave dhe në Kroaci, pas zgjedhjeve të marsit 1990, fraksioni antiserb u fuqizua. Sllovenia dhe Kroacia zgjodhën opsionin e ekonomisë së tregut dhe të sistemit shumëpartiak. (po aty: 453).

Copëtimi i Jugosllavisë ndodhi brenda pak muajve të vitit 1991. Të parët u shkëputën 'republikat katolike' të Sllovenisë dhe Kroacisë; e para në paqe, e dyta me luftë. Fati i ngjarjeve të asokohe dhe më vonë në ish-Jugosllavi lidhen me profilin dhe karakterin e Slobodan Milosheviçit. Dëshmi e kësaj u bë Bosnja dhe më pas Kosova.

3.5 Shqipëria: një revolucion pa autorë?

Autorët e huaj janë të kursyer, madje mund të thuhet se e shpërfillin Shqipërinë në studimet e tyre kur shkruajnë për ndryshimet në lindje të kontinentit të vjetër. Njëri prej tyre e përmbledh me tri fjali kronikën e ngjarjeve që i dhanë fund regjimit komunist në Shqipëri:

Nga mesi i vitit 1990, në Tiranë u zhvilluan demonstratat e para masive antiqeveritare. Ato u përhapën pavarësisht nga reformat politike të filluara nga presidenti (dhe drejtuesi

kryesor i partisë) Ramiz Alia. Në fillim të vitit 1991, Shqipëria ishte në një gjendje kaosi dhe mijëra qytetarë largoheshin nga vendi (Laker, 2003: 442).

Një tjetër është edhe më i kursyer duke u mjaftuar me një fjali: *më 20 shkurt 1991, studentët protestues në kryeqytetin e shqipërisë, Tiranë, rrëzuan satujën e ish-udhëheqësit komunist, Enver Hoxha (Gilbert, 2001: 621).*

Samuel Huntington te *Vala e tretë dhe Përplasja e qytetërimeve* e përmend vetëm si emër Shqipërinë: një herë duke e përqasur me zhvillimet në Rumani, dhe një herë tjetër sa për ta futur në listën e vendeve të ‘qytetërimit islam’.

Kjo ngjan me shmangien që i bëhet Shqipërisë në kronikat meteorologjike të televizioneve europiane: askush nuk e di apo nuk don ta dijë se çfarë ndodh në vendin e vogël ballkanik.

Mbeten kësisoj dy lloje burimesh të tjera: gazetarët e huaj dhe autorët vendas, të cilët ose kanë qenë kronikanë të periudhës 1990-1992 në Shqipëri, ose protagonistë të saj. Ka gjithmonë edhe të tjerë, siç është rasti i një çifti mësuesish francezë, Elizabet e Pol Shanse të cilët jetuan në Shqipëri ndërmjet viteve 1982-1988 si pjesë e një programi shkëmbimi arsimor midis Francës e Shqipërisë. Kronika e tyre për kohën jep një Shqipëri të zymtë, pothuajse në depresion: sulmin vendimtar kundë regjimit do ta kryejnë të rinjtë-65 për qind e popullsisë është më pak se 30 vjeç-e në mënyrë të veçantë studentët.

Më tej autorët bëjnë një dokumentim të përmbledhur të ngjarjeve duke futur në kronikën e revolucionit intelektualët (Sali Berisha, Gramoz Pashko, Besnik Mustafaj), punëtorët e Tiranës dhe të rretheve (Shkodrës etj), por edhe fenë duke përmendur mbrëmjen e Krishtlindjes së vitit 1990 në varrezën e Rrmajit në Shkodër (Shanse, 2000).

Një historian bashkëkohës italian, njohës i mirë i Shqipërisë, ka bërë një ekskursion analitik dhe studimor në ngjarjet e Ndryshimit të Madh në Shqipëri. Ai identifikon fatlumësinë e një kalimi pa gjak nga një sistem në tjetrin si dhe krediton autorët e këtij tranzicioni paqësor.

Kalimi politik nga një komunizëm stalinian, i pandryshuar që prej vitit 1944 deri më 1990 dhe që në Shqipëri mbështetej, sikurse dihet, mbi baza nacionaliste, tek një demokraci parlamentare pluripartiake u krye me shpejtësi të madhe. Dhe pa gjakderdhje. Kemi të bëjmë me një ngjarje të jashtëzakonshme, në rast se do të mbahen parasysh vuajtjet e shkaktuara nga regjimi i Enver Hoxhës dhe njëkohësisht tradita e gjakut dhe e hakmarrjes, që shquan normat zakonore shqiptare. Ky kalim mund të kishte ndodhur në një mënyrë tjetër, tragjike. Një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve kishin qenë viktimë e diktaturës, ndërsa një pjesë tjetër gjithashtu e konsiderueshme kishte pasur sukses ose kishte bashkëpunuar me autoritetet, policinë, Sigurimin. Merita për një kalim të tillë paqësor drejt demokracisë u takon padyshim dy kundërshtarëve politikë në këtë fazë historike, Ramiz Alisë dhe Sali Berishës, të cilët u shtrënguan të tregojnë guxim për të përmbajtur ithtarët e zgjidhjeve të dhunshme (Della Rocca, 2000: 24).

Është domethënës fakti se ashtu si Drakuliç, një kroate, edhe della Rocca, një italian, identifikon mungesat apo dëshirimet materiale si shkaktarë të përmbysjes. Ai i shton kështu katërshes rini, *intelligentsie*, klasë punëtore, religjion, edhe televizionin, më saktësisht atë italian. Disa, mund të shohin te kjo një *qasje imperialiste* të llojit ‘indiani dhe pasqyrat e kolonizatorit’. Por ai e arrin këtë përfundim duke cituar edhe dy autorë shqiptarë, Rando Devolen dhe Ardian Vehbiun.

Në rastin e Shqipërisë vetë rënia e regjimit të vjetër stalinist shkaktohet jo aq nga vala e fuqishme e perestrojkës së Gorbaçovit sesa nga soditja e përditshme e “parajsës” kapitaliste përmes televizionit italian, i cili shkallmon zyrtarinë e rëndë të autarkisë. Fundi i komunizmit në Shqipëri nuk ndodh aq për shkak të shpërthimit nga brenda sesa falë ndriçimit, kuptohet, atij televiziv.

Një tjetër studiuese, hedh hapa të sigurt për të piketuar pikërisht pasiguritë që lidhen me tranzicionin dhe atë që ka ndodhur gjatë tij. Ose më saktë për të përkufizuar tranzicionin, një lloj ure sociale, nga një periudhë te tjetra që ë duket pothuajse i papërkufizueshëm. Ajo e krahason me një udhëtim në labirint procesin e tranzicionit që ndodhi në Shqipëri përgjatë viteve ’90.

Evokimi i tranzicionit është shpesh një startegjemë për të shmangur ambiguitetet dhe kontradiktat që përfshijnë të gjitha tranzicionet nga diktaturat drejt një modernizmi gradual, dhe Shqipëria nuk ka qenë përjashtim. Tranzicionet ndërtojnë një konstelacion praktikash dhe kuptimesh shpesh kontradiktore rreth aktorëve socialë të përfshirë: prandaj edhe perceptimi i të humburit në labirint, i cili pas kolapsit të një utopie politike e karakterizuar nga kontrolli shoqëror total, fare mirë mund të prodhojë ankth (Pandolfi, 2002: 206).

Ajo përmend jo vetëm tranzicionin, por edhe aktorët socialë të përfshirë, pra protagonistët. Duhet qartësuar një gjë për qëllimet dhe fokusin e këtij punimi, i cili shqyrton një periudhë të shkurtër kohore ‘90-‘92 dhe jo të gjithë shtrirjen e tranzicionit në Shqipëri, që për shumë vëzhgues vazhdon ende. Rrjedhimisht të folurit për aktorë socialë nga largësia e viteve edhe përthyerja e ngjarjeve, me të drejtë, siç pohon studiuesja që këtu shqyrtojmë, prodhon ankth.

Ankthi kërkon edhe një lloj rivendikimi i cili në Shqipëri kthehet dhe rikthehet çdo dhjetor. Libra, analiza, komente, intervista dhe deklarata nga politikanë, dhjetoristë, militantë politikë apo socialë rreken të krijojnë një reliev tjetër të Dhjetorit.

Një komentator politik, e etiketon si false gjithë atë që quhet Lëvizje e Dhjetorit:

Kemi 24 vjet që e shohim këtë teatër të dyfishtë, ku dhe për ironi kemi një festë zyrtare, për një nga skenarët më falsë të Historisë më të Re të Shqipërisë. Jo se kjo që po them është një gjë e re, por rraskapitja e kësaj parade kukullash dhe marionetash, që u kurdisën nga zyrat e Komitetit Qendror të Partisë së Punës, kjo rraskapitje pra është shndërruar në një neveri çoroditëse që duhet të mbyllet (Zheji, 2014: 11).

Albert Nikolla, antropolog (2015: 11), e pranon këtë rikthim të Dhjetorit në aulat e opinionit publik, më shumë si thashethem pasi, sipas tij, asgjë nuk do të ndryshojë në atë që ai quan bosht të tranzicionit shqiptar. Ai shton se ngjarjet e 25 viteve i kanë qartësuar qëllimet politike të atyre që themeluan PD-në dhe ka pak ose aspak hapësirë për hipoteza të reja.

Përplasja e ideve ndodh për dy arsye: e para është një përpjekje për të rishkruar historinë dhe, e dyta nëpërmjet këtij rishkrimi të bëhet edhe rivendosja ose rishpikja e

protagonistëve. Kjo, sigurisht, e tejkalon edhe tranzitologjinë edhe qëllimet e këtij punimi. Për t'iu kthyer atyre duhet rënë në një kompromis i cili e shpërndan, nuk e përqendron historinë. Është ajo që thotë studiuesi J.M. Roberts për të përshkruar revolucionet në të gjithë Europën Lindore, i cili i shkon edhe Shqipërisë:

Revolucionarët e vitit 1989 përbënin një kategori të përzier. Mes tyre kishte komunistë reformatorë, shumë antikomunistë, të krishterë, studentë, punëtorë, anëtarë të pakicave kombëtare të persektuara, gjithashtu edhe njerëz që asnjëherë më parë nuk kishin marrë pjesë aktive në politikë.

3.3.1 Kujtimet si rinivlime të tranzicionit

Ramiz Alia është një prej aktorëve kryesorë të periudhës të cilën ky punim ka në fokus. Si udhëheqës i Partisë së Punës dhe si trashëgimtar i drejtpërdrejtë i Enver Hoxhës dhe regjimit të tij, Alia kishte në dorë 'edhe gurin edhe arrën'. Më shumë se vendosmërinë për të vepruar qartazi, udhëheqësi komunist zgjodhi një politikë të tërhequr duke pritur që ngjarjet të shpaloseshin dhe jo të konturoheshin prej aksioneve të tij. Te 'Kujtimet', ku koha e 'shndërrimit shqiptar' zë një kapitull të veçantë, ai e pranon këtë 'tërheqje', siç pranon edhe nevojën e ndryshimeve kur shkruan se hapat duheshin hedhur me kujdes.

Ai e kupton këtë ndryshim, apo procesin e ndryshimeve, brenda një strukture të vjetër që, sipas tij, duhej udhëhequr nga Partia e Punës dhe madje, përdor një term që e kishin për zemër të gjithë besnikët e Hoxhës 'vazhdimësinë'.

Pasuesi i Hoxhës me fjalët e veta fut në këtë proces 'vazhdimësie' jo vetëm zhvillimet e brendshme, por edhe ato ndërkombëtare.

Nevoja e ndryshimeve në Shqipëri, në vitet '80-të, nuk kushtëzohej vetëm nga gjendja e brendshme. Ajo lidhej, bile në një masë shumë të madhe përcaktohej, edhe nga zhvillimet në situatën ndërkombëtare. Dihet se nga viti 1988-1989, Bashkimi Sovjetik dhe të gjitha vendet ish-socialiste të Evropës Lindore, u përfshinë nga një valë e ndryshimesh, të cilat

prekin drejtpërsëdrejti thelbin e sistemit ekzistues. Ky proces, nxitej dhe ishte rezultat i përpjekjeve që kapitalizmi botëror, bënte prej kohësh dhe në vazhdim, për të shkatërruar socializmin si sistem (Alia, 2010: 322).

Në nivelin e komunikimit politik, Alia vë përballë dy propaganda, kapitalisten e cila shpiku edhe atë që ai quan ‘parullë’, *dominoja e fundit*, dhe një ‘qëndresë’ të kampit socialist. Kujtimet, këtu të shqyrtuara, i përkasin vitit 2010, pra njëzet vjet pas ndryshimeve që përfshinë, edhe pse të fundit, Shqipërinë. Pavarësisht distancës perspektiva e Alisë mbetet e pandryshueshme: nomenklatura punonte për ta ruajtur socializmin, pra për një *make up* mbi kufomën e një rendi që e kish shpallur falimentin, dhe jo ceremoninë mortore.

Ndryshimet, në fjalët e Alisë, duheshin bërë për ta shpëtuar socializmin nga rreziku që po e kërcënonte. Alia përmend përpjekjet e regjimit për një perestrojkë shqiptare, të paktën në ekonomi, të tilla si *privatizimi i artizanatit, të tregtisë dhe të shërbimeve*.

Këto lëvizje, që mund të quhen përpjekje për t’i dhënë socializmit një fytyrë njerëzore, pasohen me masa të tjera të drojtura apo gjysmake, të cilat pasqyrojnë jo vetëm pasiguritë e kohës, por edhe të nomenklaturës komuniste. Një prej tyre është çka Alia quan *gjallërimi i pluralizmit të mendimit*. Qartësisht, shumësia e mendimeve nuk do të thotë e alternativave sepse po aty ai citon miratimin e një vendimi të posaçëm të KQ të Partisë për *mbledhjet e hapura të organizatave bazë të partisë*.

‘Hapja’ e regjimit shoqërohet edhe me anulimin e nenit 55 i cili për dekada me radhë kishte shërbyer si pritë për çdo kritikë ndaj punëve të partisë në pushtet apo udhëheqësve të saj, dhe kishte ndaluar çdo manifestim pakënaqësie apo protestë, sado modeste. Alia e pranon se edhe shprehja e pakënaqësisë shihej si propagandë kundër ‘pushtetit popullor’. Atë që udhëheqësi i fundit komunist në Shqipëri e konsideron

hapje, lëshim, apo ndryshim, mund fare mirë të kategorizohet si dalje nga një gjendje *ad absurdum*.

Edhe pse artikulon shpesh nevojën dhe termin e ‘pluralizmit të mendimit’, Alia i shmanget një tjetër të drejte të njeriut, lirisë së lëvizjes, të paktën si terminologji, edhe pse ai citon anulimin në Kodin Penal të neneve që kalimin e kufijve e konsideronin ‘tradhti ndaj atdheut’, shoqëruar me 10 vjet burg e persekutim të familjarëve të të arratisurit. Anulimi i nenit, megjithatë, nuk do të thotë automatikisht edhe i aktit. Disa autorë (Mustafaj, Kadare etj.) flasin për të vrarë të tjerë në kufijtë e Shqipërisë edhe pas shfuqizimit të ‘nenit të tradhtisë’. Kjo përplasje e faktit me diskurin dëshmon jo drojën e ndryshimeve, sa frikën prej tyre, pse jo edhe atë se komunizmi shqiptar, edhe pse ‘i zbutur’ nga Alia nuk ishte gati të dorëzohej.

Prudencën, që Alia e shpall si teori politike, dhe si pjesë të ligjërimit politik, e mbështet edhe te një autoritet i huaj, një ‘arbitër’ apo ‘palë e tretë’ e kohës, Sekretari i Përgjithshëm i OKB, Perez de Kuelar, i cili e vizitoi Shqipërinë në vitin 1990. Është interesante se si Alia përmend zhvillimet në Bashkimin Sovjetik dhe në Lindje, pra te satelitët e komunizmit, si dhe trysninë e kapitalizmit me në krye Amerikën. Kuelari dhe OKB i shërben në këtë rast udhëheqësit komunist shqiptar si ‘rrugë e tretë’, një lloj kamerdareje për të përligjur mungesën e reformave në terma të vetëpërmbytjes.

Perez de Kuelar, duke përshëndetur këto veprime, më theksoi nevojën e ecjes graduale, sepse, siç tha ai, në vendet e tjera të Lindjes kanë dalë probleme të mëdha nga nxitimi, probleme ekonomike, politike e sociale, për të mos përmendur ngjarjet tragjike të Rumanisë. Krejt e kundërt, ishte nxitja që vinte nga qarqe të ndryshëm politike të Perëndimit, sidomos nga SHBA. Ata nuk e dëshironin strategjinë e gradualitetit. Propaganda që bëhej në drejtim në Shqipëri, nxiste që proceset e filluara në Evropën Lindore, të përfundonin sa më parë edhe në vendin tonë, pavarësisht nga çmimi (Alia, 2010: 325).

Alia nuk flet vetëm për ‘vetëpërmbytje’, por edhe rrethanat lehtësuese të asaj çka ai parapëlqen t’i referohet si pluralizëm i ideve. Është koha kur ‘ngjarjet i paraprinë

vendimeve’, siç shkruan vetë, dhe pjesë e ngjarjeve u bënë edhe qëndrimet e intelektualëve shqiptarë, disa prej të cilëve janë shprehur me artikuj e intervista në gazetat kryesore të kryeqytetit. Udhëheqësi i partisë së vetme në vend, që fliste për pluralizëm mendimesh në kohën kur pluralizmi partiak kish mundësuar garën mes forcave kundërshtare gjetkë në Lindje, ideon një takim me intelektualët. Si rrethanë lehtësuese ai përmend organizimin e takimit, jo në zyrat e KQ të Partisë, por në Pallatin e Kongreseve. Interesant është fakti se Alia pretendon neutralitet për një vend emri i të cilit zbulon qëllimin dhe frymën: Pallati në fjalë, i quajtur ‘i Kongreseve’, u ndërtua për kongreset zhurmëmdha të partisë, shumë prej të cilave shërbenin edhe si nismëtare apo certifikuese të purgave staliniste të Enver Hoxhës.

Në këtë takim me intelektualët, ku ishin të pranishëm edhe disa prej atyre që do të parcaktonin tonin e pluripartizmit që po mendohej të shmangte udhëheqja komuniste, ndër ta edhe Sali Berisha, Alia formulon edhe mungesat e kushteve për legalizimin e partive të tjera rivale të PPSH. Ndër to, kultura e nevojshme demokratike, toleranca, durimi dhe respekti, si elementë të domosdoshëm për një shoqëri me shumë parti.

3.3.1 Katovica, konspiracion në vend të teorive

Servet Pëllumbi, një prej katër nënkryetarëve të Partisë Socialiste, pak pasi ajo ndërroi emrin nga Parti e Punës, dhe pas burgosjes së kryetarit Fatos Nano, mbështet një ‘teori’ tjetër të ‘shndërrimit’. Megjithëse duket sikur në faqet e librit *Përmbysja e komunizmit* (2015) elaboron një kalim gradual, teza që e bind më shumë është *katovicizmi*.

Ky term lidhet me një mbledhje të hamendësuar nga e cila ka dalë një dokument i quajtur ‘i Katovicës’ emri i një qyteti në Poloni. Dokumenti, inekzistent sa kohë nuk

gjendet në asnjë arkivë, dhe as ka një dëshmi të dorës së parë për të, është ngarkuar me peshën e një komploti të komunizmit botëror me qendër në Moskë për të vazhduar me kontrollin në zonat e influencës. Katovica është në njëfarë mënyre një marrëveshje e Jaltës 2, por pa pjesëmarrjen e perëndimorëve. Teoritë konspirative flasin për vendimin e krerëve komunistë, të udhëzuar nga Gorbaçovi, për ta lëshuar pushtetin politik (përkohësisht) dhe për të marrë në dorë frenat e pushtetit ekonomik.

Lëshimi i pushtetit politik, vazhdon konspiracioni, është gjithsesi i pjesshëm duke qenë se partitë e reja politike opozitare që do të lejohen të formohen në Lindje do të drejtohen nga besnikë apo ish-anëtarë të partive të vjetra.

Servet Pëllumbi, zgjedh këtë qasje, nga pozitat e një ‘tranzitologu’, për të interpretuar zhvillimet politike e sociale në Shqipërinë e dy dekadave të paskomunizmit.

Një parabolë e tillë duket se rrotullohet mes ngushëllimit ideologjik (komunizmi nuk ka humbur përfundimisht, ai është shndërruar në diçka tjetër), aq edhe pështjellimit konspirativ (pushteti jashtë nesh është dyfish i paarritshëm për masat).

Autorë të ndryshëm, siç do ta shohim më poshtë, e kundërshtojnë këtë tezë, edhe pse silueta e saj është hasur më shpesh në shtypin periodik se sa në studime, përjashto këtu rastin e Pëllumbit. Një prej tyre, historian, e shfuqizon një qasje të tillë si depersonalizuese të përgjegjësive.

Ata që kanë pasur pushtetin, thotë fabula, kanë plaçkitur e kanë keqqueverisur jo se kanë qenë të paaftë, injorantë, a të rrezikshëm, por sepse kanë qenë pjesë e një plani të madh djallëzor ndërkombëtar. Kështu, përgjegjësia depersonalizohet. Kur të tërë janë pjellë e një plani djallëzor ndërkombëtar, asnjë nuk mban përgjegjësi për asgjë. Prapësitë shqiptare, për më tepër, humbasin nën vallon e errët të një bote sekrete aparatçikësh komunistë (Mëhilli, 2013: 8).

Ardian Vehbiu mohon, si një dokument të Katovicës shqiptare, ashtu edhe një mbledhje të Katovicës. Ai i ndan në dy grupe ‘entuziastët e Katovicës’, në konspiracionistë teorikë dhe në mashtrues të rëndomtë⁵.

Pëllumbi i cili duket se nuk mund t’i përkasë asnjërit prej grupeve që përmend Vehbiu, ndoshta i përket një grupi të tretë, i cili mund të etiketohet si *delegjitimues i kundërrevolucionit të 1991-it*. E vetmja referencë për të ashtuquajturin dokument të Katovicës që Pëllumbi përmend, është një letër që Gorbacovi i ka dërguar Alisë ku i thotë se sistemi dështoi dhe të merrën masa që të bëhet kthesa. ‘Arkiva’ nga nxirret ky ‘dokument’ është një intervistë e ish-sekretarit të Alisë, Guro Zeneli, dhënë gazetës SOT të datës 16 janar 2015.

Në një shtysë të dytë, Pëllumbi flet sërish për lidhjet e ngjarjeve me dokumentin ende të pazbuluar të Katovicës. Ai përmend një mbledhje të 19 dhjetorit 1990 të Ramiz Alisë me sekretarët e parë duke riprodhuar këtë bisedë të shefit komunist me vatësit e tij në rrethe.

E dëgjuat lajmin për legalizimin e PD-së? Ajo parti është djall që do të shkatërrojë idealet socialiste. Por nuk do ta lejojmë. Partia e Punës ka dalë nga zjarri i luftës. Ka kockë të fortë. Prandaj do të hidhemi në sulm. Që sot. Të shkoni në rrethe. Do të keni punë me regjistrat. Jo të gjendjes civile. Regjistrat e bashkëpunëtorëve të sigurimit të shtetit. Do t’i lexoni një për një. Pastaj do t’i thërrisni. Kuptohet në mes të natës, me fshehtësinë më të madhe. Do t’u jepni detyrën të futen në radhët e Partisë Demokratike. Të mbështesin njëri-tjetrin. Informatorët tanë duhet të jenë në komisionet drejtuese. Ata duhet të mbushin listat e kandidatëve për deputetë. Nëse ky aksion përfundon me sukses, dhe suksesi varet nga puna juaj, atëherë Partia Demokratike do të kthehet në një simotër e Partisë së Punës...! (Pëllumbi, 2015: 149).

Studiuesi nuk citon asnjë dokument. Pa një referencë, materiali ngjan me fragment romani.

⁵ Vehbiu, A. (2013, tetor, 19) Katovica e zbardhur. Marrë nga: <http://peizazhe.com/2013/10/19/katovica-e-zbardhur/>.

3.3.2 Tirania e anti-intelektualizmit

Ish-i burgosur politik, pinjoll i një familjeje komuniste të Bllokut dhe autor i *Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare*, tekst që trajton në hollësi ndryshimet dhe zhvillimet e paskomunizmit, e sheh ndër të tjera, si komunikim të ri dhe të ndryshëm, fillimin e dekadës së fundit të shekullit 20 në Shqipëri (Ngjela, 2013: 15). Ai vëren një të folur të re, shfaqjen e konferencës së shtypit dhe marrjen fund të arrogancës së regjimit. Të nivelit komunikativ Ngjela i ka edhe përshtypjet për intervistat e disa prej opozitarëve të parë si Gramoz Pashko, dhe konferencat e shtypit të Preç Zogajt. Të parat i sheh si të vetmet me koncept, ndërsa të dytat si elegante. Kritikën ai e ruan për Sali Berishën një ndërhyrje të të cilit gjatë një konference e konsideron si me preokupim politik komunist⁶.

Raporti i Ngjelës me Berishën ka rezultuar një nga më të komplikuarit në Shqipërinë paskomuniste. Plot ulje e ngritje, me pozicionin e ndryshueshëm të mik-armikut, ky raport shfaqet më shpesh se çdo tjetër në librin e Ngjelës (Ibid). Relievi i raportit të kësaj dysheje mund të përshkruhet nga çka studiuesi Daniel Kahneman quan *hindsight bias*⁷.

Shkruan për një artikull të Berishës të fillimit të vitit 1990:

Kjo e kishte krijuar një aureolë rreth tij, por, po ta shohësh me vëmendje, duhej pyetur që atëherë: si e lejoi censura këtë artikull prej “disidenti”? Por ajo që është me e trishtueshme në këtë fakt është arsyeja tjetër që është edhe më goditëse: asnjëherë Sali Berisha nuk shkroi dot më një artikull si ai që shkroi atëherë. Kurrë nuk diti që ta formojë më atë frazë, atë saktësi gjuhësore dhe atë stil. Sali Berisha realisht nuk di të shkruajë një artikull, prandaj kuptohet se në atë shkrim ai kishte vënë vetëm firmën. Domethënë, njëlloj si

⁶ Ngjela shkruan se episodin e konferencës e kishte parë në televizorin e burgut; vlen të theksohet se libri është shkruar 23 vjet më vonë.

⁷ *Hindsight bias*: shfaqet kur njerëzit ndjejnë se ata “e kishin ditur me kohë”; kjo ndodh kur ata besojnë se një ngjarje është më e parashikueshme pasi të ndodhë se sa para se të bëhej e njohur. Ky fenomen sendërtrohet nga ndërthurja e çdo tre aspekteve: shtrembërim i kujtesës; besimeve rreth gjasave objektive të ngjarjeve; apo besimi subjektiv për aftësitë parashikuese të vetes.

Zhelevi në Bullgari: në momentet kur do të dilte Partia Demokratike, Ramiz Alia e kishte formuar “disidentin Berisha” (po aty: 223).

Asokohe i sapoliruar nga burgu, Spartak Ngjela hedh hipotezën se opozitën shqiptare e kishte krijuar Ramiza Alia në mënyrë që ‘të neutralizonte revolucionin’. Ngjela e ka fjalën për atë lloj revolucioni që çoi në rrëzimin dhe ekzekutimin e Çausheikut në Rumani, fati i të cilit ‘e obsedonte’ Ramiz Alinë.

Ai nuk e përmend Katovicën, siç bën Pëllumbi, por flet për ngjarjet në Bashkimin Sovjetik dhe ndryshimet që Ramiz Alia priste të ndodhnin në qendrën e komunizmit botëror, por pa e faktuar me dokumentacion apo referencë, aludon për një letër të ardhur në adresë të shefit komunist shqiptar nga Sekretari i Parë i Partisë Komuniste të Bullgarisë, në emër të Gorbaçovit, i kërkonte Alisë të ndërmerre disa masa demokratizuese. Shkruan kryekomunisti bullgar në adresë të Alisë me direktivë të Gorbaçov-it sipas Ngjelës: *duhej që të realizonin parimin e nëndetëses. Partia Komuniste duhej të zhytej për ca kohë, dhe të dilte sërish si shpëtimtare e amullisë që kishte pllakosur vendin.*

Ngjela e sheh Alinë dhe partitë e reja opozitare që drejtoheshin nga ish-komunistë si drejtor të një ndërmarrjeje shtetërore të tipit të vjetër të cilat drejtoheshin prej tij. Duke u shfaqur si liberal Alia, sipas Ngjelës, do të gjente para për të garantuar tregun dhe larguar rrezikun e urisë dhe pasi të ndodhte kjo ai do ta ‘centralizonte’ ndërmarrjen e tij.

Ngjela e plotëson hipotezën e vet me anë të Gramoz Pashkos dhe sjell një bisedë me të ku themeluesi i PD-së i ankohet se “Ramiz Alia nëpërmjet Sali Berishës e disa të tjerëve nuk na lë që të hapim dyert e partisë për të djathtën klasike; dhe unë nuk kam forcë që të veprojmë i vetëm”.

Një moment që mund të hedhë dritë mbi pyetjen kërkimore të këtij punimi ‘a është i djathtë komunikimi politik i Berishës?’, është pretendimi i Pashkos se *Saliu ka frikë nga klasa e përmbysur sepse do të kërkojnë ndërrimin e sistemit në funksion të pronës, gjë të cilën ai e koncepton si një përfundim historik.*

Prona private dhe ligjërimi mbi të është një nga provat më të sigurta të hulumtimit të prirjes, së djathtë ose jo, të propapagandës së një udhëheqësi politik në Shqipërinë e dalë nga reforma agrare komuniste, që i shpronësoi fillimisht pronarët dhe më pas fshatarët duke ia kaluar gjithçka shtetit.

Krah për krah me antiberishizmin, Ngjela shtjellon edhe një tezë tjetër, e cila në fakt duket se është kolona kryesore ku mbahet i gjithë libri *Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare: anti-intelektualizmi*. Në librin e tretë, që shqyrton periudhën 1991-1996, autori e lidh anti-intelektualizmin edhe me Berishën duke pikasur një frymë frymëzues i së cilës në Partinë Demokratike të sapoformuar është pikërisht ai dhe duke e lidhur me atë që ai e quan ‘hordhitë e 6 shkurtit’ në jetën politike e kulturore të Shqipërisë.

...brenda këtij konceptimi të situatës enveriste, në lidhje me fluksin që po ndërtonte vetë Sali Berisha brenda Partisë Demokratike, dalloje edhe individë që kishin një ngarkesë deri në urrejtjeje kundrejt intelektualëve; dhe, të shtyrë nga kjo, të gjithë kompleksin e inferioritetit, që kishin kundrejt tyre, e shfrynin me një sens moral, duke i quajtur të gjithë intelektualët e lartë të asaj kohe “shërbyes të regjimit komunist”. Por, e parë në një sens historik, kjo ishte përsëritja identike e asaj që kishte bërë Partia Komuniste kur kishte ardhur në pushtet: të gjithë militantët e saj ishin plot urrejtje inferioriteti ndaj intelektualëve të atëhershëm shqiptarë, dhe, prandaj, të gjithë i quanin ose si agjentë të kapitalizmit të përmbysur, ose mbeturina të borgjezisë, ose bashkëpunëtorë të fashizmit. (po aty: 219).

Si vëzhgues, si ish-i burgosur, por edhe si protagonist i zhvillimeve të asokohe, Ngjela flet për idenë e një alternative të tretë, të cilën frati Zef Pllumi, edhe ai ish-i burgosur, e sheh në formimin e një partie të qendrës së djathtë, të quajtur Partia Popullore fetare. Autorë të tjerë përmendin të njëjtën ide, por me një emër tjetër partia

Kristian Islamike Shqiptare (KIS) duke përfshirë ndër ideatorët edhe Edi Ramën, gjithashtu një i përjashtuar nga zhvillimet në Partinë Demokratike. Një vend i dalë nga një sistem unipolar dhe që po futej me shpejtësi në multipolaritet dukej se i trembej politikës bipolare dhe antagonistë që do të përfshinte së shpejti vendin.

Në një moment ilustrues për historinë e re të një Shqipërie të re që do të quhej *tranzicion*, Spartak Ngjela dhe Fatos Lubonja, të dy ish-të burgosur, të dy trashëgimtarë të nomenklaturës komuniste të humbur në luftën e brendshme, të dy bij partizanësh, bëhen dëshmitarë të një skenë domethënëse.

...ishim duke biseduar në buzë të shkallëve të gjata të Pallatit të Kulturës, kur nga rruga e Durrësit hyri në Sheshin Skënderbe një vargan i gjatë veturash, që bërtisnin me flamuj në duar, dhe me koka të nxjerra nga dritaret e vogla të veturave. Diçka ndjeva menjëherë, dhe prandaj i thashë Lubonjës: “Erdhën partizanët e dytë, o Fatos! (po aty: 284).

3.4 Autoritarizmi vazhdon

Ndërsa autorë të tjerë kanë hulumtuar në periudha më të gjera kohore, duke i shtrirë shqyrtimet që nga viti 1990 e deri në dekadën e dytë të shekullit 21, Preç Zogaj, është marrë me një fragment të vetëm të mozaikut, që ka shërbyer si bazament i gjithë asaj që do vinte më pas e do të konsiderohej si *tranzicioni shqiptar*. Duket se Zogaj ka zgjedhur një teori, dhe jo një paradigmë, siç kanë bërë autorë të tjerë duke e fokusuar lëndën dhe analizën e saj në atë që ai e quan *Fillimet*, term që ka shërbyer edhe si titull i librit.

Për qëllimet e këtij punimi teksti i Zogajt ka disa vlera, edhe pse ai nuk është studim i mirëfilltë, megjithatë konteksti, ngjarjet, përballja e tyre, analiza, njëfarë kritikizmi, sidomos kur ato jepen nga një dëshmitar dhe protagonist i ngjarjeve, janë të rëndësishme, dhe madje thelbësorë për të ndërtuar, jo vetëm profilin historik, politik e

social të periudhës që ky punim merr në shqyrtim, por mund të konsiderohen thelbësore për portretin e politikanit të cilin studion ky dizertacion.

Zogaj flet për fillimet duke portretizuar si ‘një kokë mbi të tjerët’ tre personazhe të kohës, dy mjekë dhe një shkrimtar: Ylli Popën, Sali Berishën dhe Ismail Kadarenë. Një artikull i të parit, dhe intervistat e dy të tjerëve për shtypin e vitit 1990 shenjojnë një triadë të pakënaqësisë, kritikës, por edhe formulimit intelektual të hapjes.

...Disa intelektualë nga më të njohurit në vend kishin “zbuluar” në paragrafë të veçantë të fjalimeve që po mbante Ramiz Alia për demokratizimin shtegun për të avancuar ide të reja dhe një kritikizëm më të drejtpërdrejt të tabuve të sistemit. Edhe pse qëndronin në suazën e guximit të lejuar. Në këtë kontekst, nuk ishte një surprizë që shkrimtari më i madh dhe më i famshëm i vendit, Ismail Kadare, të ishte i pari i çetës së re të kritikëve (Zogaj, 2014: 11).

Zogaj, duke siguruar një abstrakt të qëndrimeve të treshes së intelektualëve, flet për teknikën e paralelizmit të pamaskaur të Popës; sens të ri kritik dhe shpërfaqje më të avancuar të antikonformizmit të Berishës, skicon gjurmët e para të komunikimit politik të intelektualëve të kohës. Duke shtuar në këtë tragë edhe ato që i konsideron ‘krijimet dhe përkthimet e guximshme të penave të tjera’, flet për këtë agjendë komunikimi si për ‘manifeste publike të mendimit të ri intelektual të kohës (po aty:15).

Siç e vumë në pah, libri i Zogajt nuk është studim dhe si i tillë nuk i bindet strukturës së ngurtë hyrje-teorizim-të dhëna empirike-përfundime, megjithatë një teknikë publicistike apo historike mund të konsiderohet përpjekja e tij për një skelet thuajse sekret që ndërton strukturën e ngjarjeve ku përzihen sa *determinizmi* aq edhe *strukturalizmi*, *bihejvorizmi* e të tjera.

Ramiz Alia, shefi komunist i kohës, dhe pasuesi i diktatorit Hoxha, shfaqet rrjedhimisht si përcaktues në zhvillimet e fillimeve. Edhe Zogaj nuk i shmanget ndoshta një prej ngjarve më shumë të diskutuara e të analizuara të asaj kohe, takimt të Alisë me

intelektualët. Te *Fillimet* ndeshim një element pak ose aspak të trajtuar, një dëshmi të Anastas Kondos, shkrimtar dhe ish-ndihmës i Alisë, sugjerimin e ekipit të Sekretarit të Parë për një takim të mbyllur ‘kokë më kokë’ me 4-5 intelektualë. Por Alia kishte vendosur për dhjetëfishin. Zogaj e shpjegon kështu vendimin e Sekretarit të Parë komunist:

Alia i kishte venë pesës një zero prapa dhe ishin bërë pesëdhjetë. Qëllimi i thirrjes së takimit kishte ndryshuar thelbësisht me shtimin e zeros pas pesës. Pesë vetë zakonisht thirren për t’u dëgjuar, për të biseduar, për t’u marrë mend. Pesëdhjetë thirren për t’u mbajtur fjalim, për t’u dhënë mend. Pesëdhjetë, që si për të theksuar distancën me Partinë, kishin zënë vend kryesisht në radhët e dyta e të treta të një salle në Pallatin e Kongreseve (po aty: 29).

Distanca e intelektualëve me partinë që përshkruan autori, zhvendoset edhe në komunikim apo në informacion, duke u bërë e tillë, për të përdorur një term të kohës, edhe me masat popullore. Po aty Zogaj konturon problematikat e takimit intelektualë-Alia dhe Sali Berishën që foli për ngjarjet me ‘domethënie politike’ për të cilat partia dhe mjetet e saj të informimit heshtnin. Të patransmetuara mbeteshin protestat e Shkodrës dhe Kavajës dhe vrasja e një adoleshenti në përpjekjen për t’u futur në ambasada më 2 korrik.

Berisha, duke folur për mosinformim apo dezinformim, është duke kërkuar legalizimin e një të drejtë të mohuar në komunizëm: lirinë e informimit. Te një liri tjetër, ajo e pluripartizmit ngërthehet, sipas Zogajt, diskutimi mes Alisë dhe Berishës. Sekretari i parë e përmend i pari pluralizmin partiak, pas Berishës që ka guxuar të shkojë deri te pluralizmi i mendimit. Dokumentet e arkivuara të takimit lënë të kuptohet një lojë nervash mes protagonistëve, por Zogaj ‘magjepset’ pas një shprehjeje në anglisht të Sali Berishës, *never say never* (kurrë mos thuaj kurrë).

Zogaj flet për të si për një gjë të herës së parë, si në komunikim ashtu dhe në konceptin politik. Në një farë mënyrë, ‘kurrë mos thuaj kurrë’, paralajmëronte fundin e një status quo-je të gjatë.

Kurrë mos thuaj kurrë! Kjo shprehje nuk ishte shqiptuar kurrë në mjediset, sallonet apo mbledhjet opake të komunistëve. Ajo kishte ardhur nga një botë tjetër dhe pasi ishte shqiptuar nga kardiologu Sali Berisha ishte stampuar në ballë të atij takimi duke i shpëtuar nderin, duke përcaktuar drejtimin e ri të të busullës, duke kurdisur orën e re të ngjarjeve në horizontin e Shqipërisë. Never say never! Pluralizmi e kishte çarë murin, e kishte fituar të drejtën. Vendosja e tij tani ishte një çështje kohe. Never say never (po aty: 36).

Ashtu si Spartak Ngjela, dhe Zogaj e ka të fortë relievin që skicon në tekstin e tij Sali Berisha. Pak pasi e ka komunikuar si sendërtues të një kodi të ri politik, saktësisht të pluripartizmit, me shprehjen në anglishte *nevers say never*, ai i gjen hijet. Këto dritëhije do ta shoqërojnë portretizimin e Berishës, dhe ‘zbardhja’ e kontekstit të kohës, i cili është edhe qëllimi i këtij kapitulli, synon gjithashtu të vendosë një lidhje koherente mes asaj çfarë është Berisha dhe çfarë janë personazhet apo autorët që kanë shkruar për të: shumica kundërshtarë të tij në një kohë apo në një tjetër.

Por i duhej dikush që kishte statusin e një intelektualit kritik, dikush që mund të amortizonte dhe zbuste zemërimin e studentëve pas drurit që kishin ngrënë, dikush që mund ta shfajësonte para tyre dhe ta çlironte nga akuzat për pabesi që po i bëheshin në qytetin “Studenti”. I duhej, pse jo, një njeri i njohur në atë pol të ri force që po lindte dhe kjo ishte e natyrshme. Dhe më të mirë se kardiologun Sali Berisha vështirë se mund të gjente. Ky njihej gjerësisht në Shqipëri si njeriu që kishte kërkuar më shumë liri për bashkatdhetarët dhe vendin e tij gjatë atij viti (po aty: 46).

Më tej, Zogaj, që kanë qenë herë në grupin e Berishës, e herë në grupin kundërshtar me të, e hedh vështrimin mbi lidhjet Alia-Berisha, një raport që është përimituar sa në të djathtë e sa në të majtë të spektrit politik nga gazetarë, publicistë, shkrimtarë e studiues, duke u futur, në mungesë të dokumenteve, në teori konspiracioniste, për të shpjeguar kësisoj sa gjendje personale aq edhe problemet sistemike të Shqipërisë.

Teorive komplotiste, më shumë se çdo gjë, u ka ndihmuar mungesa apo dokumentacioni i pakët: takimet Alia-Berisha kanë qenë, së pari të rralla, dhe së dyti të

padokumentuara. Dëshmitarët pranojnë se shkëmbimet kanë qenë telegrafike, ndërkohë që protagonistët, Alia e Berisha, kanë komunikuar pak ose aspak mbi dialogjet mes tyre. Zogaj flet për dy takime të dy njerëzve që do bënin rokadë në kreun e shtetit pak më shumë se një vit më vonë, ndërsa Besnik Mustafaj, te një kronikë e ngjarjeve në librin *Midis krimeve dhe mirazheve*, flet për një takim pesëmbëdhjetë minutësh.

Takimi i dytë është ‘i pacertifikuar’ sepse Alia pretendon për një herë të dytë të tij me Berishën mesnatën e takimit të parë, ndërkohë që Blendi Fevziu te *Piedestale pa statuja* ngulmon se shefi komunist dhe kreu i asaj që së shpejti do të ishte opozita zyrtare, u panë të nesërmen diku nga ora 10 e paradites. Zogaj e quan *një takim korrektësie*.

Duke përmbyllur paraqitjen e Sali Berishës si protagonist, thekson se ai shihej si i përshtatshëm nga nomenklatura për faktin se përmes tij mund të kishin akses në lëvizjen e re. Brenda së njëjtës fjali, përdor dy terma kureshtarë ose domethënës, për të cilësuar rolin e Berishës: ‘i dërguar’ dhe ‘ndërmjetës’ duke parapëlqyer këtë të fundit.

E kërkuam në rolin fleksibël të një ndërmjetësi, duke evituar përdorimin e fjalës “i dërguar” dhe ishin në të drejtën e tyre dhe në lojën e tyre ta bënin këtë, pasi, përtej shpresave të marra të mbajtjes së pushtetit dhe privilegjeve nëpërmjet një demokracie butaforike, nuk mund të luanin kaq verbtazi me fatin dhe, siç e shënuam më lart, nuk njihnin njeri më të përshtatshëm se Sali Berishën që do të mund t’ua ruante kockën nëse do t’u duhej të sakrifikonin mishin (po aty: 49).

Dëshmitë për tranzicion, apo më saktë në rastin tonë, të fillimit të lëvizjes demokratike në Shqipëri, do të ishin të paplota nëse nuk do të flitej për rolin e Ismail Kadaresë. Të gjithë autorët që kanë shkruar për këtë periudhë e fusin largimin e shkrimtarit, dhe para kësaj, pelegrinazhin e tij intelektual, si përcaktues dhe siguries të një panorame të plotë të zhvillimeve këtu të marra në shqyrtim. Nuk ka rëndësi nëse shkruesit janë pohues apo

mohues, e rëndësishme është që Ismail Kadare njehsohet si një prej harqeve të urës që siguruan fondamentin e kalimit të vendit nga një sistem në tjetrin.

Preç Zogaj hyn tek *dëshmitarët e Kadaresë*. Ai e përshkrua ikjen e shkrimtarit, në tetor 1990, si një akt të ndodhur në një periudhë kritike: ngjarjet e ambasadave, demonstratat në Shkodër, Tiranë, Kavajë dhe përpjekjet e regjimit për të bërë ‘ndryshime fasadë’ që kishin qëllim njëfarë perestrojke ala gorbacoviane për të siguruar, jo ndryshimin, por vazhdimësinë.

Zogaj e shenjon si historik vendimin e Kadaresë për të kërkuar azil politik në Francë, duke e quajtur deklaratën e tij ‘jo vetëm një akt, por edhe dokument të një platforme lucide për të ardhmen e Shqipërisë së re dhe Kosovës së re.’

Me zërin e intelektualit të vet më të njohur, kombi shqiptar i njoftoi mbarë botës aspiratat e veta për liri, demokraci, të drejta politike dhe kombëtare. Historia nuk zhvillohet si një pjesë teatrale ku personazhet dhe gjithkush tjetër mund të lexojnë fundin para fillimit. Në politikë ngjarjet zbulohen duke ndodhur. Në këtë kuptim, ikja e Kadaresë në tetor të vitit 1990 ishte një akt politik dhe intelektual i guximshëm me efekte pozitive të jashtëzakonshme për kursin që morën zhvillimet demokratike të kohës në Shqipëri (po aty: 63).

Shenja që bëri nga Franca intelektual i par excellence i Shqipërisë në tetor 1990, do të bashkohej me të tjera shenja që do t’i jepnin jetë panoramës gri e të tulatur të vendit, studentët dhe punëtorët, kryesisht të qyteteve të mëdha si Tirana e Shkodra, por edhe Kavaja. Një lexim që Zogaj u bën ngjarjeve të kohës dhe rreshtimit të faktorëve është interesant sepse pranon një pozicion më modest në protagonizëm. Duke folur për vete, Berishën dhe intelektualë të tjerë, ai pranon se:

...falë Lëvizjes Studentore dhe Azem Hajdarit, që na kishte ftuar për mbështetje e këshilla, kishim rastin të viheshin në një hap me ngjarjet e reja, që po përcaktonin drejtimin e ri të vendit.

Nga artikujt dhe intervistat e Popës, Berishës, Kadaresë, Pashkos e të tjerëve, autorët e tranzicionit, shpalosin jo vetëm proselitët e rinj, por edhe dogmatikët e vjetër,

byroistët ose ata që konsiderohen si ‘konservatorët’ ndër anëtarët e nomenklaturës komuniste. Thua se të gjithë këta autorë, këtu nuk bën përjashtim as Zogaj, sjellin një fjali të Spiro Kolekës, si ilustrimin më flagrant të ‘palës tjetër’, forcës që e zotëronte pushtetin prej katër dekadash.

“Ne e kemi marrë pushtetin me luftë e nuk e lëshojmë pa luftë, ishte deklarata e Kolekës. Kjo fjali hyn mes ngjarjeve që përparuan pa ndalur deri në atë që njihet si Lëvizja e Dhjetorit, e cila akt pas akti kulmoi me themelimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë. Zogaj kujton fjalën e Berishës, një fjalim të zjarrtë, në mitingun ku u shpall themelimi i PD, kushtimin lëvdues për Ramiz Alinë-të përligjur shton ai- si dhe vetëparaqitjen e Doktorit si mik të partisë së sapoformuar. Dhe shton: Por nën shtytjen e vrullshme të ngjarjeve, pa kaluar njëzet e katër orë, do të përshihej në Komisionin Nismëtar të asaj partie dhe do të ishte ndër firmëtarët e parë të kërkesës për legalizimin e saj.

Si kontrapunkt të Berishës dhe vendimit të tij të orëve të para për t’iu bashkuar themeluesve të Partisë Demokratike, Zogaj sjell shembuj të çka mund të quhen hezitime apo pavendosmëri të mëdha:

kur PD ishte ende në embrion, individët më shumë mendoheshin se sa turrehin për tu bërë me të, më shumë hezitinin se sa shtyheshin me bërryla që kush e kush të dilte para tjetrit, siç do të ndodhte më vonë kur partia të forcohej, të fitonte zgjedhjet dhe të vinte në pushtet.

Lufta për pushtet që filloi aty dhe vazhdoi pafund, ka përcaktuar shumë në tekstin dhe nëntekstin e historisë së tranzicionit, por edhe sjelljes politike të protagonistëve. Patosi, logosi dhe ethosi i zhvillimeve që filluan me atë kohë që Zogaj karakterizon si *Fillimet* do të zhveendosej nën hijen e gjakut dhe baltës. Për këtë dikotomi, me një sens artistik, Zogaj kujton ngjitjen drejt Qytetit Studenti ku do të zhvillohej mitingu i parë i

shpalljes së një partie opozitare në Shqipëri që pas instalimit në pushtet të komunistëve në vitin 1944.

Kishim menduar të gjithë se regjimi nuk e lëshonte pa shkuar gjaku në gju të kalit. Ashtu ishte kapur me thonj e me dhëmbë në udhëkryqin e kohës tirania shqiptare. Kishim menduar se do të bëheshim me gjak. Por ishim bërë vetëm me baltë. Nuk e dinim atëbotë se balta do t'i ngjitej si mallkim tranzicionit të gjatë të Shqipërisë.

3.7.1 Tranzicioni si kronikë

Studiuesi Elez Biberaj, përmes një pune thuajse shterruese ka siguruar, deri më tani, kronikën më të plotë të tranzicionit shqiptar. Ai i ka parë, si kronikan kryesisht, zhvillimet në Shqipëri, dhe më pas i ka shtrirë në studimin *Shqipëria në tranzicion* duke përdorur teknika sa të një gazetari, aq dhe të një historiani apo të një analisti⁸. Biberaj megjithatë nuk është i paprekur nga një ‘afërsi’ me anti-komunizmin, prirje që lidhet me historinë e familjes së tij e arratisur nga Shqipëria gjatë regjimit komunist.

Ai në ndryshim nga autorët e tjerë të trajtuar në këtë kapitull, ka patur si pretendim sigurimin e një kontekstualiteti, por edhe një interpretim të veçorive të tranzicionit, i ndihmon këtij qëllimi sepse i sheh nga lart dhe nga larg zhvillimet në Shqipëri. E tija është kronika më e ftohtë e ngjarjeve të periudhës 1990-1992. Ai ka përdorur burime të shumta publicistike, historike, studimore e të tjera duke ua lënë fakteve interpretimin e ngjarjeve, dhe jo duke përdorur interpretimin për të ndërtuar ngjarjet, siç kemi hasur ndër autorë të tjerë të cituar në këtë punim.

E bëjmë këtë dallim, jo për të theksuar mungesat e *autorëve interpretativë*, por për të thënë të kundërtën: të gjitha qasjet i ndihmojnë sigurimit të një konteksti sa më të plotë e sa më tregues të periudhës që këtu trajtojmë.

⁸ Elez Biberaj ka dëshmuar shpesh para Komisioneve të Kongrest Amerikan në kapacitetin e një analisti të çështjeve të Shqipërisë dhe Ballkanit.

Biberaj e fillon që në vitin 1989 kronikën e ngjarjeve që lindën ndryshimin edhe në Shqipëri, duke sjellë fjalën e Ramiz Alisë në Këshillin Qendror të Bashkimeve Profesionale më 11 dhjetor, në pragun e përmbysjes së dhunshme dhe të ekzekutimit të diktatorit rumun, Nikolla Çausheku. Në një artikull të gazetës *Bashkimi* Alia citohet duke ‘u matur’ me një pyetjeje retorike: ‘Ka njerëz jashtë shtetit që pyesin: Do të ndodhin edhe në Shqipëri procese si ato që po ndodhin në Europën Lindore? Ne u përgjigjemi vendosmërisht dhe kategorikisht: Jo, në Shqipëri nuk do të ndodhin’ (Biberaj, 2011: 67).

Duke cituar ata që i quan *ideologë shqiptarë* dhe duke përmendur dy artikuj në gazetatat komuniste të kohës, *Bashkimi* dhe *Zëri i Popullit*, të Genc Kondit dhe Sokol Gjokës, Biberaj thotë se ata i shpjegojnë ngjarjet në Europën Lindore si devijim nga marksizëm-leninizimi i partive komuniste.

Një ideolog tjetër, historiani Arben Puto, në një letër të botuar në shtyp i mëshon patundshmërisë në rrugën e Partisë ndërkohë që ngjarjet përmbysëse në Lindje kishin ndodhur e në Shqipëri do të fillonin pak muaj më vonë.

‘Ne kemi zgjedhur vetë rrugën tonë, socializmin. Se sa e drejtë ka qenë kjo rrugë, duket nga fitoret e pashembullta që kemi arritur, që ia kanë ndryshuar pamjen mbarë vendit. Prandaj dhe jemi të vendosur të vazhdojmë në këtë rrugë’ (Puto, 1990: 2).

Në një kthesë interesante ideologjike ‘kapet’ Ramiz Alia i cili, në përpjekje për të siguruar legjitimet dhe vazhdimësi politike për regjimin, vëren Biberaj, fut në përdorim taktikën e vjetër komuniste të theksimit të temave kombëtariste dhe të të rolit të Partisë së Punës në ruajtjen e Pavarësisë së vendit.

Intelektualët dhe roli i tyre brenda një mjedisi të paqëndrueshëm e në ndryshim të vazhdueshëm, vështrohen në mënyrë sasiore dhe cilësore nga Biberaj. Duke iu referuar një artikulli në shtypin shqiptar të kohës, ai jep një bilanc numerik të atyre që kishin kaluar rrethimet e ambasadave për të ikur në Perëndim, duke vënë re se në lista mungonin intelektualët. Më poshtë sillen intervista të *Zërit të Amerikës* me refugjatët shqiptarë të cilët shprehnin kritika të ashpra për intelektualët. Shumë të tillë theksonin zhgënjimin për paaftësinë e intelektualëve për të formuluar kërkesa të qarta politike dhe i shihnin si bashkëpunëtorë të Alisë.

Qëndrimi i Ramiz Alisë ndaj intelektualëve ishte i dyanshëm. Nga njëra anë ai e shikonte përkrahjen e tyre si të domosdoshme për suksesin e politikës së tij, kurse nga ana tjetër e dinte se synimet e tyre ndryshonin rrënjësisht nga synimet e tij. Meqë u kishte dhënë deri diku liri shprehjeje, udhëheqësi shqiptar priste që intelektualët të mbështesnin politikën e Partisë së Punës, sidomos në intervista dhe në kontakte me të huajt (po aty: 91).

Të huajt i kërkonin Alisë lejin e pluralizmit politik dhe shefi komunist zgjodhi një devijacion duke folur për lejim të pluralizmit të mendimeve. Nën presionin e kërkesave ndërkombëtare, përherë e më këmbëngulëse, shqiptarët nuk do të dënoheheshin më nga neni 55 i agjitacion propagandas, por ata nuk mund të krijonin parti opozitare të cilat të mbronin interesat e tyre.

Biberaj ia atribuon Sali Berishës thirrjen e parë publike për vendosjen e pluralizmit politik duke përmendur artikullin e famshëm të botuar në shtator në gazetën *Bashkimi*, organ i Frontit Demokratik. Ai e konsideron artikullin e kardiologut të njohur ‘një sulm kundër konservatorëve që kundërshtojnë reformat dhe qëndrimin e tyre përçarës

ndaj problemeve ideologjike’. Biberaj vë në dukje edhe daljen e Berishës nga zhgualli ideologjik i diskutit komunist me anë të ‘hedhjes poshtë të temave ideologjike të konservatorëve’, ‘përmendja vetëm shkarazi e Ramiz Alisë’ dhe ‘asnjë citim i parullave

të zakonshme ideologjike të Partisë së Punës’. Pluralizmi shkruante Berisha në artikull ishte një traditë e lashtë e shqiptarëve duke i mëshuar gjithashtu faktit se koha nuk priste (Berisha, 1990: 2,3).

Pavarësisht lëshimeve, të mefshta në fillim, të Alisë pluralizmi u vendos dhe forca e parë opozitare, Partia Demokratike e Shqipërisë, u krijua. Biberaj flet për bashkim të opozitës ‘rreth njerëzve të tillë si Sali Berisha dhe Gramoz Pashko, të dy anëtarë të Partisë së Punës. Mirëpo dy udhëheqësit e opozitës që po dilte në skenë nuk bënë përpjekje për të bashkuar forcat dhe nuk zhvillonin ndonjë veprimtari të organizuar, duke u mbështetur vetëm në një rreth të vogël miqsh të ngushtë’.

Më tej studiuesi bën një vëzhgim që favorizon Berishën përkundër tranzitologëve të tjerë që i kanë mëshuar vazhdimisht idesë se kardiologu i shndërruar në politikan ishte kartë e Alisë në lëvizjen antikomuniste. Duke e vendosur Pashkon në kontekstin e vet social, Biberaj duket se sugjeron se nëse ngjarjet prodhonin një përplasje finale, jo idesh por fizike, të ngjashmit do ta gjenin gjuhën dhe i rrezikuari do të ishte kardiologu nga Tropoja e largët.

Me zgjerimin e veprimtarisë politike, Berisha rrezikonte t'i humbte të gjitha, sepse nuk kishte as bazë politike as miq në sfera të larta që mund ta mbronin. Pashkoja, përkundrazi, ishte në pozita më të forta se sa Berisha, pasi familja e tij kishte lidhje të ngushta me klanin e Enver Hoxhës. Kishte pak të ngjarje që edhe në rast të një fushate kundër kundërshtarëve, regjimi do të tregonte egërsinë e tij të vërtetë ndaj Pashkos.

Nëse Berisha do të mbetej *Tjetri i huaj* ose të paktën *i ndryshëm*, edhe më shumë të tillë do të ishin, në sytë dhe gjykimin e nomenklaturës komuniste ende në pushtet në vitin 1990, partitë nacionaliste të para dhe gjatë Luftës së dytë Botërore. Më 17 dhjetor të atij viti, Kuvendi, që asokohe quhej Popullor, dekretoi krijimin e partive politike. Vendimi, shkruan Biberaj, pasqyronte vendosmërinë e komunistëve për të parandaluar

krijimin e partive të së djathtës së skajshme dhe ringjalljen e dy partive nacionaliste të periudhës së Luftës së Dytë Botërore - të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit.

Partia Demokratike, ndërkohë e legalizuar dhe aktive, duhej të mbledhte rreth vetes të gjitha fashat antikomuniste, disidentët, të përndjekurit dhe pronarët e shpronësuar, por edhe komunistë të zhgënjyer apo të pakënaqur me ngadalësinë e reformave të ndërmarra nga Alia. Biberaj sqaron se PD nuk kishte ideologji të përcaktuar qartë përveç përkrahjes së demokracisë dhe mori formën e një lëvizjeje të masave që përfshinte grupe dhe individë që në kushte normale nuk do të ishin në aleancë politike me njëri-tjetrin.

Nëse Spartak Ngjela parashtroi tezën e anti-intelektualizmit të politikës shqiptare duke përfshirë këtu edhe Partinë Demokratike në hapat e parë, Biberaj flet për mbisundim të intelektualëve në udhëheqjen e partisë së parë opozitare, duke shtuar se kjo bëri që ‘disa studentë aktivistë të protestonin se intelektualët ua kishin ‘vjedhur revolucionin.’ Në forumet drejtuese të PD, 6 anëtarë ishin studentë, ndër ta edhe Azem Hajdari, lideri i parë i partisë, dhe Shinas Rama.

Ndryshimi mes intelektualëve dhe studentëve ishte strategjia politike: të parët ishin për kujdes me Alinë dhe hapa të matur, ndërsa të dytët kërkonin radikalizim e lëvizjes opozitare. Shinas Rama dhe Azem Hajdari, sipas të gjithë autorëve që kanë shkruar për ngjarjet e asaj kohe, janë më të zëshmit në favor të radikalizimit.

Kujdesi i intelektualëve, përveç përvojës dhe moshës, është i kuptueshëm po të mbahet mend se shumë prej tyre kishin qenë anëtarë të Partisë së Punës. Dyshimet ndaj komunistëve të shndërruar në Demokratë sipas Biberajt ‘ishin shumë të përhapura’. Ismail Kadare nuk ishte dakord me ‘dyshuesit’.

Nuk duhet harrur se ka pasur qindra komunistë, po aq shumë në mos më shumë se të tjerët që kanë luftuar për demokracinë në Shqipëri dhe kanë vuajtur dhe janë dënuar për këtë ... Të përjashtosh komunistët nga procesi i demokratizimit do të thotë të pengosh qëllimisht këtë proces dhe qëllimisht të shtosh armiqtë e demokracisë. Në dobi të kujt do të ishte një qëndrim stalinist? (po aty: 111).

Biberaj e interpreton atë që ai quan ngurrim të të Partisë Demokratike (pra të intelektualëve në udhëheqje të saj) për tone dhe lëvizje radikale kundër regjimit me anë të një interviste të Berishës për *Zërin e Amerikës* në fillim të janarit 1991. Berisha nuk dha një përgjigje të qartë kur u pyet për Enver Hoxhën, vazhdon Biberaj, duke e quajtur atë ‘figurë komplekse’ dhe duke komentuar se: nën udhëheqjen e [Enver Hoxhës] Shqipëria ka bërë përparim të pamohueshëm në shumë fusha. Por ai ngriti një regjim diktatorial dhe ishte diktator.’

Një ton tjetër të ligjëritimit opozitar mundëson Biberaj me anë të një interviste për të njëjtën media të shkrimtarit Kasem Trebeshina, i sapoliruar nga burgu. Ai dënoi

opozitën se nuk po dilte hapur kundër kultit të Enver Hoxhës dhe i mëshoi idesë se udhëheqësit e saj [opozitës] nuk ishin antikomunistë të vërtetë.

Udhëheqësit e Partisë Demokratike vazhdonin të këmbëngulnin për rrugë paqësore. Preç Zogaj kujton një ‘vërejtje’ të Berishës lidhur me qëndrimet e gazetës së partisë dhe fjalinë e tij ‘do të shkoj të hedh pëllumba paqeje në Kavajë’. Sipas Biberajt udhëheqja e PD e dinte dobësinë e partisë dhe i druheshin një kundërsulmi të forcave komuniste konservatore që mund të bëheshin shkas për një revoltë popullore ose edhe për luftë civile. Kështu ata theksonin se do të përdornin vetëm metoda paqësore.

Atë që autorë të cituar më lart në këtë kapitull e përligjin me një direktivë sovjetike të tipit ‘Katovica’, apo ‘emisarë’ të Alisë në lëvizjen anti-komuniste, Elez Biberaj e sheh

si punë të Sigurimit të Shtetit i cili ‘i ishte përveshur punës për të hapur fjalë se udhëheqësit e opozitës ishin njerëz të Alisë’.

...mënyra se si i priti populli, e nxitën Partinë e Punës që të bënte ndryshime të rëndësishme në qëndrimet e veta. E shtyrë nga frika se mos eliminohej politikisht nga opozita e porsadalë dhe humbiste kontrollin, Partia e Punës filloi përpjekjet për të rimarrë iniciativën. Mediat zyrtare filluan një fushatë, duke pretenduar se Partia e Punës dhe Alia personalisht kishin nisur reformat që pastaj kishin çuar në sanksionimin e pluralizmit politik.

Për të kuptuar më qartë qëndrimin e forcave konservatore, përfshirjen e Sigurimit, por edhe enverizmin e një pjese të popullatës së kohës, si dhe për të futur në mozaikun e kontekstit të gjitha ngjyrat e forta, duhet përmendur krijimi dhe aktiviteti i një shoqate pothuajse paramilitare që u vetëquajt *Vullnetarët e Enverit*. Ndër kërkesat e tyre, kujton Biberaj, ishte rivendosja e bustit të Enverit pas një ‘marshimi’ drejt Tiranës; shpalljen e Vlorës kryeqytet të ri të Shqipërisë etj.

Vendin e pushtoi një ndjesi pasigurie e cila shtoej në sajë të akteve të shkatërrimeve dhe presionit: dy terma të kohës që simbolizonin, jo vetëm gjendjen psikologjike, por edhe ndërrimin e kodeve të komunikimit, ishin ‘vandalistët’ dhe ‘huliganët’. Të dyja palët pretendonin se të tillët ishin në anën tjetër, ndërkohë që Berisha në një intervistë për gazetën *Drita* pretendon se pas akteve shkatërrimtare qëndronte Sigurimi i Shtetit. I njëjti ent, sipas shefit të opozitës, kishte dorë edhe në eksodin e rreth 20 mijë shqiptarëve.

Biberaj i referohet një gazetareje britanike, Catherine Field-it, këshilltare e qeverisë së koalicionit, që i dha jehonë pohimeve të Berishës:

‘Garda e vjetër, e mbështetur nga forcat e pakënaqura të policisë së fshehtë, është në grahamat e fundit, por gjithmonë gati të hidhet në sulm. Zvarritjet e tyre që nuk kanë të mbaruar dhe prania e fshehtë po, megjithatë, kërcënuese e policisë së fshehtë më kanë bërë të iki në shtëpi çdo ditë e bindur se pak gjëra kanë ndryshuar në Shqipëri. Njerëzit janë të trembur dhe nuk flasin, po ata besojnë se elementë konservatorë të ish-Partisë Komuniste por organizojnë paqëndrueshmërinë e vendit dhe prishjen e rendit. Ky mendim nganjëherë më lë pa gjumë.

Qeveria e koalicionit, ku Gramoz Pashko, një prej themeluesve të PD, ishte zëvendës kryeministër, përbën një nyjë prej së cilës dolën shumë fije të mëvonshme që përcaktuan shumëçka në forumet e Partisë Demokratike, por edhe në të gjithë skenën politike shqiptare.

Ndër autorët e cituar në këtë kapitull ka mendime se Pashko si zv/kryeministër, dhe larg zhvillimeve të forumeve të PD, ishte një lëvizje brilante e Berishës i cili synonte kontrollin e partisë dhe pushtetin e plotë të mëvonshëm. Biberaj zbulon një skizmë të shfaqur mes bllokut të ministrave Demokratë dhe Berishës e bazës së PD në anën tjetër.

Berisha e theksoi verbin antikomunist dhe filloi të fliste për kriptokomunistë.

Strategjia e re e Berishës fitoi pothuaj menjëherë përkrahjen e popullit, që kishte filluar ta shikonte përherë e më shumë qeverinë e koalicionit si një zgjidhje që kishin gjetur komunistët për t'u pasuruar. Ishin të shumtë ata që mendonin se Gramoz Pashko, i cili kishte humbur lidhjen me udhëheqjen dhe anëtarët e thjeshtë të partisë, po sillej me shumë delikatesë në marrëdhëniet me komunistët (po aty: 176).

Ky kontekst dhe këto ndjesi bëjnë, sipas Biberajt, që ‘opinionit brenda Partisë Demokratike u zhvendos nga e djathta si për çështje politike ashtu edhe për ato ekonomike’. Ministrat demokratë në qeverinë e koalicionit refuzojnë daljen nga kabineti dhe rrjedhimisht rrëzimin e qeverisë. Këtu kulmon edhe lufta për pushtet brenda Partisë Demokratike. Ajo që bie në sy në terma të simbolikës së përfaqësimit të ngjarjeve apo personazheve, është se nëse Elez Biberaj i etiketon si ‘majtistë’ Pashkon dhe mbështetësit e tij në apo jashtë qeverisë, Preç Zogaj, vetë ministër Kulture në të njëjtin kabinet, i konsideron ata si ‘liberaldemokratë’. Sidoqë të jetë, të dy palët u vunë përballë. Qëllimi i ‘majtistëve’ të Biberajt ishte shkarkimi i Berishës si kryetar dhe marrja në dorë e udhëheqjes së PD. Biberaj flet për një takim në prag të Kuvendit të parë kombëtar të Partisë Demokratike, të cilin e kujton edhe Preç Zogaj, pjesëmarrës në të. Në shtëpinë e Pashkos u mbledhën Ceka, Ruli, Zogaj dhe ish-kryeredaktori i

Rilindjes Demokratike Frrok Çupi, për të kurdisur atë që Biberaj quan ‘zëvendësimin e Berishës me Cekën’.

Kundërshtarët e Berishës do të kërkonin që kryetari i partisë të zgjidhej nga kryesia, ku ata mendonin se ishin shumicë, në vend të konferencës kombëtare një forum më i gjerë, më ‘popullor’ dhe më pranë Berishës. Nëse kjo kërkesë hidhej poshtë nga delegatët e kuvendit ‘majtistët’ [gjithmonë sipas Biberajt] do të fusnin në lojë kartën rezervë: ish-anëtarët e Partisë së Punës të mos zgjidheshin në postet drejtuese. Kjo do të eliminonte Berishën.

Biberaj vëren një sintoni mes sulmeve personale kundër Berishës që vinin sa nga kundërshtarët e tij brenda partisë, ashtu dhe nga gazeta e komunistëve *Zëri i Popullit*. Akuzat e të dyja palëve qenë të njëjta: drejtonte Partinë Demokratike në mënyrë autoritare dhe nuk duronte kritikën. Për ZP Pashko me të tijtë ishin të moderuarit, Berisha një politikan kokëkrisur që do të bëhej edhe diktator, po të merrte pushtetin.

Alia, si edhe udhëheqja e re e Partisë Socialiste, siç dukej, besonin se grupi majtist ishte më i prirur se Berisha për të rënë në ujdë me socialistët. Duke punuar në prapaskenë, Alia përpiqej të bënte për vete kundërshtarët e Berishës, sidomos Pashkon, Cekën dhe Zogajn. Në fillim të shtatorit 1991, presidenti e ftoi Cekën ta shoqëronte në një varg vizitash në disa vende europiane, ku ai nënshkroi dokumentet mbi hyrjen e Shqipërisë në KBSE (po aty: 177).

Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike u mbledh shtatorin e atij viti (1991). Skizma që do të vinte u shfaq e qartë. Berisha fitoi mbi ata që Zogaj i quan ‘liberaldemokratë’ ndërsa Biberaj ‘majtistë’.

3.8 Përfundime I: Demokratizimi i Huntington: a është Shqipëria e përputhshme me të?

Libri i Samuel Huntington-it është botuar në vitin 1993. Në raport me Shqipërinë, por edhe me vendet e Europës Lindore që i rrëzuan regjimet e tyre komuniste duke filluar nga viti 1989, në terma të distancës historike dhe analitike, një largësi e tillë kohore nga objekti i studimit do të dukej e vogël dhe e pamjaftueshme edhe në rastin e një autori si Huntington. Por ajo valë demokratizmi që përfshiu Europën Lindore në mbyllje të dekadës së parafundit të shekullit 20, ishte shfaqur në Perëndim të saj apo në Amerikën e jugut duke filluar që në vitin 1975. (Këtu fillon edhe periudha e studiuar prej profesorit të Harvard-it).

Te kjo shtrirje në kohë dhe gjeografi, megjithatë, shumë kritikë do të gjenin edhe mangësitë e pretendimeve apo përfundimeve të *valës së tretë*. Argumentohet me të drejtë, siç është përmendur edhe më lart, mbi faktin se kontekstet kohore, historike dhe kulturore nuk mund të jenë të njëjta si në Lindje ashtu në Perëndim; si në Europë ashtu dhe në Amerikën Latine; si në Hungari ashtu dhe në Kili apo Portugali, për shembull. Kritika qëndron, por është gjithashtu i vlefshëm qëndrimi se ajo që Huntington parashtron është një paradigmë, dhe si e tillë argumenton mbi më shumë se një teori e mbi më shumë se një praktikë.

Autori i *Valës së tretë* pranon se, për të shpjeguar demokratizimin janë ngritur teori të shumta dhe janë identifikuar një sërë variablash (Huntington, 2015: 55). Midis sosh ai radhit variablat që kontribuojnë për demokracinë dhe demokratizimin. [Mes tyre, aty ku është e mundur duhet gjetur një kontekst dhe një prognozë shqiptare]:

1- *Një nivel i përgjithshëm i lartë i mirëqenies ekonomike;*

Shqipëria, në periudhën e shqyrtuar këtu, ishte vendi më i varfër i Europës; të ardhurat vjetore për frymë të vendit në vitin 1991 ishin 2040 USD. Moldavia, po atë vit e kishte të njëjtin tregues 3590 USD⁹.

2- *Shpërndarja relativisht e barabartë e të ardhurave dhe/ ose pasurisë;*

Mund të flitet për një barazi relative në Shqipërinë që po dilte nga komunizmi, ose atë që mund të quhet *barazi në mjerim*, por jo për shpërndarje të barabartë të të ardhurave në kuptimin socialdemokrat, le të themi gjerman apo suedez.

3- *Ekonomia e tregut;*

E kundërta e saj: ekonomia e centralizuar, gjithçka në duart e shtetit dhe asgjë jashtë kontrollit të tij.

4- *Zhvillimi ekonomik dhe modernizimi social;*

Shqipëria ishte në fund të dy proceseve të mëdha të nisura me zhurmë e shoqëruar me propagandë nga regjimi komunist: *industrializimi i rëndë i vendit dhe emancipimi i shoqërisë*. I pari prodhoi Kombinatit Metalurgjik Çeliku i Partisë në Elbasan, cili për të cituar një prej krerëve të PD-së sapoformuar ‘nuk prodhonte dot një tapë shisheje birre’. I dyti, i projektuar si proces mesianik prodhoi *njeriun e ri komunist* me një gjuhë dhe vetëdije të ngjashme me romanin 1984 të George Orëll.

5- *Aristokracia feudale në një moment të caktuar të historisë së shoqërisë;*

Këtu mund të prodhohet një përgjigje pozitive e pjesshme. Ekzistonin para pushtimit osman familjet e mëdha feudale shqiptare, apo principatat e Arbrit siç janë quajtur me

⁹ <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?page=4>

një tendencë të romantizmit nacionalist. I njëjti vështrim romantik i sheh si të ndërprera shenjat e shqiptarisë pas pushtimit osman.

6- *Mungesa e feudalizmit në shoqëri;*

Propaganda e regjimit këtë pretendim kishte: dhënien fund të feudalizmit pas ardhjes në pushtet të Partisë Komuniste. Teoricienë konservatorë si Edmund Burke apo Alexis de Tocqueville e shohin nga optikë krejt e kundërt. Duke respektuar parimin e konservatorimit evropian mund të thuhet se Shqipëria ishte zhveshur në fakt nga çdo formë feudalizmi, por ky ‘rend i gjërave’ u zëvendësua me autokracinë. Nëse mungesa e feudalizmit në shoqëri është kusht për demokracinë, më shumë i tillë duhet të jetë mungesa e diktaturës.

7- *Një borgjezi e fortë (“pa borgjezi, s’ka demokraci,”) sipas formulimit konçiz të Barington Moore-it;*

Një ‘borgjezi e drojtur’ e qytetit që lulëzoi gjatë Republikës dhe mbretërisë së Zogut u zhduk me dhunë pas ardhjes në pushtet të komunistëve. Figura e *borgjezit të vogël* ishte më e përqeshura në shtypin dhe kinematografinë socrealiste.

8- *Një klasë e mesme e fuqishme;*

Klasa e mesme nuk është një koncept i pajtueshëm me barazinë dhe komunizmin. Të pranosh ekzistencën e klasës se mesme do të thotë të pranosh se ekzistojnë të varfrit dhe të pasurit. Në Shqipërinë socialiste nuk kishte të varfër, ishte pretendimi i propagandës komuniste.

9- *Nivele të larta edukimi dhe arsimit;*

Një analizë sasiore e konfirmon pretendimin e regjimit për zhdukjen e analfabetizmit, përhapjen e arsimit (sidomos fillor), si dhe hapjen e të parit Univeristet në historinë e

Shqipërisë. Një qasje cilësore e gjen shkollën komuniste të mbyllur, totalitariste dhe stimuluese të procesit të të mësuarit riprodhues në vend të të menduarit kritik.

10- Një kulturë të dobishme më shumë sesa konsumatore;

As te dobishme dhe as konsumatore.

11- Protestantizmi;

Le ta marrim këtë pikë, jo si pretendim fetar (pasi Shqipëria ishte vend ateist, i vetmi në botë) por sipas kuptimi ëeber-ian të *etikës protestante të punës*. Në secilin rast, jo, do të jetë përgjigjia.

12- Pluralizmi social dhe grupet e fuqishme ndërmjetësuese;

Socializmi i Enver Hoxhës pretendonte kompaktësi sociale, *grusht bashkuar rreth Partisë*, jo pluralizëm. Shqipëria ishte një vend pa mekanizma apo grupe ndërmjetësuese duke qenë se feja ishte e jashtëligjshme; gildat apo sindikatat nuk ekzistonin, ndërsa Universiteti (dmth inteligjentia) renditej i treti pas proletariatit dhe fshatarësisë.

13- Zhvillimi i konkurrimit politik para zgjerimit të pjesëmarrjes politike;

E paaplikueshme në rastin shqiptar.

14 - Struktura autoriteti demokratik brenda grupeve shoqërore, sidomos të atyre të lidhura ngushtë me politikën;

Nuk ekzistonin grupet shoqërore.

15 - Nivele të kompromisit;

I vetmi kompromis ishte lufta pa kompromis kundër kapitalizmit dhe shfaqjeve të huaja.

16 - Pushtimi nga një fuqi e huaj prodemokratike;

Paradoksi i Shqipërisë është se fuqia më e iluminuar pushtuese e saj ishin fashistët italianë. Miqtë e mëvonshëm të saj (pushtues të një lloji tjetër) i përkisnin Lindjes (edhe pse këtu mund të kritikohemi për rënie në orientalizëm) jugosllavët, rusët dhe kinezët.

17 - Influenca e një fuqie të huaj prodemokratike;

Dy të tilla mund të identifikohen në rastin shqiptar: influenza franceze ndaj së cilës ishte e hapur vetëm udhëheqja komuniste, dhe influenza italiane ndaj së cilës ekspozohesh një pjesë e mirë e popullatës nëpërmjet radiostacioneve të vendit përtej Adriatikut. Megjithatë, këtu duhet kuptuar influenza, jo si një e fuqie në kuptimin e pushtetit, por si *soft power*. E cila, megjithatë funksionon.

18 - Dëshira e elitës për t'u matur me kombet demokratike;

Problemi i parë këtu është elita. Në rastin shqiptar ajo i përkiste sferave komuniste të riorganizuara, rikonceptuara dhe riqarkulluara pas vitit 1945. Sidoqoftë në fund të viteve '80 ka mjaftueshëm shenja të një elite që kërkon 'të dalë në botë' bashkë me kombin.

19 - Traditat e respektit ndaj ligjit dhe të drejtave të individit;

Të drejtat e individit, edhe ajo e jetës, ishin të mohuara në Shqipërinë socialiste. Nuk mund të flitet për një traditë të stabilizuar edhe para se komunistët të merrnin pushtetin. Kanuni i Lek Dukagjinit përbënte ligjin dhe rregullonte marrdhëniet ndërmjet individëve në veri, ndërsa në jug disa zona kishin gjithashtu kanunet e tyre. Në këtë rast mund të flitet për strukturë, edhe pse paraligjore.

20 - *Homogjeniteti shoqëror (etnik, racor, fetar);*

Shqiptarët ishin mbi 90 përqind etnikisht të dallueshëm, prej së njëjtës racë [kaukazianë ose europianë të bardhë]. Sa i takon fesë përgjigja mund të jepet nëpërmjet maksimës rilindase ‘feja e shqiptarit është shqiptaria’.

21- *Heterogjeniteti shoqëror (etnik, racor, fetar);*

Shih pikën 20.

22 - *Konsensusi mbi vlerat politike dhe shoqërore;*

Periudha 1990-1992 mund të ndahet në dy pjesë (jo të barabarta) sa i takon një konsensusi të brendshëm mbi vlerat politike dhe shoqërore. Nëse deri në zgjedhjet e para të 31 marsit 1991 për shumicën e popullatës, siç u pa nga zgjedhjet, (fitorja e komunistëve), vlerat bazoheshin në konsensusin e vjetër të arritur me anë të forcës së shtetit; prej aty deri në zgjedhjet e dyta filloi të kristalizohej një pajtim i ri shoqëror mbi vlerat udhëheqëse. ‘E duam Shqipërinë si gjithë Europa’, të paktën si simbolikë, u bë sinonim i vlerës kryesore të shumicës së shqiptarëve. Anti-amerikanizmi i vjetër, edhe pse i trysnuar, u zëvendësua me një patos për Amerikën, siç u dëshmuua nga vizita në Tiranë e Sekretarit të Shtetit, James Baker.

23 - *Mungesa e konsensusit mbi vlerat politike dhe shoqërore;*

Shih pikën 23.

24 - *Nivele të ulëta të dhunës civile;*

Dhuna shtetërore si zëvendësues i të gjitha dhunave ishte modeli sundues gjatë regjimit komunist, e tillë deri në zgjedhjet e para pluraliste.

25 - Nivele të ulëta të polarizimit politik dhe të ekstremizmit;

Polarizimi politik në Shqipëri ka qenë i lartë në të gjitha periudhat kur vendi ka qenë pjesë e një rendi politik ku lejoheshin alternativat. Kjo mund të vihet re që pas Pavarësisë, me polarizimet që hasi Ismail Qemali si kryeministër i parë i Shqipërisë, përgjatë Republikës dhe Monarkisë së Zogut, por edhe gjatë Luftës së dytë Botërore. Polarizimi i lartë u kthye në ekstremizëm njëkahësh kur në pushtet erdhi Partia Komuniste me Enver Hoxhën.

26 - Udhëheqës politikë të përkushtuar ndaj demokracisë;

Ligjërimi politik i udhëheqësve shqiptarë ka qenë dhe vazhdon të jetë i mbushur me ‘shprehje të vullnetit demokratik’, por raportet e organizmave të huaja si dhe shtypi i vendës apo i huaj dëshmojnë një prirje që nuk përputhet me diskurin. Politikani shqiptar ende nuk e ka vrarë te vetja modelin e Enver Hoxhës.

27 - Përvoja si koloni britanike;

E paaplikueshme në rastin tonë.

28 - traditat e tolerancës;

Shqiptarët mburren me tolerancën ndaj tjetrit të huaj dhe fesë, por nuk mund të thuhet e njëjta për mendimin ndryshe. Siç vihet re në variablat e interpretuara më lart, në përballje me kontekstin shqiptar të cilin kemi nën analizë, të sjella nga Huntington por të huzuara prej tij nga autorë të ndryshëm, Shqipëria është e paqëndrueshme apo e

papërputhshme me demokratizmin. Nëse për një çast e lëmë mënjanë natyrën e regjimit, siç sugjeron Huntington-i i mbështetur në ‘një literaturë të gjerë studimore’, niveli i zhvillimit ekonomik është një hon edhe më i thellë.

Siç e dëshmojnë të ardhurat për frymë në vitin 1991, sipas statistikave të Bankës Botërore, Shqipëria është në fund të këtij honi. Nëse marrim si bazë atë literaturë të gjerë studimesh ku mbështet Huntington-i na duhet të pranojmë se ‘një sasi madhe e politikës publike formësohet më shumë nga niveli i zhvillimit ekonomik të vendit sesa nga natyra e regjimit të tij (po aty: 46).

Duke kapërcyer nga ato që mund të quhen *pika të përshtatshmërisë së një vendi me demokratizimin* Huntington-i sugjeron apo ndërton katër modele të ndryshimit për vendet e përfshira në *valën e tretë*. Këtij punimi i intereson ngushtësisht periudha ‘89-‘91 ku u përfshinë Shqipëria dhe vende të ngjashme me të në Europën Lindore komuniste. Mendojmë se Shqipëria përfshihet në modelin e katërt të propozuar nga studiuesi amerikan për arsye që mund të kuptohen nga përkufizimi i mëposhtëm:

*Modeli i katërt i ndryshimit përfshinte **tranzicionin e drejtpërdrejtë** nga një sistem i qëndrueshëm autoritarist, në një sistem të qëndrueshëm demokratik ose nëpërmjet evolucionit gradual gjatë një kohe të caktuar, ose me zëvendësimin e menjëhershëm të të parit me të dytin.*

Një tjetër studiues (Ash, 1990: 42) portretizon Rumaninë dhe rastin e saj të shndërrimit apo tranzicionit dhe e përqsas atë me Shqipërinë duke i kontrastuar të dyja me pjesën tjetër të vendeve të Europës Lindore. Sipas tij, ‘Rumania, krahas Shqipërisë, ishte vendi më i varfër në Europën Lindore’ dhe kishte mungesa të mëdha të zbuluara edhe nga lista e kritereve për demokratizim të shqyrtuar më lart në këtë syth.

Për Garton Ash këto mungesa ishin: *përvoja demokratike; Krishtërimi Perëndimor pothuajse mungonte krejtësisht; izolimi nga influencat e Komunitetit*

European, Vatikanit, Shteteve të Bashkuara, madje edhe të Bashkimit Sovjetik. Të njëjtat mungesa mund të përshkruajnë edhe Shqipërinë.

Huntington identifikon si ndikuese për valën e tretë të ndryshimeve demokratike edhe procese apo institucione të tilla të politikës ndërkombëtare si Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin European¹⁰ (KSBE), Akti Final i Helsinkit dhe procesi që do të njihej si Procesi i Helsinkit.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës përbyjnë një faktor ndikues të përhapjes së valës së tretë duke përdorur, siç vëren Huntington-i ‘një sërë mjetesh politike, ekonomike, diplomatike dhe ushtarake për të mbështetur demokratizimin’. Studiuesi amerikan përfshin në këto mjete:

(1) deklaratat e presidentëve, sekretarëve të shtetit dhe zyrtarëve të tjerë në mbështetje të demokratizimit në përgjithësi dhe në vende të veçanta; vlerësimet vjetore të gjendjes së të drejtave të njeriut në vende të tjera nga Departamenti i Shtetit; mbrojtja e demokracisë nga Agjencia e Informimit e SHBA-së, Zëri i Amerikës, Radioja Evropa e Lirë dhe Radio Liria;

(2) presionet dhe sanksionet ekonomike, përfshi kufizimet dhe ndalimet nga Kongresi të ndihmës, tregtisë dhe investimeve të SHBA-së në pesëmbëdhjetë vende; pezullimet e ndihmës në raste të tjera dhe votat kundër apo abstenimet në lidhje me kreditë e institucioneve financiare shumëpalëshe;

(3) veprimi diplomatik, përfshi edhe përkrahjen e demokratizimit nga një brez i ri aktiv ambasadorësh të SHBA-së, “përkrahës të lirisë”.

¹⁰ Një nga aktet e para të hapjes së regjimit komunist me botën ishte nënshkrimi nga Ramiz Alia i aktit të futjes së Shqipërisë në KSBE.

Përveç superfuqive janë edhe ‘supernjerëzit’ ata që ndikuan në ndryshimet në Europën Lindore. Këtu përmenden Papa Gjon Pali II, Presidentët amerikanë Jimmy Carter dhe Ronald Reagan, si dhe udhëheqësi sovjetik Mikail Gorbaçov që luajti një rol të dorës së parë.

5.9 Përfundime II: Rrezik i majtë apo i djathtë?

Shpjegimi i kontekstit të periudhës të marrë këtu në shqyrtim (‘90-’92), lidhet ngushtë me rolin e partisë në pushtet, PPSH, e cila si gjithkund në Europën Lindore ndahej në konservatorë dhe liberalë. Ramiza Alia ka synuar dhe është portretizuar nga shumë aktorë si pjesë e grupit të dytë, njëfarë Gorbaçovi i Shqipërisë. Ndër autorët shqiptarë që e kanë trajtuar këtë temë dhe këtë kohë, Besnik Mustafaj (1999), protagonist dhe dëshmitar i zhvillimeve, më vonë ambasador i Shqipërisë në Paris, kur Demokratët erdhën në pushtet, flet për një nervozizëm dhe frymë kërcënuese të rënë të Alisë dhe krerëve të tjerë komunistë.

Ai përsërit një deklaratë të shpeshtë nga funksionarët e lartë të kohës sipas së cilës procesi i demokratizimit të Shqipërisë ishte i pakthyeshëm. Me një kusht, megjithatë: ky demokratizim mund të arrihej vetëm nën kontrollin e vëmendshëm të Partisë së Punës. Komunistët po kërkonin jo vetëm t’i influenconin ngjarjet, por edhe t’i kontrollonin ato duke e fshehur këtë pas një perdeje patarenalizmi të ‘partisë së madhe’, ‘partisë së vjetër’, apo dhe ‘partisë më të ditur’. Mustafaj, vetë një shkrimtar, shkruan për trishtimin që ndjente kur shkrimtarë dhe artistë të rinj e e pyesnin se ‘ç’do të thoshte monizëm?’(Mustafaj, 1999: 34).

Këtu ndoshta lind edhe fakti apo paradoksi që ende zemëron një pjesë të protagonistëve të Lëvizjes së Dhjetorit. Koha e re po zëvendësonte të vjetrën përmes një ‘transferte’, edhe pse dekori do të kompozohet i tillë që të paraqitet si ‘përmbysje’. *Intelligentsia* ish-komuniste ishte e vetmja që kishte mjetet apo, me një term që erdhi më vonë dhe shumë prej tyre do ta përdornin me endje, knoë hoë-n për të marrë pushtetin e ri që do të lindte nga kryengritja e studentëve, punëtorëve dhe, sigurisht, edhe intelektualëve.

Fred Abrahams (2015: 105) flet për dy më të shquarit e kësaj inteligentsie Gramoz Pashkon dhe Sali Berishën. Duke bërë një retrospektivë, ai e pranon si të parashikueshëm faktin se njerëz si ata dolën në krye. Ndër të tjera sepse ata flisnin gjuhë të huaja dhe e kuptonin ekonominë ndërkombëtare më mirë se të tjerët. Ata mishëronin paradoksin e të gjithë bllokut sovjetik, sipas të cilit, *ata që kishin aftësi për të qeverisur në sistemin e ri, ishin ata që kishin përfituar nga i vjetri*.

Të rinjtë dhe të vjetrit, e reja dhe e vjetra, duket një përplasje klasike e cila e merr kuptimin politik të lufta për të zëvendësuar një ideologji me një tjetër, por jo vetëm aty. Mustafaj, te *Krime dhe mirazhe*, bën një ‘zbulesë’ interesante që thotë shumë për përplasjet disapolëshe të asaj periudhe kur po ngjizej *shekulli i ri i shqiptarëve*. Ai flet për një ideal të Partisë Demokratike, për integrimin e Shqipërisë në zhvillimet demokratike dhe europiane, por edhe për një ndeshje paralele të llojit Davidi me Goliathin. Ky i fundit, ishin enveristët apo enverizmi. ...*por edhe me ekstremin e djathtë* vazhdon ai duke folur për një ‘meritë’ të paadresuar (mund të jetë individ ose grup) që e kuptoi shpejt rrezikun e revanshit të djathtë, ndeshja me të cilin, sipas tij, ishte më delikate se me të majtën (Mustafaj, 1999: 158).

Pyetja e parë me qëllim të identifikimit të trajtës politike të asaj që Mustafaj konsideron ‘ekstrem i djathtë’ duhet të jetë ‘kush?’. Jo vetëm çfarë konsiderohet si ekstrem i djathtë, por cilat ishin këto parti të skajshme në Shqipërinë e dekadës së fundit të shekullit, ende e padalë nga ekstremi komunist?

Përkufizimi për ‘parti e ekstremit të djathtë’ në fjalorët politikë ndalet te konservatorizmi, fanatizmi dhe ksenofobia¹¹. Një parti tipike, e periudhës kohore të cilën merr në shqyrtim ky punim, është Fronti Nacional i Jean Marie le Pen-it në Francë.

Etiketimi i dy partive historike, tradicionale konservatore shqiptare, Balli Kombëtar dhe Legaliteti, si parti të ekstremit të djathtë është një ekzagjerim. I vetmi ekstremizëm mund të dallohet në kërkesat e disa partive të djathta, Legaliteti (fillimisht e regjistruar si Partia Nacionaldemokratike) për shembull, për të mos pranuar komunistë në radhët e tyre, si dhe pakënaqësia e saj me PD dhe angazhimin e saj në zhdukjen e komunizmit. Sa i takon programeve, ndër të njëzet partitë e djathta që ishin formuar deri në vitin 1991, ata ngjanin shumë, me përjashtim të Legalitetit, që kërkonte kthimin e Monarkisë (Biberaj, 201: 173).

Nënteksti i artikulimit të Mustafajt, frika nga ekstremi i djathtë, lidhet pikërisht me këtë kontekst: një front politik që do përjashtonte ish-komunistët nga radhët do t’i përjashtonte ata edhe nga negociimi dhe rrjedhimisht nga pushteti i nesërm. Në një vështrim retrospektiv kjo mund të lidhet edhe me ekzigjencën e protagonistëve të hershëm të Partisë Demokratike për të krijuar një parti popullore të qendrës. Historia e mëvonshme politike e Partisë Demokratike do ta përgënjeshtronte këtë. PD, që pas

¹¹ Marrë nga: <http://www.dictionary.com/browse/right--wing>

Mocionit të vitit 1992, i cili çoi në skizmën e parë dhe krijimin e partisë Aleanca Demokratike, u bë vetë partia e ekstremit të djathtë, së cilës ia kishte frikën Mustafaj.

Një tjetër ‘zbulesë’ bën Ramiz Alia. Ai pretendon se intelektualët nuk u shprehën për nevojën e pluripartizmit dhe shton se që ai që e hapi vetë me një pyetje të drejtëpërdrejtë temën e partive të tjera, por nuk gjeti mbështetës për të. Alia përdor fjalën ‘risk’ (që sipas tij duhej marrë për hir të një ideje) për të përshkruar vetëpërmbytjen e intelektualëve, dhe te kjo fjalë ndoshta qëndron edhe dekodimi i asaj që ka ndodhur në atë takim, i cili ka qenë dhe mbetet një prej momenteve më të diskutuara të paratranzicionit shqiptar. Nëse intelektualët nuk ishin të gatshëm për të marrë një ‘risk’ (fjalë e përdorur nga vetë Alia) është e rëndësishme dhe treguese që udhëheqësi komunist e pranon ekzistencën e një risku. Këtu kemi rastin kur një fjalë e vetme tradhton gjithë diskurin zyrtar. Por edhe idenë e pushtetit të transferuar.

Është e rëndësishme të kujtohen termat kohorë të diskurit: ngjarjet e dëshmuara në librin e Alisë kanë ndodhur në vitin 1990, ndërsa kujtimet për to janë shkruar në vitin 2010, pra 20 vjet më vonë. Edhe pse ‘lartësia e kohës së re’ i lejon një vëzhgim dhe përfundime më të kthjellëta, ai flet për ‘vetëcensurë’ dhe ‘përgjegjësi’, dy terma që duket se shpjegojnë premisat e udhëheqësit komunist dhe frikën e intelektualëve. Fjalja e plotë është: Nëse ata që morën pjesë në mbledhje, kanë folur duke *censuruar vetveten*, kjo nuk i çliron nga *përgjegjësia* (Alia: 2010: 343)¹².

Më shumë se autocensura (një term i futur në përdorim të gjerë në një kohë shumë më të vonë se ngjarje që përshkruan Alia), kureshtar është termi ‘përgjegjësia’. Ndoshta një radhë pyetjesh do të mund të evidentonin raportin e Alisë apo të

¹² Termat në kursive janë të miat (a.l)

intelektualëve me këtë fjalë. Kush ishte përgjegjës? Për çfarë? Para kujt? Apo: kush mund t'i ngarkonte me përgjegjësi? Përgjigjia e kësaj të fundit e ka dhënë vetë Alia, i cili në fjalinë e vet (shih më lart) ka përdorur togfjalëshin 'çliron nga përgjegjësia'. Me një vështrim retrospektiv nuk është e vështirë për të identifikuar se, në dimrin e vitit 1990, ai entitet që ngarkonte dhe çlironte përgjegjësi, edhe pse koha kish filluar të hidhte dyshime mbi të, ishte Partia e Punës së Shqipërisë dhe udhëheqësi i saj. Ata ishin shpata e Damokleut në atë sallë të Pallatit të Kongreseve ku ishin thirrur intelektualët.

'Paragjykimin' për intelektualët Alia e shtrin edhe përtej këtij takimi. Duke e kthyer madje në një gjykim kur thekson se *inteligjenca shqiptare, nuk u tregua e shkathët për të ndihmuar zhvillimin demokratik të vendit*. Duke i mbetur besnik një socializmi 'me forcat tona', i cili duhej përkthyer edhe në një 'demokratizim me forcat tona', Alia qorton vendimin e intelektualëve shqiptarë për t'i folur popullit nëpërmjet *Zërit të Amerikës* duke anashkaluar kështu shtypin shqiptar, i cili tashmë kishte dëshmuar një shkallë hapjeje mjaft të madhe (po aty: 341).

Nismën e përfaqësuesve të inteligjencies shqiptare për të folur për nevojën e ndryshimeve, Alia e formaton në dy terma gjithashtu kuriozë: 'zëra sporadikë' dhe 'guximin'. Duke e futur këtë të fundit në thonjëza, për të theksuar një guxim të dyshimtë, dhe duke i quajtur sporadikë disidentët, ai kërkon të bëjë një rinivelim të historisë së vitit 1990, duke u nisur nga ato që mund të quhen pozitat e një tranzitologu të vitit 2010. Nga ky kënd ai u jep të huajve atë që ua merr intelektualëve duke pranuar ndërhyrjen dhe presionin nga jashtë në kursin e zhvillimeve politike të kohës.

Duhet theksuar se, ndryshimet që ndodhën në Shqipëri, ashtu si edhe në vendet e tjera të Evropës Lindore, u imponuan kryesisht nga ndërhyrja dhe presioni i gjithanshëm nga jashtë, nga zhvillimet në situatën ndërkombëtare. Ish-Sekretari i Shtetit të SHBA, Igëllberger, gjatë vizitës në Shqipëri në vitin 1992, u deklaroi studentëve të Universitetit të Tiranës se "ndihmë nga ana e SHBA, duhet konsideruar edhe ajo çka bëmë ne për

shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, gjë që krijoi kushtet për të shkatërruar komunizmin edhe tek ju” (po aty: 358).

Ramiz Alia është proponent i kalimit gradual nga një sistem në tjetrin dhe si kundërshtarë të kësaj ideje ai përmend ekstremistët e të dy krahëve, konservatorët në partinë e tij dhe radikalët në partitë e reja, sidomos Demokratiken. Megjithatë, ‘vazhdimësinë’ Alia e gjen te drejtuesit e PD, të cilët ai i përshkruan si ish-anëtarë të Partisë së Punës, ose nga familje të lidhura me të. Përveç kësaj fashe ai identifikon edhe ‘njerëzit e prapambetur’, forcat e jashtme, ku fut elementë të emigracionit politik dhe grupe kosovarësh, por edhe përfaqësues zyrtarë të vendeve të huaja. Flukset e papërmbajtshme të kohës në gjirin e forcave politike të reja e të vjetra, Alia i përmbledh në një teori konspirative e cila ka qarkulluar dendur për t’u bërë pothuajse një ‘paradigmë’ e ndarjes së pushtetit në Shqipëri. Është fjala për atë që quhet ‘marrëveshja Nano-Berisha’ një takim në Trieste të Italisë, në fillim të vitit 1992. Alia shkruan për praninë në këtë takim të një *“ndërmjetësi” i cili përçonte interesat e një shteti të huaj, ish-federal i fashizmit, M. Çoku, si edhe të përfaqësuesit të San Egidios, z. Paglia.*

KAPITULLI IV

DIKOTOMIA E DJATHTË /E MAJTË: SHQYRTIME

4.1 Dallesa sipas Bobbio

Termat ‘e djathtë’ dhe ‘e majtë’ i ka lindur Revolucioni Francez i vitit 1878. Ata, sipas studiuesit Norberto Bobbio, nuk janë gjë tjetër veçse dy ‘terma antitetikë’, që shënojnë dallesën mes ideologjive. Në një studim që merret ekskluzivisht me kontrastet me dy ideologjive konfliktuale politike, të djathtës dhe të majtës, botuar në vitin 1993, ai shqyrton atë që në nëntitull e quan ‘grykime dhe kuptime të një dallese politike’. Bobbio është një antifukujamist, në njëfarë mënyre, dhe libri i tij i mëshon një teze të kundërt me ‘Fundin e historisë’ së Fukujamës. Nëse autori amerikan, që në vitin 1991, pretendonte bashkë me rënien e Murit të Berlinit, përfundimin e Luftë së Ftohtë me fitoren e kapitalizmit mbi socializmin, lexo të djathtës mbi të majtën, *historia ishte ezauruar*, Bobbio i mëshon idesë së kundërt. Dikotomia e majtë/ e djathtë nuk është zhdukur, ajo mund të ketë pësuar shndërrime, por do të vazhdojë të ndajë më dysh, të ketë pasues dhe të sundojë diskurin politik. Nuk ka pra, sipas Bobbio-s, një *fund të historisë dhe as ideologjisë*.

Teza e studiuesit italian është e rëndësishme për punimin tonë, jo vetëm për faktin se, duke folur për përplasjet apo dallimet e majtë /e djathtë, na thotë se çfarë janë, ku konsiston, dhe si është ndërtuar secila prej ideologjive, por edhe se, jo vetëm trajton ngjarjet e kontekstit kohor të cilin përfshin ky punim, por edhe e ka shkruar atë thujse

në të njëjtën kohë. Tezat e Bobbio-s janë botuar në vitin 1993, ndërsa janë shkruar përgjatë periudhës 1990-1992¹³.

Dallesa e kundërshtuar, siç e quan studiuesi përpjekjen për të fshirë kontrastet mes të majtës e të djathtës, është e pamohueshme ndër të tjera edhe për atë se të dy konceptet, në raport me universin të cilit i referohen janë *reciprokisht ekskluzivë dhe bashkëlidhurazi shterues*. Sipas tij, *eksluzivë* sepse nuk ka doktrinë e as lëvizje që të jetë njëkohësisht e djathtë dhe e majtë; dhe *shterues* në kuptimin që, të paktën nga një pikëpamje themelore, një doktrinë a një lëvizje do të jetë medoemos ose e majtë, ose e djathtë (Bobbio, 1997: 7).

Duke i etiketuar dyshen antitetike e majtë /e djathtë si dikotomi të mëdha, Bobbio vëren se atyre mund t'u bëhet një përdorim *përshkrimor*, *vlerësimor* dhe *historik*. Që të tria të rëndësishme për punimin tonë, për nevojën për të dhënë një paraqitje të palëve të cilat përbëjnë kontekstin shqiptar të viteve 1990-92 (komunistëve në pushtet dhe lëvizjes antikomuniste); për të shënuar atë kalim nga një fazë e jetës politike të Shqipërisë në tjetrën (megjithëse këtu duhet bërë një dallim: më shumë se një kalim i plotë i cili do të ndodhë pas zgjedhjeve të 22 marsit 1992, ajo kohë e Shqipërisë mund të shenjohej më saktësisht si një fazë e këtij kalimi). Sa i takon aspektit tjetër, përdorimit vlerësimor të se majtës e së djathtës, mund të thuhet se ky nuk është qëllimi i kësaj teze e cila do të përqendrohet te *dallimet* vetëm sa për të evidentuar se çfarë në fakt është e djathtë, dhe pasi të jetë bërë një klasifikim i kësaj, të hulumtohet se sa shumë ose sa pak i tillë ka qenë diskuri i Sali Berishës.

¹³ Disa prej artikujve të tij prej nga ka dalë libri janë shkruar edhe përgjatë fundit të viteve '80.

Jean Paul Sartre, një filozof i së majtës është ndër të parët që ka folur për një dallesë tashmë të paqenë mes dy ideologjive, duke i quajtur ato, të djathtën dhe të majtën, *dy kuti të zbrazëta* (Steëart, 2016). Bobbio duke i bërë një përmbledhje artikulesve të këtij ‘kapërcimi’, siç e quan ai, ndalet te shembujt që sillen prej tyre për të ilustruar këtë fazë të re të dikotomisë, tashmë të paqenë.

Një prej tyre është e ashtuquajtura *krizë e ideologjisë*. Bobbio e kundërshton këtë tezë duke thënë se as që bëhet fjalë për zhdukjen e ideologjive, madje ato janë më të gjalla se kurrë.

...pohimi i krizës së ideologjive është më se ideologjik. Le pastaj që “e majta” dhe “e djathta” nuk kanë të bëjnë vetëm me ideologjitë. T’i reduktosh në shprehje të kulluara të mendimit ideologjik do të thotë t’i hysh një thjeshtimi të papërligjur, pse ato dy terma u referohen programeve të kundërta, që kanë të bëjnë me probleme zgjidhja e të cilave i përket normalisht aksionit politik, pra tregojnë kontraste jo vetëm idesh, por edhe interesash e vlerësimesh për drejtimin që i duhet dhënë shoqërisë; këto kontraste ekzistojnë në çdo shoqëri e nuk kuptohet sesi papritur mund të zhduken (Bobbio, 1997: 9).

Bobbio sjell pretendimet e një grupi autorësh italianë për humbjen e fuqisë konotative të dyshe e majtë /e djathtë dhe se do të ishte më mirë [sipas këtyre autorëve-shënimi im] që ky çift t’i lërë vendin një tjetëri si për shembull: progresistë-konservatorë.

[Përkundër asaj që shkruante Bobbio në vitin 1993, mund të thuhet se çifti i përmendur më lart progresistë-konservatorë, është bërë pjesë e fjalorit politik, të paktën në kontekstin amerikan, por duhet sqaruar gjithashtu se vetëm si pjesë e një dallese më të madhe, asaj e djathtë /e majtë, dhe jo si zëvendësuese e saj, dhe aq më pak si parësore në raport me të.]

Diktomia e qenësishme të e cila ngulmon Bobbio duke kundërshtuar mohuesit e saj, e ka gjetur ndoshta kundërshtimin më të fortë të një vërejtje e A. Panebiancos në një shkrim në *Corriere della sera* të 20 janarit 1993 (cituar nga Bobbio) i cili ngulmon se nga *etiketat* apo *pozicionet* duhet kaluar te *problemet*.

Një intermexo kritike mund të bëhet këtu lidhur me atë se, edhe nëse kalojmë te *problemet*, siç propozon Panebianco, sërish nuk e kemi shterruar përplasjen në dikotominë e djathtë /e majtë. Kjo për faktin se pavarësisht cilat janë etiketat, apo *pozicionet*, dhe nëse për një çast i harrojmë ato duke kaluar te *problemet*, sërish nuk merr fund këtu dallesa. Është e vërtetë se e majta dhe e djathta ndahen pjesërisht nga problemet që shqetësojnë secilën prej tyre, por më shumë se kaq ato i ndan *zgjidhja e problemeve*. Secila ideologji e sheh një problem të zgjidhur më mirë sipas këndvështrimit dhe me anë të mjeteve të veta. Mund të flasim këtu për taksimin, rishpërndarjen, e me radhë.

Në përpjekjen për të vërtetuar tezën e tij mbi *dikotominë e pashlyeshme* e djathtë/e majtë, Bobbio zbulon *qendrën*. E bën këtë duke përmendur një grup autorësh të cilët kanë argumentuar se në universin politik, gjithnjë e më kompleks të vendeve të mëdha të shoqërive demokratike, “ndarja tepër e prerë në dy palë të vetme të kundërvëna duket gjithnjë e më e papërshtatshme, vizioni aksial i politikës duket gjithnjë e më i pamjaftueshëm.” Këta autorë flasin për të ashtuquajturin *plurivers* (me palë të shumta), që bien në konvergjenca e divergjenca, dhe rrjedhimisht në kombinacione, përputhje e mospërputhje, dhe si rrjedhojë vërejnë ata “nuk ka më mundësi që problemet të shtrohen në formë antitetike, “ose e djathtë, ose “e majtë”, “po të mos jesh i djathtë, je i majtë” ose anasjelltas”.

Bobbio i jep kredite këtij qëndrimi, por nuk e konsideron vendimtar.

Dallimi mes një të djathte dhe një të majte nuk e përjashton aspak, madje edhe në gjuhën e zakonshme, ekzistencën e një vije të pandërprerë mbi të cilën, mes së majtës nistore dhe së djathtës fundore ose çka është e njëjta gjë, mes së djathtës nistore dhe së majtës fundore, zënë vend pozicione të ndërmjetme, të cilat mbushin hapësirën qendrore mes dy skajeve; kjo vijë njihet mirë dhe është quajtur “qendër”. Po të duam të luajmë me gjuhën e logjikës, do të mund të themi se, ndërsa vizioni diadik ose aksial i politikës mund të përkufizohet si vizioni i së Tretës së përjashtuar, sipas të cilit hapësira politike konceptohet si e ndarë

rigorozisht më dysh, në mënyrë që njëra pjesë të përjashtojë tjetrën, e që mes të dyjave të mos ketë absolutisht asgjë, vizioni triadik, nga ana e vet, që përfshin edhe një pjesë të ndërmjetme mes së djathtës dhe së majtës, - një pjesë që nuk është as e djathtë e as e majtë, por që qëndron midis tyre, - mund të përkufizohet si vizioni i së Tretës së përfshirë (po aty: 10,11).

Ekzistenca e kësaj të trete të përfshirë sipas Bobios nuk e përjashton dikotominë, madje dëshmon të kundërtën, praninë e saj (dhe falë kësaj bëhet edhe vetë e pranishme). Kjo, e nyjton sistemin, vazhdon ai, por nuk përjashton antitezën. Në instancë të fundit *dishepulli i dikotomisë* vëren se nuk ka provë më të fortë të qëndrueshmërisë së modelit konfliktual e majtë/e djathtë se *prania brenda një universi pluralist e një të majte që priret ta quajë qendrën si maskë të një të majte që nuk dëshiron të dalë në skenë e tillë, pra si e majtë*.

Rruga e tretë që do të futej në fjalorin politik disa vite pas botimit të *E djatha dhe e majta*, dhe do të përdorej nga presidenti amerikan Clinton dhe kryeministri britanik Tony Blair, përvijohet edhe pse zbehtë, nga Bobbio. Në ndryshim nga ‘qendra’, sipas tij ‘rruga e tretë’ nuk është një përpjekje për një vend midis së djathtës e së majtës por *përtej së djathtës e së majtës*. Edhe pse e konsideron praktikisht një politikë të qendrës, çdo e tretë të bën të mendosh edhe për dy njësi të tjera, pra një të parë e një të dytë.

Çdo përfytyrim i një të Trete paravendon medoemos dy entitete të tjera; por e Treta e përfshirë e zbulon thelbin e vet duke i nxjerrë ato dy entitete jashtë vetes, ndërsa e Treta përfshirëse duke u ushqyer me to; e Treta e përfshirë paraqitet kështu si një praktikë pa doktrinë, ndërsa e Treta përfshirëse si një doktrinë në kërkim të një praktike, e cila që nga momenti kur nis të realizohet, shfaqet si pozicion centrist.

Në pamje të parë teoria e një ‘rruge të tretë’ më shumë duket si një spekulim intelektualist për tezën e trajtuar këtu, sidomos po të mbajmë parasysh periudhën kohore dhe vendin që shqetësojnë këtë punim, pra Shqipërinë në vitet ‘90-‘92. Sigurisht, mund të pretendohet se termat atitetikë e majtë/e djathtë në atë kontekst mund të zëvendësoheshin fare mirë nga komunizëm/antikomunizëm dhe kjo do të mjaftonte, pa qenë nevoja për të elaboruar, duke përdorur Norberto Bobbio-n, idenë e një rruge të

tretë. Megjithatë, siç vihet re në kapitullin III, ky diskutim ka qenë pjesë e repertorit politik. Pa përdorur terminologjinë, ende të panjohur për peizazhin politik shqiptar të kohës, të Rrugës së Tretë, por duke shfaqur shqetësime të një *pale të tretë*. Një pjesë e mirë e autorëve të cituar në Kapitullin III flasin për ‘bezdinë’ e një faktori të tillë, si komunistët në pushtet, ashtu edhe eksponentë të lëvizjes antikomuniste. Kjo *palë e tretë* identifikohet si *partitë e djathta konservatore* të para Luftës së dytë Botërore, të tilla si Balli Kombëtar apo Legaliteti. Partia e Punës në pushtet, kur harton ligjin për lejimin e pluralizmit, sigurohet që parti të tilla të konsiderohen të jashtëligjshme. Ky fakt e shtyn Lëvizjen e Legalitetit (partia e ndjekësve të Mbretit Zog) që, fillimisht, të regjistrohet si Partia Nacional-Demokrate dhe më vonë t’i rikthehet emrit të parë.

Kjo dëshmon faktin se kur *rruga e parë* dhe *e dytë* janë të *vetëmjaftueshme*, ato bëhen edhe *përrjashtuese*. Në rastin e komunistëve shqiptarë të fillimit të viteve ’90, kemi të bëjmë më shumë me urrejtjen patologjike ndaj kundërshtarëve të vjetër; por ideja përrjashtuese mund t’i mvishet opozitës antikomuniste të kohës, e cila shihte te partitë tradicionale të së djathtës një konkurent për pushtetin e nesërm. E kundërta ndodh kur partitë apo fashat brenda një force politike nuk ndihen të vetëmjaftueshme; atëherë lind ideja *përfshirëse*. Sali Berisha u afrua me përfaqësues të forcave konservatore të djathta, [siç dëshmon Zogaj], kur liberalët e shtuan intensitetin në luftën e brendshme për të kapur pushtetin në PD.

Në fjalët e Bobbio-s *kombinimi triadik lind kurdoherë në gjirin e një krize*, pra nga frika se mos ka shteruar vitaliteti historik i një antiteze. Kjo, sigurisht do të vinte shumë më vonë në politikën shqiptare, në mes të viteve 2000, kur lideri i socialistëve Edi Rama hodhi tezën ‘përtej së majtës e së djathtës’, por në kushtet e pluralizmit ende të brishtë

shqiptar, kombinimi me një *të tretë*, u pa si manovër shpëtuese në luftën për pushtetin e brendshëm.

Një tjetër shembull tipik historik i sintezës së të kundërtave, - i nxjerrë këtë radhë nga historia e së djathtës, kur kjo e fundit vuante një krizë po aq të rëndë, - mund të gjendet në ideologjinë e revolucionit konservator, të ngjizur pas Luftës së Parë Botërore si përgjigje e së djathtës ndaj revolucionit përmbysës, falë të cilit e majta kishte marrë fuqinë në një vend të madh e dukej se po e merrte edhe gjatë. Por për sa i takon temës sonë, dmth kundërvënies e djathtë-e majtë dhe zhdukjes së skajeve të saj, një teori e së Tretës përfshirëse mund të interpretohet, për nga qëllimet, si një sintezë të kundërtash; ndërsa në praktikë si një orvatje e një pale për të shpëtuar çka mund të shpëtohet nga pozicioni i vet, duke e përthithur e duke e neutralizuar pozicionin kundërshtar. (po aty: 14, 15).

Kur flasim për diadën e majtë/e djathtë dhe për pretendimet e disa studiuesve për rënien e saj, nuk mund të mos marrim parasysh kontekstin. Si i tillë, argumenti duhet të mbajë parasysh se bota e dalë prej Luftës së Ftohtë u përball me atë që mund të quhet *triumf i së djathtës*: në kohën kur ra Muri i Berlinit, dhe bashkë me të u delegjitimua edhe socializmi botëror, tri fuqi të mëdha të Perëndimit drejtoheshin nga parti të djathta dhe në pushtet ishin liderë konservatorë si Ronald Reagan në Amerikë, Margaret Thatcher në Britani dhe Helmut Kohl në Gjermani. Edhe në vende ndoshta më pak domethënëse në përballjen Perëndim-Lindje si Franca, Italia apo Spanja, e majta ishte në rënie dhe e djathta në ngjitje, siç pohojnë autorë të ndryshëm, ndërmjet tyre J.M. Roberts.

Dy prej këtyre vendeve, Franca dhe Italia, ishin të përfshira në një intelektualizëm të majtë të përfaqësuar më herët nga Sartre e të ngjashmit e tij, dhe nga parti komuniste që ishte mbajtur larg pushtetit me mjete, mund të thuhet, ekstrapolitike. Rënia e komunizmit botëror krijonte zhgënjim ndër intelektualët e majtë, por edhe jepte nevojën e maskimit me një ideologji të re të ngjashme me atë që përmend Bobbio, së cilës i mëshon më vonë një intelektual i majtë britanik, Anthony Giddens, te *Rruga e Tretë*.

Pra lind nevoja, në fjalët e Bobbio-s, për të shpallur të kapërcyer diadën e vjetër e për ta mohuar atë, gjë që “ka të bëjë me konstatimin që ajo e ka humbur pjesën më të madhe të

vlerës së saj përshkimore, ngaqë shndërrimet e paprera të shoqërisë dhe dalja në skenë e problemeve të reja politike”.

Një problem i tillë politik është për shembull *mjedisi*, ose më saktë mbrojtja e tij. Kjo ka sjellë edhe daljen e partive të gjelbra të cilat kanë si flamur të programeve të tyre ndërgjegjen e një bote të gjelbër, pra individin politik që nuk vepron vetëm si *homo economicus*. Por, kemi edhe problem të vjetra, zgjidhjen e të cilëve, e majta dhe e djathta e shohin në mënyra të ndryshme. Meqë po flasim për probleme morale, vëren Bobbio, të dy palët e kundërvëna janë në fronte të ndryshme siç ndodh zakonisht me universin moral: në lëshimtarë (laksistë) e në rigoristë. Ai pranon megjithatë *se ka një të majtë rigoriste e një të djathtë lëshimtare, dhe anasjelltas*.

Bobbio i ndan mohuesit e dikotomisë në ata që e quajnë të kapëcyer për shkak të a) kotësisë: është e kotë të vazhdohet të ndahet universi politik në bazë të kriterit të ideologjive, në një kohë kur vetë ideologjitë nuk ekzistojnë më); b) paplotësisë: është e pamjaftueshme ndarja e universit politik në dy pole, në një kohë që konstatohet ekzistenca e një poli të tretë, s’ka rëndësi nëse të ndërmjetëm ose të epërm); c) anakronizmit: janë shfaqur, në skenën politike, programe, probleme e lëvizje që nuk ekzistonin atëherë kur lindi diada e as kur kjo e përligjte veten.

Për t’iu kthyer edhe njëherë kontekstit, i cili është i dorës së parë, duhet rikujtuar se Bobbio i argumenton tezat e veta si *kundërvënie ndaj një kundërvënieje*. Domethënë pretendimit të intelektualëve apo ideologëve të djathtë për kotësinë e diktomisë, duke qenë se njëra ideologji, komunizmi/socializmi/e majta, kishte rënë apo e kishte humbur ‘luftën’. Si kundrapeshë, Bobbio paraqet fakte të mbizotërimit, jo të zhdukjes, të njëjës

ideologji përkundër tjetrës. I tillë është rasti i Italisë së pas Bashkimit apo fashizmit, raste kur epërsia e së djathtës përcaktoi kontekstin politik

Kur fashizmi, i konsideruar si lëvizje e së djathtës, u shemb me bujë e, - me plot të drejtë, të paktën sipas pjesës më të madhe të opinionit publik botëror, - e majta u ngjiti, për kontrast, aq lart sa u duk se e djathta ishte zhdukur ose të paktën se e kish humbur reputacionin aq shumë, sa ato pak grupe a lëvizje që guxonin të vetëqueshin të djathta (pse një gjë e tillë do të merrej gati si një provokim) do të zinin vend, bash për këtë arsye, në zgrip të skenës politike (po aty: 20).

Historia përsëritet dhe partitë e asaj pjese të spektrit politik që Bobbio quan ‘zgrip’, sipas rastit të majta apo të djathta, kur ideologjia e tyre është në rënie të lirë, përvetësojnë apo artikulojnë nevojën e një kalimi apo kapërcimi që sheh përtej së majtës e së djathtës. Diada shihet kështu si e panevojshme, e pafrytshme, e tejkaluar dhe në kohë për t’u zëvendësuar. Sipas artikulimit të studiuesit: shfuqizimi i diadës kthehet në një mjet të natyrshëm për të fshehur dobësinë.

Kjo tendencë u vërejt e fortë në fillim të viteve ’90, dhe për arsye që merren me mend. Rënia e komunizmit, një rend shoqëror dhe ideologji e ‘ekzaltuar, për një kohë të gjatë, si shprehje e përparimit të pandalshëm të së majtës në shoqërinë e përbotshme, sipas Bobbio, i zhvendosi raportet ideologjike të forcës. Ishte radha e së djathtës për të kapur skeptrin e fitimtarit dhe e së majtës për të provuar zgripin. Prej kësaj të fundit, apo ideologëve të saj, regëtinë shpresat për një kapërcim të diadës.

Kuptimplotë është rasti i një konference politologjike të mbajtur në Torino në dhjetor 1992 logoja e së cilës ishte “ëhat is left”. Frazë që, jo paradoksalisht, shpreh dy gjëra që mund të përmbliidhen në ‘çfarë është e majta’ dhe ‘çfarë ka mbetur’ [prej saj], Bobbio ripërsërit idetë laryshe të kësaj konference që shkojnë nga fatalizmi për një të majtë që nuk ekziston më dhe deri te relativizmi. Vermeersch (1991) në artikullin *The left in Eastern Europe* artikulon se në vendet e Europës Lindore zgjedhjet e para demokratike

u zhvilluan pa qenë nevoja që midis partive në garë të përvijohet dallësi e djathtë /e majtë. Duke qenë se rasti specifik i Shqipërisë, dhe jo konteksti më i gjerë euro-lindor i intereson këtij punimi, duhet sqaruar se në fakt, siç patë në Kapitullin III, diada u shfaq në ligjërimin politik shqiptar, edhe pse e drojtur. Se të paktën pandehma, apo për disa ‘kërcënimi’ i saj ekzistonte, e dëshmon kuadri ligjor i pushtetit komunist të kohës i cili i shpalli ‘të jashtëligjshme’ partitë e së djathtës tradicionale.

Bobbio arsyeton me të drejtë se: edhe në këtë rast nuk mund të mos pranohet se zhdukja e supozuar e diadës lidhet me një anomali të situatës kalimtare nga totalitarizmi në demokraci; duket e logjikshme të parashikohet se në një të ardhme të afërt, kur të jenë stabilizuar institucionet demokratike, ka të ngjarë që partitë të grumbullohen sërish rreth dy poleve tradicionale. Në Shqipëri, edhe pa u stabilizuar institucionet, mund të thuhet se dikotomia e djathtë /e majtë u rikthye e fortë dhe kulmoi 5 vjet pas ardhjes në pushtet të ‘antikomunistëve’ me një referendum për Monarkinë, ndoshta forma më e shprehur e së djathtës konservatore në Shqipëri.

4.1 ‘Fundi i historisë’, por dikotomia mbijeton

Siç dëshmohet nga kapitulli III, shqetësimi i diskurit publik në Shqipërinë e fillimdekadës së fundit shekullit 20 nuk ka qenë dikotomia e djathtë /e majtë, sa liria e shprehjes dhe të drejta të tjera themelore të njeriut, koncepte të paartikuluara gjatë regjimit komunist.

Ligjërimi politik i kohës që i mbushur me terma të tillë si *demokratizimi*, *liria e fjalës*, *liria e lëvizjes*, *antikomunizëm*, *Europa*, *vlera europiane*, e të tjera. Termat e djathtë /e majtë përdoren për të përshkruar ekstremitete politike. Në këtë kuptim, realitetet

shqiptare nuk përputhen me debatin në Perëndim që përshkruan Bobbio ku ‘termat “e djathtë” dhe “e majtë” mbeten nga më të përdorurit në ligjëratën politike’.

Pamja politike e Shqipërisë së asaj kohe mund të përshkruhet nga një tjetër diadë, që evidentohet këtu:

Vetë kategoria e politikës paraqitet, nga një teori mjaft e përhapur, nëpërmjet diadës “miku-armiku”, e cila përmbledh, në një nivel të lartë abstraksioni, idenë e politikës si truall të antagonizmit, forma më e skajshme e të cilit është lufta, e cila është naturaliter dikotomike (mors tua vita mea). Në luftë, qoftë kjo e jashtme, qoftë e brendshme, nuk ka vend për një palë të Tretë, e cila nuk shfaqet veçse në trajtat e ndërmjetësit, që rreh t’i japë fund, ose të arbitrit, që do të vendosë paqen (po aty: 39).

Duke i mëshuar një vizioni aksial të politikës, dhe duke ngulmuar që lojtarët preferojnë të mbeten dy, (dhe kështu ndodh), Bobbio flet për ndarjen e majtë /e djathtë, dhe për vendin e rëndësishëm që merr në ligjërimin politik, si një *metaforë hapësinore*, duke i shtuar asaj edhe të tjera si *metafora kohore*, që ndan novatorët nga konservatorët, progresistët nga tradicionalistët.

I rëndësishëm është qëndrimi i tij sa i takon vlerësimit për ligjëratën politike e cila ‘nuk ka zakonisht përpikmërinë e duhur’. Kjo na lejon që termat antitetikë e djathtë/ e majtë t’i zëvendësojmë, në truall shqiptar, me të ngjashmit **komunist/antikomunist**, ndoshta fjalët më të dendura në fjalorin politik shqiptar të (para)tranzicionit. Të pajtohemi gjithashtu, se kjo kundërvënie, ashtu si ajo e përdorur prej Bobbio-s merr dy lloje kuptimesh: *përshkrimor* dhe *vlerësimor*.

Nëse kuptimi përshkrimor e lejon deri në njëfarë mase neutralitetin, domethënia vlerësimore do të thotë një kategorizim kundërvënës shterrues dhe antitetik, ku ngjyrimi pozitiv i njërit nënkupton ngjyrimin negativ të tjetrit. Në periudhën të cilën ka në

trajtesë ky punim, në Shqipëri, termi *antikomunist* kategorizohet si pozitiv dhe e kundërta mund të thuhet me siguri për termin *komunist*.

Siç vëren Bobbio, ndoshta rasti më ‘flagrant’ i dykuptimësisë vlerësimore është fjala *barazi* ndër të majtët e të djathtët. Nëse te të parët kuptohet si *barazitizëm*, për të dytët përbën një *renditje hierarkike*. Analogjia më e saktë në rastin shqiptar do të ishte secila prej fjalëve që përbjën togfjalëshin *liri-demokraci*. Nëse *liria* merret automatikisht si përshkruese e një gjendjeje apo ideologjie të djathtë (liria e tregut, e sipërmarrjes, nga shteti, etj), *demokracia* nënkupton një gjendje të majtë (një *laissez faire* moral dhe një barazi e popullit në të njëjtën kohë). Bashkimi i këtyre dy ‘të kundërtave’ në një slogan apo kredo, që përbënte pendulin social më shumë se ideologjik të diskurit të Shqipërisë së fillim viteve ’90, dëshmon se e djathtë /e majtë është një antitezë ende e pafutur në qarkullim, por e përfaqësuar, deri në një kohë të dytë, nga kundërvënia tjetër, komunist/antikomunist.

4.1.1 Kriteret dalluese

Pretendimi i një filozofi se politika nuk duhet t’i përshtatet arsyetimit njerëzor, por natyrës njerëzore, pjesë e së cilës është arsyeja, dhe në asnjë mënyrë pjesa më e madhe’ (Burke, 1981) do të qe ndoshta një kriter domethënës dallues mes së majtës dhe të djathtës. Dhe, ja ku lind një dikotomi e re, për qëllim të kësaj teze, e cila kundërvë *racionalizmin* me *tradicionalizmin*. Burke në debatet me Thomas Paine ishte mbrojtës i flaktë i sentimentit dhe natyrës njerëzore, duke i dhënë shumë rëndësi traditës e cila sipas tij përbënte thelbin e çka ai konsideronte *të djathtë*, të cilën ia kundërvinte parimeve të Revolucionit francez.

Për Burke-n termi ‘i djathtë’ ka një ngjyrim univok, pra gjithmonë pozitiv dhe e njëjta gjë sipas Norberto Bobbio-s mund të thuhet edhe për ligjëratën fetare, ku ‘të mirët ulen në të djathtë e të ligjtë në të majtë të Atit’. Në diskurin politik metaforat janë ekuivoke: të dyja, e djathta, dhe e majta, mund të përfaqësojnë kahun pozitiv ose negativ të diadës. Ndryshimi këtu bëhet nga pala që e bën dallimin apo gjykimin. Ata që janë të majtë apo afër së majtës shohin negativisht të djathtën dhe principet e saj, dhe anasjelltas.

Autorë të shumtë, një prej të cilëve, Laponce, mendojnë se në ligjëratën politike e majta shoqërohet gjithnjë me tipare tepër pozitive, siç do të mund të ishin *e ardhmja, krijimtaria, drejtësia*. Por jo vetëm ai. Naom Chomsky, Gore Vidal, George Lakoff e të tjerë, i shohin vlerat e së majtës si më përparimtare.

Duke ndjekur logjikën e Laponce-s, ndër dallimet, ndoshta më ortodoksi është ai fetar apo çka Bobbio quan dallimi mes *së shenjtës* dhe *profanes*. Brenda tij, vazhdohet me arsyetimin, *gjejnë vend edhe plot dallime të tjera, si ai midis rendit hierarkik dhe rendit barazimtar dhe ai midis qëndrimit tradicionalist, përkrahës të vijueshmërisë, dhe qëndrimit progresist ose të orientuar nga e reja, përkrahës të shkëputjes, të pavijueshmërisë*.

Nëse arsyetimin laponcian e marrim dhe ia mbivendosim kontekstit shqiptar, e gjejmë autorin kanadez në të drejtë. Pse kështu? Sepse Shqipëria e viteve ’90-’92 ishte, ndër të tjera, një vend në limbo, jo vetëm sa i takon ideologjive politike apo politikave ekonomike, por e tillë edhe në kuptimin e dogmës fetare. Megjithëse një nga shenjat e para të hapjes, siç del në kapitullin III, është mesha e Krishtlindjes mbajtur në varrezat e Rrmajit në Shkodër në vitin 1990, kontaktet fetare ishin ende të nën trusninë e ateizmit zyrtar të shpallur nga regjimi i Hoxhës në vitin 1967. Kishat dhe xhamitë ishin kthyer në

qendra kulturore ku edukohej apo ‘farkëtohej’ *njeriu i ri komunist*: ateist, materialist, antikapitalist, me besim të patundur te ‘nëna Parti’. Profeti i ri i shqiptarit ishte Enver Hoxha. Partia e Punës, që e kishte pushtetin në atë kohë, alias Partia Komuniste, e cila do të shndërrohej pa kaluar shumë në Parti Socialiste, e bënte skenën politike shqiptare të kohës të korrespondonte me përfundimin *feja është në të djathtë, ateizmi në të majtë* (Laponce, 1981).

4.1.2 Kritere të tjera

Studiuesit janë ndalur te domethënia dhe impakti i rënies së ideologjisë marksiste-leniniste, që lidhet më shumë se me asgjë tjetër me shpërbërjen e perandorisë sovjetike dhe, rrjedhimisht, shembjen e komunizmit përballë kapitalizmit. Një prej tyre e ka trajtuar këtë temë disa herë. Edhe pse, sipas tij, me shembjen e marksizëm-leninizmit mori fund njëherë e mirë interpretimi manikeist i kundërvënies e djathtë /e majtë, një pjesë e kuptimit mbetet. Kështu “çlirimi i njeriut nga sundimi i padrejtë dhe shtypës [...] mbetet, në analizë të fundit, thelbi i patjetërsueshëm i së majtës si “kategori politike”, në gjendje t’i bëjë ballë çdo lloj procesi çmitizues”. Të djathtën ai e sheh si “përfaqësuese të një modaliteti të njerëzores” duke qenë se shpreh “rrënjosjen në truallin e natyrës dhe të historisë”, “mbrojtjen e së kaluarës, traditës dhe të trashëgimisë” (Confrancesco, 1990).

Confrancesco paraqet një ndarje apo kriter të ri për të dalluar të majën nga e djathta. Nëse Laponce sheh *të shenjtën* si përkufizuese të së djathtës, ai sheh *traditën*. Ndërkohë që e majta ka *emancipimin* si kuadratim kryesor. Vëreni se kundërvënia nuk është antagoniste duke qenë se, si *emancipimi* ashtu dhe *tradita* shenjojnë vlera pozitive dhe jo e kundërta. Tradita, atëherë bashkë me variabla të saj, mund të na shërbejë si një

përcaktor i vlerave të së djathtës dhe mënyra si e sheh e majta atë i jep jetë një dikotomie që vazhdon, por sipas cilësish dhe kundërvëniesh të tjera.

Siç e thotë Bobbio: Shpirti i së djathtës mund të shprehet përmbledhtas në moton: “asgjë jashtë traditës e kundër saj, gjithçka brenda traditës e për të”. Por, a mund të thuhet se ekzistojnë po aq të djathta sa çka edhe tradita? Ka, në fakt, kuptime të ndryshme që mund t’i jepen traditës dhe Confrancesco evidenon gjashtë të tilla:

1-tradita si arketip;

2-tradita si përcaktim ideal i një epoke aksiale, ose vendimtare, në historinë e njerëzimit;

3-tradita si besnikëri ndaj kombit;

4-tradita si kujtesë historike;

5-tradita si të pasurit të njëjtin fat;

6-tradita si vetëdije e kompleksitetit të realitetit.

Gjashtë llojet e traditës na vendosin para një përfundimi të sigurt të asaj që mund të quajmë ‘relativitet të politikës si kategori’ apo ndryshe ‘mungesë absolutizmi të konceptet politike’. Kjo vlen për të thënë edhe atë se e majta dhe e djathta mund ta pranojnë konceptin themeltar të njëra tjetrës, në këtë rast traditën dhe emancipimin, por sipas interesit apo qasjes së tyre. “Ndërrimi’ i vendeve nuk i jep fund të qenit të njërës e majtë apo e djathtë.

Confrancesco liston edhe një varg temash të dyfishta, në kuptimin që ato mund të elaborohen apo mbrohen si nga e djathta ashtu dhe nga e majta, pra u përkasin të dyja palëve dhe kjo nuk e prek kundërvënien thelbësore të dikotomisë:

1-militarizmi;

2-laicizmi;

3-antikomunizmi;

4-individualizmi;

5-përparimi teknik;

6-përdorimi i dhunës.

Ajo që duhet theksuar, meqë flasim për komunikim *politik*, (vetë kjo fjalë e fundit e bën automatikisht dallimin), është se ky kapërcim i diadës, edhe në tema që mund të ngjajnë jothelbësore bëhet, shpesh, për synime instrumentale. Fjala bëhet kështu një mjet i gjuhës që përlij qëllimin e politikës. Duhet kujtuar gjithsesi ndryshimi mes thelbësorës dhe instrumentales, i cili i ndihmon kronikës së polemikës, por nuk e zhvlerëson diadën.

Një tjetër autore (Galeotti, 1990) shkruan për nevojën e të shquarit të *konteksteve* ku përdoret diada. Këto kontekste sipas saj janë katër: *ligjërata e zakonshme, ligjërata ideologjike, analiza historike – sociologjike, studimi i imagjinatës shoqërore*. Nëse Laponce sheh traditën dhe profanen dhe Confrancesco traditën dhe emancipimin si dallesë të diadës e djathtë / e majtë, Galeotti përzgjedh dy terma të tjerë: *hierarkinë* për të djathtën dhe *barazinë* për të majtën.

Bobbio rimerr Revelli-n, duke theksuar pesë kritere të dallimit mes të majtës e të djathtës:

-sipas kohës (progres-konservacion);

-sipas hapësirës (barazi-pabarazi);

-sipas subjekteve (vetëdrejtim-tjetërdrejtim);

-sipas funksionit (klasa inferiore-klasa superiore);

-sipas modelit (racionalizëm-iracionalizëm).

4.2 Barazia dhe liria si kritere themeltare

...kriteri më shpesh i përdorur për të dalluar të djathtën nga e majta është qëndrimi i ndryshëm që njerëzit, si qenie shoqërore, mbajnë përballë idealit të barazisë, i cili krahas atyre të lirisë e të paqes është një nga qëllimet e fundme që këta njerëz i vënë vetes e për të cilët janë të gatshëm të ndeshen (Bobbio, 1996: 68).

Megjithë shenjimin e barazisë si themeltare për diadën e majtë /e djathtë, pranohet se barazia është gjithsesi një koncept relative, jo absolut. Dhe është i tillë, sipas tij, për shkak të të paktën tri variablave: *subjektet mes të cilëve duhen rishpërndarë të mirat materiale e jomateriale; të mirat materiale e jomateriale që duhen rishpërndarë; kriteri në bazë të të cilit do të kryhet kjo rishpërndarje.*

Thënë ndryshe: kujt i jepen? Kujt i takojnë ose kush i meriton këto të mira? Cilat janë këto të mira (materiale ose jo) që duhen shpërndarë? Një parimi barazie gjithpërfshirës absolut; një pabarazie natyrore të trashëguar, apo një ndërhyrjeje nga lart (prej shtetit) e cila nga ana e saj mund të shihet si absolute ose relative?

Duke sjellë shembullin e vdekjes, si më barazimtarja ndër faktet e jetës, Bobbio tregon megjithatë se edhe ajo është ‘e pabarabartë’: të gjithë vdesim, domethënë jemi të

barabartë në vdekje, por jemi të pabarabartë në kohë dhe në mënyrë, pra se si dhe kur vdesim.

Vlen të bëhet dallimi mes asaj që quhet *e drejtë natyrore* dhe *e drejtë shoqërore*. Ata që besojnë te barazia e njerëzve e bëjnë këtë nisur nga premisa se pjesa më e madhe e pabarazive janë shoqërore dhe shoqëria mund dhe duhet t'i mënjanojë. Ata që e shohin pabarazinë si të pashmangshme nisen nga premisa e kundërt, sipas së cilës ato (pabarazitë) rrjedhin prej natyrës dhe kësisoj janë të 'pashërueshme' me ndërhyrje shoqërore.

Të ndara sipas një boshti aksiologjik, e majta dhe e djathta janë përfaqësuese të barazisë dhe pabarazisë, apo hierarkisë. E djathta sheh atë që është natyrore, ku futet edhe 'natyra e dytë' që themelohet nga tradita, zakoni, e shkuara. E majta përballë 'natyralizmit' të së djathtës vendos atë që Bobbio quan 'artificializëm' për të cilin ai përdor një shembull brutal *lufta për t'i nxjerrë të sëmurët mendorë nga çmendinat*.

Nëse 'barazia' mund të jetë thelbi i së majtës, duke i dhënë të djathtës 'hierarkinë', çfarë mund të thuhet për 'lirinë'? Kujt i përket ajo, apo kë përshkruan më mirë?

Por dallesë mes libertarizmit dhe autoritarizmit, sado historikisht po aq rëndësore sa ajo mes barazitarizmit dhe pabarazitarizmit, nuk përputhet me dallesën mes së djathtës dhe së majtës. Doktrina e lëvizjes libertare e autoritare ka edhe në të djathtë, edhe në të majtë, e kjo ndodh ngaqë kriteri i lirisë shërben për të përshkruar universin politik jo aq në lidhje me qëllimet, sesa në lidhje me mjetet, ose me metodat që duhen përdorur për t'i arritur këto qëllime: ky kriter ka të bëjë kështu me pranimin ose me refuzimin e metodës demokratike, të kuptuar si një bashkësi rregullash që lejojnë të merren vendime kolektive nëpërmjet debatesh të lira e zgjedhjesh të lira e pa përdorimin e dhunës.

Në funksion të hipotezës së këtij studimi, dhe të kontekstit historik të kohës, nuk mund të mos theksohet se e djathta, qoftë kjo liberale apo konservatore, u bë sinonim i lirisë.

E majta europiane, edhe ajo italiane apo franceze, edhe ‘pesha të rënda’ të saj si Sartre, flirtuan me stalinizmin duke i dhënë *logjistikë intelektuale* në Perëndim. Siç argumentohet në kapitulljt pararendës, një aleancë mes atyre që vetë autorët e cituar nga Bobbio i konsiderojnë kategori të së djathtës, *e shenjta* (Kisha Katolike), *hierarkikja* (Margaret Thatcher në Britani) dhe *konservatorja* (Ronald Reagan në Amerikë) ishin ‘sipërmarrës të lirisë’ krahasuar me komunizmin e diskredituar politikisht, ekonomikisht dhe kulturisht të Lindjes.

4.3 Impulsi konservator

Një preambul e idesë se Berisha është konservator, apo se shfaq shenja të konservatorizmit, mund të formulohet duke patur parasysh kontekstin historik e politik të kohës të marrë në shqyrtim në këtë punim. Siç e kemi shënuar, një president konservator kish përfunduar dy mandate në Shtëpinë e Bardhë për t’ja lënë vendin mandatit të tretë të një tjetër konservatori. George H. Bush pasonte Ronald Reagan-in, por edhe politikat e tij të antikomunizmit. Ky i fundit u quajt ‘ndoshta i pari president në historinë amerikane që me krenari e kishte shpallur veten konservator, pa variacione liberale apo progresiste’ (Nisbet, 2002: 143).

Duke folur për ngjyrimet ideologjike në Amerikë, Nisbet thekson se ndryshe nga Britania, impulsi konservator në Amerikë, deri vonë, nuk ishte i përqendruar apo i përfaqësuar nga një bllok unik politik. Edhe Demokratët e së majtës, kishin në gjirin e tyre konservatorë. Këtë mungesë të ndarjes si me thikë të ideologjikes, ai e gjen te ‘mungesa ose të paktën dobësia e një tradite feudale në Amerikë’.

Mungesa e kësaj tradite dhe ndarja ideologjike jo ekstreme nuk është se e ka lënë Amerikën një vend pa sentimentin apo idenë konservatore. Ajo ide gjendet te vlerat

personale apo familjare edhe pse ato nuk mund të jenë të tubuara medoemos në një bllok apo shprehje politike në formën e një partie.

Megjithatë nuk mungonin amerikanët që besonin besnikërisht te të vërtetat konservatore: një shtet minimal, një qeveri e fortë, por e rezervuar, laissez-faire në shumë fusha, familja, fqinjësia, komuniteti lokal, kisha dhe grupe të tjera ndërmjetëse për të përballuar shumicën e krizave, decentralizimi, lokalizmi dhe parapëlqimi për traditën dhe përvojën ndaj planifikimit racional dhe, pra, një paragjykim i pamposhtur ndaj masave rishpërndarëse (po aty: 144).

Kur vjen puna te mendimi intelektual amerikan, ky autor thekson se është pothuajse në gjendje *tabula rasa* sa i takon konservatorizmit. Të paktën pas Luftës Civile, kohë kur, vëren ai, nuk ekzistonte më një klimë konservatore në studime, filozofi dhe letra. Gjithashtu, në fillim të shekullit XX, në aulat e universiteteve, nuk mund të pikasje ndonjë konservator: Santajana, një përjashtim i madh u largua për në Europë; mësimet e Irving Bebetit dhe Morit u morën vetëm nga studentët e tyre, pak veta domethënë.

Kthesën, sipas tij e sjell revolucioni studentor i viteve '60. Më saktë efekti bumerang i tij: njerëzit përqaftuan mendimin konservator pikërisht si reaksion ndaj 'teprimeve revolucionare' të lëvizjes së studentëve. "Nisën të shfaqeshin artikuj, ku fjalët *autoritet, rend civil, traditë dhe kontratë shoqërore* qenë kryesoret' vëren autori i 'Konservatorizmit'.

Ajo çka vjen më poshtë në këtë kapitull është përpjekja për të gjetur dhe vendosur piketa të konservatorizmit, të cilat më pas do t'u mbivendosen aktiviteteve të Berishës, më saktë diskurit të tij, fjalimeve, intervistave etj, për të bërë njëfarë reflektimi e më pas përfundimi, mbi atë se a ka përqaftuar apo elaboruar Berisha i fillimeve të tranzicionit një diskur konservator?

Shenja e parë e madhe e identifikuar, siç kemi parë në kapitujt pararendës, një mjedis politik konservator në Amerikë dhe një superioritet i së djathtës botërore (lexo rrëzimi i

komunzimit), shkon në favor të kësaj shtyse. Siç do ta ndeshim në kapitujt vijues, Berisha është i pari që formulon një ide konservatore të mirëfilltë, atë të *kombit*. Ai, sipas Biberajt, është i pari intelektual që, në artikullin të *Bashkimi*, flet për të drejtat e shqiptarëve të Kosovës, pjesës tjetër të kombit shqiptar. Kjo është një shenjë e dytë. Shenja të tjera do të mblidhen nga ky punim në vijim, por në fillim do të vendosen piketat për të cilat folëm që në krye të kësaj nëndarjeje.

4.4 Prona: ngulitur në të drejtën romake

Edmund Burke, i njohur si themeluesi i konservatorizmit modern, në kritikën ndaj Revolucionit Francez e ka gjetur fajtorin: *jam i sigurt që shkrimet e Rusoit çuan drejtpërdrejt te ky lloj i turpshëm i së keqes*.

Nuk mund të kishte ‘lloj më të turpshëm të së keqes’ për Burke-n sesa *sulmi jakobin ndaj pronës*. Revolucioni Francez u përqendrua te prishja e çdo tekstore pronësie që zotërohej nga ente të tilla si familja, kisha, gildat e të tjera. Edmund Burke shpall me lehtësi se është për feudalizmin dhe argumenton, përkundër mendimit iluminist, se rendi feudal është në pajtim me natyrën njerëzore. Siç theksohet te *Konservatorizmi-Endrra dhe realiteti* ‘për traditën konservatore pak gjëra mund të ishin më të përbuzshme sesa qëndrimi i Revolucionit ndaj pronës’.

Familja, një tjetër vlerë themeltare e konservatorizimit, ura e madhe që i mbante të hapura e të forta lidhjet me traditën, u prek nga fryma dhe legjislacioni i revolucionit jakobin, gjithashtu. Ideologët e Revolucionit, të cilët, si Burke ashtu dhe Tocqueville, i shihin me përçmim dhe i quanin ‘filozofë’, mendonin se struktura farefisnore ishte “kundër natyrës dhe e papajtueshme me arsyen”.

Në teorinë konservatore të pronës private ka një karakter të fortë romak. Prona është më shumë se një shtojcë e jashtme e njeriut, më shumë sesa një shërbyes jofrymor i nevojave njerëzore. Në të drejtën romake dhe veçanërisht në tabelat origjinale dhe në të drejtën e Republikës rrënja dhe kuptimi thelbësor i familja është prona - prona e paluajtshme; në radhë të parë toka, por edhe e gjithë prona që është në zotërim të trashëgueshëm të patria potestas, e drejta e familjes. (Nisbet, 2002: 96)

Kur krahason Revolucionin francez me atë amerikan, Burke sheh një antitezë. Sipas tij, nëse amerikanët kërkonin çlirim nga pushteti arbitrar, jakobinët në Francë e bënë revolucionin për një njeri i cili nuk jetonte, nuk kishte lindur ende, por mund të inxhinierohet përmes arsimit, bindjes dhe, më të frytshmes ndër format jakobine, terrorit e shtypjes. Duke bërë një përqasje mes konteksteve, pavarësisht distancës në kohë, fillimi i viteve '90 në Shqipëri, e gjente shqiptarin e modeluar pikërisht sipas përfytyrimit jakobinian të Revolucionit francez: një *njeri i ri* i trysnuar sa përmes kulturës së socrealizmit, aq edhe nëpërmjet formave të larmishme të dhunës shtetërore të aplikuara nga regjimi i Hoxhës.

Forma të një modeli jakobin, pjesë e 'Urdhëresave' të Komitetit të Sigurisë Publike: "Ju mund ta rimodeloni plotësisht një popull që doni ta bëni të lirë, t'i shkatërroni paragjykimet, t'i ndryshoni shprehjet, t'i kufi zoni kërkesat, t'i çrrënjësoni veset, t'i pastroni dëshirat."

4.5 Tradita: të djathtëve u pëlqen të jetojnë në të shkuarën?

Tradita merr një vëmendje të madhe në mendimin konservator. Emile Faguet i quan konservatorët "profetë të së shkuarës". Apo Churchill: *më pëlqen të rroj në të shkuarën. Nuk mendoj se njerëzit do të kenë shumë kënaqësi në të ardhmen.* Kjo shoqëri ideale e së shkuarës bëhet një outpost prej nga konservatorët artikulojnë idetë e tyre të konsideruara si *reaksionare* nga kundërshtarët e tyre progresistë apo racionalistë. Por, askush më mirë se de Maistre-ja nuk mund t'i përgjigjej epitetit 'reaksionar' të përdour

shpesh për të përshkruar apo demonizuar të djathtën. Duke qenë i sigurt në kreditet e tij konservatore, ai shpallte: Ne nuk duam një kundër-revolucion, po të kundërtën e revolucionit”.

Nisbet i kthehet etimologjisë kur interpreton fjalën ‘trader’ si rrënjë të fjalës traditë (tradition) e cila, në fe dhe në jurisprudencë, do të thotë të transmetosh një “peng të shenjtë”. Pa harruar të theksojë se të jesh tradicional nuk do të thotë të jesh kundër ndryshimit në vetvete. Sipas Burke-s “Një shtet pa mjetet për njëfarë ndryshimi është pa mjetet e ruajtjes së vet.”

Tradita nuk mund të ndahet nga historia, e cila për konservatorët është themelore. Të dyja, me siguri, i bashkon eksperiencia njerëzore dhe e shkuara e parë si trashëgimi apo dhe si mësim. Mendimi i mëposhtëm i Burke-s ndoshta kryen një sintezë të raportit histori/traditë:

Shoqëria është në të vërtetë një kontratë... Ajo është një partneritet në shkencë, një partneritet në art, një partneritet në çdo virtyt dhe në çdo përkryerje... ajo bëhet një partneritet jo vetëm midis atyre që jetojnë, po midis atyre që jetojnë, atyre që kanë vdekur dhe atyre që do të lindin.

Ajo që për progresistët është nisje nga fillimi, viti zero i historisë, për konservatorët është vazhdimësi. Jo një konceptim mekanik i shoqërisë, por të parit e saj si një organizëm në lëvizje që nuk pushon një ditë për t’u rishpikur nga fillimi. Mund të thuhet se, nëse e djathta konservatore e pranon Zotin dhe të shenjtën, ajo nuk e ka kompleksin e Zotit: nuk e kërkon ndërtimin apo shpikjen e botës nga fillimi, dhe as një njeri të ri sipas modelit të saj, tradicional, puritan, historik, sakral apo çfarëdoqoftë.

Ajo çka kanë luftuar Bërkja dhe pasuesit e tij është ajo që ai e quante “frymë të rinovimit”, domethënë adhurimin mendjelehtë të ndryshimit për ndryshim; për nevojën e cekët, por depërtuese të masave për t’u zbavitur dhe gudulisur me anë të risive të pafundme. Veçanërisht vdekjeprurëse është fryma e rinovimit, kur zbatohet tek institucionet njerëzore. Pikëpamjes së Bërkes se kushtetuta e vërtetë e një populli mbështetet në historinë e

institucioneve të tij dhe jo në një copë letër, i është bërë jehonë vazhdimisht nga konservatorët deri në ditët tona (Nisbet, 2002: 60).

4.7 Autoriteti: I kodeve shoqërore, jo tirania e shtetit

Për cilin autoritet flet Nisbet kur pohon se ‘krahas pronës, ai është një nga dy konceptet qendrore të filozofisë konservatore’? Me siguri, jo për ‘shtetin e madh’ duke e ditur një aversion të konservatorëve, dhe të djathtëve në përgjithësi, për ‘tiraninë e shtetit’. Burke i përgjigjet kësaj duke thënë se bëhet fjalë për ‘autoritetin e traditave dhe të kodeve shoqërore’. Ndryshe nga të majtët, që e shohin lirinë si një problem të shtetit dhe individit, Burke dhe konservatorë të tjerë, thekson Nisbet, fusin në ekuacion edhe grupet ndërmjetëse, familjen, kishën, gildat e të tjerë.

Për të kuptuar diçka mbi autoritetin sipas mendimit konservator, mund të hidhen sytë nga kushtetuta amerikane e cila është në fakt një koncept i djathtë, po të mbash parasysh kujdesin kirurgjik të saj për *ndarjen apo balancën e pushteteve* (checks and balances), *qeverisjen indirekte dhe kufizimet qeveritare*. Nisbet sjell shembullin e refuzimit të Hamilton-it për të votuar një ligj të të drejtave personale, apo dhe Senatin si një krijim konservator, njëfarë barazpeshe ndaj ‘demokracisë direkte’ të Dhomës së Përfaqësuesve dhe parimit, të huaj për konservatorët, ‘një njeri, një votë’.

Nisbet bën kujdes për të sqaruar se konservatorët, kur bëjnë fjalë për qeveri të kontrolluar dhe me pushtet të kufizuar, nuk nënkuptojnë qeveri të dobët:

...nuk duhet të mendohet që konservatorët kanë qenë ose janë në favor të një qeverie qendrore të dobët. Aspak. Dallimi që bënte Tokëvili te Democracy in America midis qeverisë dhe administratës është, të paktën, i nënkuptuar thujse në të gjithë mendimin konservator. E para, shkruante Tokëvili, duhet të jetë e fortë dhe e unifikuar. Është kjo e fundit ajo që, në interes të lirisë dhe të rendit, duhet të jetë sa më e decentralizuar, e lokalizuar dhe, përgjithësisht, sa më e padukshme që të jetë e mundur.

Argumenti i Nisbet, mbështetur te zërat më të fortë të konservatorizmit modern si Burke, Tocqueville, de Maistre-ja e të tjerë, i mëshon faktit se në mendimin e djathtë ka një papajtueshmëri organike dhe absolute mes lirisë dhe barazisë. Dhe kjo sipas akademikut amerikan vjen ngaqë të dy vlerat kanë objektiva të kundërt. Sa më poshtë, vazhdon ai, përmbledhtaz, është pikëpamja, së cilës autorët konservatorë i janë përmbajtur gjithmonë, prej Burke-s e më tej, për lidhjen midis lirisë dhe barazisë:

Qëllimi i vazhdueshëm i lirisë është mbrojtja e saj për pronën individuale dhe familjare - një fjalë e përdorur në kuptimin e saj më të gjerë, duke përfshirë aspektet jomateriale dhe materiale të jetës. Nga ana tjetër, objektivi organik i barazisë është ai i një lloji rishpërndarjeje ose nivelimi të vlerave materiale dhe jomateriale, të ndara në mënyrë të pabarabartë, të një komuniteti. Për më tepër, duke qenë se forcat individuale të trupit dhe të mendjes janë të ndryshme nga lindja, të gjitha përpjekjet për ta kompensuar këtë larmi të forcave me anë të ligjit dhe të qeverisë vetëm mund t'i paralizojnë liritë e atyre që janë të përfshirë; veçanërisht liritë e më të fortit dhe më të aftit.

Sipas Edmund Burke-s, Revolucioni e kish zhvendosur kuptimin e lirisë nga *liria nga* në *liria për* që do të thotë liria për të marrë pjesë në një komunitet apo kredo. Te slogani i famshëm i Revolucionit *une et indivisible* Burke shihte asgjë më shumë se rrënimin e hapësirës së lirisë duke ia hequr atë individit për t'ja kaluar kombit. Ky bashkim apo unitet sipas tij nuk i linte hapësirë individit krijues dhe sipërmarrës.

Dorëzimi i individit para kauzave, për hir të popullit, bashkë me zotërimet e tij dhe të shkuarit në drejtimin e paditur të një bashkësie absolute dhe kolektiviste, është çka i ka ushqyer revolucionet, që nga ai Francez deri te Bolsheviku e të tjerë.

Duke vazhduar me argumentin konservator të lirisë dhe autoritetit Nisbet shkruan:

Akuza kryesore që i kanë bërë liberalizmit konservatorët është, dhe ka qenë që prej Bërkes, te Dousoni, Elioti dhe Kërku midis modernëve, që liberalizmi është një lloj preteksti i Judës për totalitarizmin. Argumentohet se, me ndikimin e vet të pandërprerë çlirimtar mbi autoritetet dhe rolet tradicionale në shoqëri, liberalizmi dobëson strukturën shoqërore, nxit shumëzimin e qenieve njerëzore të "tipit masovik" dhe, kështu, në mënyrën e vet, u shkel syrin mësuesve të totalitarizmit që janë në pritje.

4.8 Feja: rreziku i një kishe nacionaliste

Deriva konservatore ka gjithashtu të shtrenjtë Fenë dhe Zotin. Në një letër për të birin, Burke shkruan: “feja është kështjella e njeriut në një botë gjithsesi të pakuptueshme dhe, rrjedhimisht, armiqësore”. Duke besuar, sipas një filozofie thellësisht të krishterë, se të mungesat është liria, pra te kufizimet e 10 Urdhëresave për shembull, konservatorët shohin një lidhje të fortë mes besimit dhe lirisë.

Kur nuk ka më asnjë parim autoriteti në fe, sikurse dhe në politikë, njerëzit janë veçanërisht të frikësuar nga pamja e një pavarësie të lirë. Lëvizja e vazhdueshme e të gjitha sendeve përreth i alarmon dhe i mundon ata... Për sa më takon mua, unë dysjoj nëse njeriu mund të mbështesë ndonjëherë në të njëjtën kohë pavarësinë e plotë fetare dhe gjithë lirinë politike. Dhe unë jam i prirur të mendoj që, nëse besimi tek ai mungon, ai duhet të jetë i nënshtruar; dhe, nëse është i lirë, duhet të besojë (Nisbet, 2002: 116).

Duke cituar Chesterton-in [Rreziku i humbjes së besimit te Zoti nuk është se nuk do të besohet më tek asgjë, por, përkundrazi, se do të besohet te çdo gjë], Nisbet bën një lidhje, me vend në gjykimin tonë, mes fesë dhe feve sekulare, të atyre që proklamoheshin si ateiste, të tilla si marksizmi, frejdzizmi e të tjera. Për të, *feja qytetare* është më afër thelbit të besimit konservator *një fe ku bërthama transhendentale e shfaq veten në veshje si qytetare, ashtu edhe fetare*.

Megjithatë, konservatorët janë për një ndarje të qartë mes kishës dhe shtetit. Besimet personale, shkruan Nisbet, nuk duhet të ndërhyrjnë në strukturën publike të kombit. Edhe Thomas Eliot, poeti konservator, e ka predikuar këtë ndarje duke paralajmëruar se: një rrezik i përhershëm për një kishë zyrtare është erastianizmi... rreziku që një kishë kombëtare të mund të bëhet një kishë nacionaliste”.

4.9 Roger Scruton dhe tre ligjet e politikës

Një filozof bashkohës konservator britanik, e konsideron si një gjë të pazakontë të qenit intelektual i djathtë (Scruton, 2016: 1). Duke ilustruar përmes të atit idetë dhe sentimentet e majta dhe të djathta, Konservatore apo Laburiste, ai identifikon prirje të

djathta te individi në raport me gjërat e prekshme. Te i ati, një mbështetës i Laburizmit, Scruton dallon përkujdesjen e thellë për traditën, qytetin, komunitetin, atë që është thelbësisht britanike. Ai është kështu një konservator pa e ditur. Scruton citon një prej tre ligjeve të politikës të Robert Conquest, njëri prej të cilëve shpallte: *çdokush është i djathtë në çështjet që njej*.

Scruton, duke u mbështetur te T.S. Eliot, pranon se pikëpamjeve të tij politike u dha trajtë ideja se *ne duhet të jemi modernë në mbrojtje të së shkuarës dhe krijues në mbrojtje të traditës*. Te kreativiteti ose ideja e tij thellohet sërish filozofi britanik kur ripërcjell një vërejtje të kryeministres Thatcher sipas së cilës ‘sipërmarrësit krijojnë gjëra, ndërsa menaxherët i varrosin ato’. Scruton është kritik me atë që ai quan *kulturë të menaxhimit* dhe efektet e saj mbizotëruese në shoqëritë perëndimore.

Ai kujton aversionin e krijuar në rrethet akademike të majta për Thatcher-in pas shprehjes së saj të famshme “nuk ekziston një gjë e tillë që quhet shoqëri”. Gjithashtu, faktin se ‘Zonja e hekurt, ishte të paktën dikush për t’u urryer, megjithëse Scruton pranon se nuk e gëlltiti asnjëherë deri në fund retorikën e tregut të lirë të thatcher-istëve. Por mbështeste idenë se talenti dhe natyra sipërmarrëse e individit duhej çliruar. Natyrisht prej dekadash të tëra të predikimit të barazisë së pakumtimit, siç e quan ai.

‘Shoqëria inekzistente’ e Thatcher-it, ekziston për Scruton-in në një mënyrë tjetër, madje konservatorizmi mbështetet pikërisht te ideja e shoqërisë. Sipas tij ‘liria’ nuk është një përgjigje e qartë dhe e mjaftueshme për pyetjen: në çfarë besojnë konservatorët? “Si Matheë Arnold, unë mbroja bindjen se liria është një kalë i mirë për t’u ngarë por për t’u ngarë *diku*’, përgjigjet Scruton.

Ai shton se liria e vetme, pa përvojën apo traditën, është thjesht, metaforikisht, një kalë që sillet në fushë. Ai bën një vëzhgim me vlerë për qëllimet e drejtpërdrejta të studimit tonë kur flet për ‘natyrën e brishtë të demokracive të reja’, lexo Shqipëria.

...vura re se sa të parëndësishme janë zgjedhjet krahasuar me institucionet jetëgjata dhe shpirtin publik që i bën politikanët e zgjedhur përgjegjës. Pushteti në Europën Lindore, pas rënies së komunizmit, i perkiti një grupi aventurierësh që formuan një parti politike për të fituar zgjedhjet mbi premtime grandioze, të cilët më pas privatizuan aq sa mundën për vete para se të largoheshin nga pushteti në zgjedhjet e ardhshme (po aty: 10).

‘Parëndësia’ e zgjedhjeve në raport me nevojën e shpirtit publik, apo premtimet grandioze të politikanëve të demokracive të reja, nuk janë, sigurisht, synimi i studimit tonë, por gjithsesi ato mbeten të rëndësishme si background apo kontekst që sigurojnë një pamje apo kuadratim për të kuptuar prerjet retorike dhe pikat takuese ose shmangëse me diskurin e përgjithshëm demokratik, konservator, liberal, të majtë apo të djathtë, të objektit të studimit.

Në këtë plan është e rëndësishme të kujtojmë dy togfjalëshat më të zakonshëm, pothuajse stilemat e përdorura përgjatë viteve të para të hapjes: ‘zgjedhjeve të lira’ dhe ‘pluralizmit’. Scruton flet për një qeveri tjetër, të cilën ai e quan të përgjegjshme, por nuk sigurohet me anë zgjedhjesh të lira. Ajo, sipas tij, vjen përmes respektit të ligjit, përmes shpirtit publik dhe përmes një kulture rrëfimi.

Zgjedhjet, siç dihet janë një nga instrumentet, në mos kryesori i pranuar, i demokracisë që lejojnë apo funksionalizojnë qeverisjen. Ato legjitimojnë apo u japin të drejtën për të vendosur atyre që quhen ‘shumica’. Shumica që mund të krijohen edhe nga identitetet fetare kundrejt të cilave Scruton vendos sekularizmin apo ligjin sekular. Ky i fundit, siguron ai, në shoqëritë perëndimore do të jetë përherë i zgjedhuri i parë dhe garanti i fundit. Është ky ligj, vijon ideja, ‘parimi jonë kryesor i mbrojtjes ndaj asaj që Tocqueville dhe John Stuart Mill e denoncuan si tirania e shumicës’. Për Scrutonin ka

diçka më të rëndësishme se shumica dhe ky është saktësisht personi që nuk bie dakord me të.

Scruton bën dallim edhe mes nacionalizmit dhe idesë së kombit. Nacionalizmin e quan një ideologji të rrezikshme sepse zë hapësirën e lënë bosh nga religjioni dhe fut idenë kombëtare në vend të Zotit duke e gjetur aty shpëtimin, ngushëllimin dhe kompensimin e pasigurive të tjera. Kjo është ideja naziste e kombit, por kombi nuk shfaqet i tillë në jetën dhe zakonet e përditëshme të europianit. Për të, kombi ka kuptimin e identitetit historik dhe ‘të angazhimeve të vazhdueshme që i bashkon ata në trupin politik. Kjo është veta e parë shumë e marrëveshjes.’

Pyetja e vetme atëherë është “kush jemi ne?” Dhe në kushtet moderne, kombi është përgjigja e kësaj pyetjeje, një përgjigje pa të cilën ne jemi të gjithë në det të hapur.

Kombi ose atdheu i Scruton-it (lexo konservatorit) është sekular. Sepse të tilla janë historitë e tij, thekson ai. Ato mund të mos jenë të vërteta, pra mund të jenë mite, por janë ‘produkt i besnikërisë së përbashkët dhe jo prodhues të saj’.

Besnikëria nuk krijohet për shkak të historive që besohen; historitë besohen sepse besnikëria ka nevojë për to. Dhe historitë ndryshojnë për të përshtatur vetën e parë të ndryshueshme shumë të njerëzve. Ato janë, siç thotë Platoni, gënjeshtër fisnike: falsifikime literale që shprehin të vërtetën emocionale.

Këtë besnikëri Scruton e konsideron ‘trashëgimi kulturor’ dhe e sheh të rrezikuar nga një pjesë e akademisë dhe medias mbështetur nga qarqe të majta të cilat madje synojnë t’i kthejnë në politika qëndrime të tilla. Një ide të ngjashme me këtë mund ta gjejmë te një përplasje e kahershme në kulturën shqiptare, sinteza më e fortë e së cilës është libri *Mosmarrëveshja* e Kadaresë. Atë që shkrimtari shqiptar e konsideron si mohim të mitologjisë kombëtare, filozofi britanik e shenjon si ‘kulturë mospranimi’. Kësaj të fundit ia atribuon ai sulmet mbi shtetin komb dhe idenë kombëtare.

Konservatorizmi është një kulturë konfirmimi. Ai është për gjërat që ne vlerësojmë dhe për gjërat që ne duam t'i mbrojmë. Çdokush që e kupton se çfarë është në lojë në konfliktin global që po zhvillohet sot, - besoj unë - do të shohë se kombi është një nga gjërat që ne duhet të ruajmë (po aty:29).

Territori, aty ku ngulet atdheu, më shumë se lidhjet fetare dhe fisnore, janë çka na përkufizon, thotë Scruton. Gjithaq të rëndësishëm në ndërtimin tonë si individë dhe si bashkësi janë edhe historia e zakonet. Sipas Burke-s, kombi është një partneritet, jo vetëm në shkencë, art dhe moral por edhe “midis atyre që jetojnë, atyre që kanë vdekur dhe atyre që do të lindin”. Për Nisbet nga ana tjetër, një pjesë e madhe e thelbit të konservatorizmit modern është pikërisht nderimi i të vdekurve - *sepse të vdekurit janë të gjithë te traditat dhe doket.*

KAPITULLI V

VËSHTRIM EMPIRIK MBI GJUHËT E BERISHËS

5.1 Hyrje

Në këtë kapitull do të kryejmë një ‘pranëvendosje’ të dëshmive teorike dhe gjetjeve empirike pra, do të masim ‘hapat e objektit të studimit’, diskurin e Sali Berishës, në raport gjurmët teorike që kemi skicuar në kapitujt pararendës. Këtu do të identifikojmë diskurin e Berishës, kryesisht atë ideologjik-i djathtë/ i majtë- dhe si rri ai brenda ligjërimit të përgjithshëm të kohës, pra kontekstualitetit.

Pjesa e parë e këtij kapitulli, lënda e parë e analizës, do të jetë edhe debutimi i Sali Berishës, asokohe kardiolog i njohur, në shtypin, dhe më gjerë në shoqërinë shqiptare, si *njeri politik*. Bëhet fjalë për një artikull (Berisha 1990: 2,3) të gjatë në një prej periodikëve të kohës, i cili do të analizohet këtu në disa rrafshe të diskurit. (Ky nuk është në fakt debutimi *per se* i Berishës duke qenë se ‘kontakti’ i parë i tij me publikun mbetet një intervistë për gazetën Drita në maj 1990, por gjykojmë se artikulli në gazetën Bashkimi është më pranë qëllimeve të studimit të këtushëm).

Së pari, do të hulumtohen fjalë dhe shprehje të *gjuhës së re* dmth koncepte apo terma të panjohur për publikun e asokohe, fjalor i cili jo vetëm lajmëron një retorikë të re, por edhe një guxim intelektual. (Për këtë të fundit duhet të mbani mend kohën dhe kontekstin shoqëror të një Shqipërie që mbërrin në *stacionin e hapjes* pas 45 vitesh komunizëm stalinian).

Së dyti, do të kërkohen gjurmë të *gjuhës së vjetër* asaj që George Orëell e quante *neëspeak*, pra një diskur që edhe nëse nuk është totalitar, është socialist apo komunist në kufizimin e vet, është pjesë e zhagonit zyrtar, e një shqipeje që ngjan e drunjtë dhe

ndërton një retorikë statike dhe statiste. Me këtë qëllim do të shyrtohen, për efekte krahasimi apo kontrasti, shkrime të intelektualëve apo politikanëve të tjerë të kohës, për të shenjuar këtë gjuhë ‘të vjetër’ dhe për të kuptuar se ku gjuha ‘e re’ e Berishës, apo ‘e vjetra’ e tij, ngjajnë apo ndryshojnë me të.

Së treti, do të hetohet për shenja të *fjalorit teknik* që lidhet me profesionit e autorit, mjekësinë, atë që quhet *diskur shkencor*.

Së katërti, dhe e fundit, do të zhvendosemi te piketa që na çojnë te gjurmë të *retorikës ideologjike*. Në këtë rast, duke qenë se hulumtimi i këtushëm sillet rreth pyetjes ‘a është i djathtë komunikimi politik i Berishës?’ për këtë shenjë do të kërkojmë, pra për *të djathtat*.

Megjithëse kjo e fundit duket një premisë abuzive, (si mund të kërkojsh shenja të djathta në shtator 1990?) i shërben analizës sonë për të kuptuar se si është zhvendosur diskuri i Berishës-nga artikulli i parë në mesin e ‘90 te fjalimi i tij si President i Republikës, dy vjet më vonë në prill 1992.

Metoda e procedimit do të jetë pak a shumë si më poshtë: artikulli do të jepet i plotë dhe në trup të tij fjalët që do analizohen do të shenjohen në mënyra të ndryshme. Kështu, gjuha e re do të shënohet me **bold**; gjuha e vjetër (ose neëspeak-u komunist) me *kursive*; gjuha shkencore me underline; dhe *gjuha ideologjike* (e djathtë) me *lucida calligraphy*.

Në fund të artikullit do të ketë një fjalor, për secilën kategori, me të gjithë termat apo frazat, të cilat edhe do të shpjegohen, aty ku ka nevojë për një gjë të tillë. (Artikulli jepet i plotë në mënyrë që konteksti i fjalive të shpjegojë termat sa më saktë, dhe të shmangen mangësitë në interpretim).

5.2 Artikulli që paraqet Berishën si *political personae*

Demokracia dhe humanizmi-binom i pandarë

Demokratizimi i jetës tek ne po zhvillohet si një **imperativë historike e kohës** që jetojmë. Vendimet e plenumeve të fundit të KQ të Partisë dhe konkretizimi i tyre në një seri dekretesh të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe të Qeverisë *shënojnë hapa të rëndësishme në thellimin dhe zhvillimin e pandërprerë e të pakthyeshëm të këtij procesi vendimtar për ardhmërinë tonë, për ecjen dhe zhvillimin e shoqërisë sonë në rrugën e përparimit të gjithanshëm shoqëror, ekonomik dhe kulturor. Këto procese forcojnë akoma më shumë marrëdhëniet dhe lidhjet e popullit tonë me popujt e tjerë dhe i shërbejnë prestigjit dhe emrit të mirë të Shqipërisë, integritetit të saj gjithnjë më të madh në zhvillimet përparimtare evropiane dhe botërore.*

Por **proceset demokratike në vendin tonë janë njëkohësisht një ndihmë e çmuar për luftën e vëllezërve tanë në Kosovë.** Luftë kjo që për idealet njerëzore që mbron dhe pjesëmarrjen gjithë popullore, nga shtatë gjer në shtatëdhjetë sipas një parimi të hershëm dhe liridashës shqiptar për kohën që zgjat nga vite '70 – të të shekullit që shkoi e gjer sot, për numrin e të rënëve sa në asnjë vis tjetër të këtij kontinenti, për moshën e martirëve më të njomë se të çdo revolucioni tjetër demokratik e çlirimtar, për qëndresën, format, urtësinë dhe **frymën e tyre qytetare** do të mbetet e *pashembullt* në historinë e qytetërimit të sotëm. Kurse për platformën, ideologjinë, mjetet dhe përmasat e represionit, masakrës dhe shfarosjes që **pushtuesit serbomëdhenj** ushtrojnë kundër popullsisë shqiptare, ajo mbetet pa ekuivalencë në analet e barbarisë dhe shtypjes njerëzore. Gjithashtu, këto procese janë shumë të

mirëpritura, jo vetëm nga shqiptarët që banojnë në trojet e tyre, por edhe nga ata që janë ngulur në dhera të tjera, pra nga mbarë **diaspora shqiptare**.

I parë nga ky kënd, **demokratizimi** i jetës së vendit tek ne është proces *jetik* për **çështjen shqiptare** në tërësi, për forcimin e **unitetit moral dhe shpirtëror të kombit** tonë dhe arritjen e një **rezultanteje kombëtare të qëndrueshme**. Pikërisht këtu qëndron dhe dimensionin i madh atdhetar i këtyre zhvillimeve. Por po këtu e kanë zanafillën gjithashtu edhe *detyrat e mëdha* që shtrojnë dhe *hapësirat e reja* që ato *çelin para nesh*.

Sot, më shumë se ndonjëherë, koha që jetojmë kërkon nga ne, **intelektualët**, që të *mobilizojmë forcat*, mendjen, energjitë dhe të gjitha potencialin tonë *t'ua përkushtojmë luftës për zbatimin, thellimin dhe përsosjen e pandërprerë*, të proceseve demokratike në vendin tonë.

Intelktuali, thotë Rexhep Qosja, për *bibël* ka të vërtetën dhe për *zot* popullin, çka do të thotë se në luftën, përpjekjet dhe në të gjithë veprimtarinë e tij ai si armë të vetme ka të vërtetën. Me qëndrimin ndaj asaj është e lidhur forca e tij. Ai është kompetent, i pathyeshëm, kur është një me të vërtetën, sikundër do të jetë i mundur kur ajo qëndron në anën tjetër dhe mbetet i mjerë e pa shpresë kur e humbet atë. Qëndrimi ndaj saj, shpreh gjithashtu thelbin e moralit të intelektualit. Ai është, si të thuash, *linja e prerë e demarkacionit* ndërmjet tij dhe pseudointelektualit, i cili jo që nuk mbron interesat e shoqërisë, por përkundrazi është një mashtrues i rrezikshëm i saj.

Kështu që detyra e parë dhe e përhershme e çdo intelektualit është këmbëngulja në kërkimin, zbulimin, ekspozimin, afirmimin, riafirmimin, verifikimin dhe riverifikimin e të vërtetave, veçimin e tyre nga gjysmë të vërtetat, artefaktet dhe të pavërtetat. Kjo e tëra aspak për pozitivizëm, por, së pari, për formimin e ideve,

pikëpamjeve, koncepteve dhe *qëndrimeve të reja* dhe *shfrytëzimin* e tyre në hartimin mbi baza shkencore të politikave në të gjitha fushat; së dyti: për zbatimin e njohurive, metodave, teknikave e procedurave, eksperimentimeve të reja, për të ndjekur kështu zhvillimin bashkëkohor; së treti: për afirmimin dhe *fuqizimin* e asaj që është arritur dhe që përbën një *bazë të fuqishme* për ecjen dhe përparimin tonë. Por këtu duhet mbajtur parasysh se ndonëse eksperiencia të mëson shumë, fetishizimi i asaj mund të pengojë zhvillimin. Kështu shpesh praktika dhe veprime që dje kanë qenë të dobishme dhe efikase në kushtet e sotme mund të tregohen *anakronike* dhe dëmsjellëse.

Pra, intelektual, vetëm duke i qëndruar besnik dhe *konsekuent të vërtetës* mund të përmbushë *misionin e tij fisnik* në krijimin e vlerave shpirtërore, kulturore, artistike dhe shkencore të **kombit** të tij. Vetëm kështu ai mund të bëhet pararendës i të ardhmes, pra projektues i saj dhe do të mund të shkruajë qartë e pa njolla në librin e madh të *paraardhësve të tij të ndritur*, gjenia e të cilëve është derdhur dhe kristalizuar në të gjitha aktet e mëdha krijuese të historisë sonë. Vetëm në këtë mënyrë ai do të mund t'i shërbej me përkushtim dhe dinjitet *zotit të vet* dhe të madh *popull* dhe do të mund të japë ndihmesën e tij në këto procese që kërkojnë para së gjithash **ndryshimin e njerëzve dhe të realitetit në një raport proporcional** duke pasur parasysh këtu *tezën e Marksit se “historia nuk bën asgjë, njerëzit bëjnë gjithçka”*.

Mirëpo sot tek ne në rast se *masat e gjëra* dhe *shumica dërrmuese e punonjësve*, **demokratizimin** e shoqërisë sonë e konsiderojnë *proces vendimtar* siç është në të vërtetë për të sotmen dhe të ardhmen e vendit, mendim të kundër me këtë kanë **elementët antidemokratë** dhe **forcat konservatore**, të cilët në realitet nuk janë as të pakët në numër, por as dhe të pafuqishëm për nga pushteti që kanë. Këto forca nuk janë të përqendruara në një brezni të caktuar e aq më pak në **brezin që bëri luftën**. Ata

që në rininë e tyre rrokën armët për liri kombëtare dhe dinjitet njerëzor, si rregull nuk mund të kenë mendësi tjetër për liritë dhe të drejtat e individit.

Konservatorë dhe antidemokratë janë, në radhë të parë, ato *kuadro* dhe nëpunës të burokratizuar që i kanë lejuar dhe krijuar vetes *privilegje* të paligjshme. Dhe tani që ka ardhur koha të heqin dorë prej tyre, këta njëlloj si njeriu fatkeq, që, sajon dhe beson gënjeshtrenë e vet, mendojnë se i kanë të ligjshme, madje u duket sikur kanë lindur me to. Mirëpo në diagnozë sociale syri i mprehtë klinik i doktorit popull pothuaj nuk gabon.

Antidemokratë janë pa dyshim të gjithë fanatikët, *intolerantët* e ata që në vend të **pluralizmit të mendimit** parapëlqejnë **monizmin** (dhe mundësisht vetëm monizmin e tyre) uniformën e tij. Mirëpo **demokraci pa demokratë** nuk mund të ketë, kurse **uniforma e mendimit** mbart në vete pasoja të rënda sociale. Ajo vërtet uniformon mendimin, e paraqet atë njëlloj, por si çdo uniformë tjetër (në shëndetësi, ushtri etj.) fsheh në vetvete shumë më tepër se sa ç'tregon. “Sa koka, aq mendime”, thotë një fjalë e urtë latine për të shprehur kështu më së miri **karakterin e përvetshëm pluralist të mendimit njerëzor**. Salla, auditori, kuvendi apo shoqëria **moniste** janë thjesht iluzion.

Dogmatikët, gjithashtu, e kanë të vështirë të heqin dorë nga dogmat, praktikat e vjetruara dhe paragjykimet. Natyrisht para të tjerëve nuk mund të paraqiten si burra kuvendi, se i tillë nuk mund të jesh në rast se nuk respekton forcën e argumentit, **mendimin e tjetrit**, por dalin me slogane, etiketime dhe apostrofime. Mirëpo, dogmatikët dhe konservatorët s'duhet të injorojnë faktin se psikologjia e një populli në të cilin si grup moshë mbizotëruese absolute është ajo e rinisë, pra e një populli që jeton me rininë e tij si ky yni, nuk mund të pajtohet me dogma, paragjykime, mendime dhe praktika të vjetruara.

Proceset demokratike i tmerrojnë, gjithashtu, të gjithë **elementët** që nuk përfillin dhe nuk respektojnë ligjin si dhe ata që kriteret dhe normat e reja i konsiderojnë të vlefshme vetëm për të tjerët. Ndërkohë që respektimi me *rigorozitet* nga të gjithë i ligjeve, normave dhe rregullave të vendosura nga shumica, përbën alfën e demokracisë.

Konservatorë e antidemokratë janë dhe ata nëpunës dhe kuadro që veten e ndiejnë si zotër të demokracisë apo këtë të fundit e kuptojnë dhe e trajtojnë njëloj si ilaçon të cilin vetëm pikatoret e tyre e dozojnë në mënyrë ideale duke harruar kështu se **demokracia si pushtet i popullit i ka trojet në popull e buron nga shpirti i tij.**

Me një fjalë, pothuaj për të gjithë këta **demokratizimi** është jo dhimbje e madhe, por **agoni e vërtetë sociale**. Prandaj dhe me mjete, mënyra dhe mekanizma nga më të shumëllojtat dhe në **verbëri politike**, ata përpiqen të pengojnë, vështirësojnë, ngadalësojnë dhe madje të mohojnë zhvillimin e këtyre proceseve tek ne. Në këto rrethana diskutimet e hapta dhe *vjelja e mendimeve* dhe opinioneve të njerëzve marrin një rëndësi të veçantë. Sot tek ne për këtë qëllim përdoren forma të ndryshme duke filluar nga intervistat radiotelevizive të rrugës, që thonë aq sa thonë, gjer tek mbledhjet dhe letrat e shumta në të cilat nuk jemi aspak të kursyer.

Por në *stadin aktual* të zhvillimit kulturor dhe arsimor të shoqërisë sonë një vend të veçantë mendoj se duhet të zënë **studimet sociologjike dhe psikologjike**. Dhe kjo jo vetëm për faktin se në shkencë ekziston një rregull sipas të cilit ajo që është lënë në harresë, kërkon me të drejtë vendin e vet, por edhe për vetë rolin e madh që këto shkenca të lidhura drejtpërdrejt me shoqërinë dhe njeriun mund të luajnë në proceset e demokratizimit të jetës së vendit.

Studimet social-psikologjike të bazuara në teknikat sasiore e cilësore të analizës së mendimeve dhe opinioneve, realizuar këto në mostra që në bazë të kritereve

rigorozisht shkencore përfaqësojnë shtresat dhe grupmoshat e shoqërisë, kanë vlera të pazëvendësueshme. Ato lejojnë njohjen reale të mendimeve, opinioneve, vlerësimeve, shqetësimeve, synimeve dhe motiveve të njerëzve për problemin e dhënë. Këto studime japin njohuri të sakta për përmasat dhe prirjet e dukurisë së studiuar, lejojnë analizën në thellësi të arsyeve që i shtyjnë njerëzit, **individët** apo grupet të formojnë opinionin, qëndrimin apo sjelljen e caktuar. Kështu nëpërmjet tyre mund të zbulohen mekanizmat sociale dhe psikologjike që qëndrojnë në bazë të kësaj apo asaj sjelljeje, të këtij apo atij opinionit apo qëndrimi.

Vjelja dhe studimi i mendimit me këto metoda do të tregojë realisht se çfarë parapëlqehet dhe çfarë nuk pëlqehet apo nuk u intereson më njerëzve dhe shoqërisë sonë. Ajo do të mundësojë hartimin e një **politike sociologjike** më të saktë. Duke krahasuar dy, anketa njëra me emër dhe tjetra anonime, lidhur me përhapjen e vesit të duhanit në shkollat mesme të Tiranës, kemi konstatuar se anketa anonime zbuloi prevalencë 3 herë më të lartë të këtij vesi se sa anketa me emër. Anketa anonime, krijon mundësi për shprehjen e lirë të mendimit, opinionit, lejon shmangien e efekteve të njohura të **autocensurës** dhe bën kështu të mundur analizën shkencore të qëndrimeve dhe motiveve e synimeve të shoqërisë. Ajo përfaqëson një lloj **mikroreferendumi** për problemet që studion. Raporti i saj me anketën me emër është pothuaj identik me raportin që ekziston ndërmjet **votimit të fshehtë** dhe **votimit të hapur**. Kështu që vlera e këtyre studimeve vetëkuptohet, nuk mund të zëvendësohet nga **mbledhjet, letrat e forma të tjera**.

Nga një analizë e mbledhjeve tona nuk është e vështirë të konstatohen se me gjithë ndryshimet që kanë pësuar, ato vuajnë akoma nga sëmundja e konformizmit, i cili është edhe mekanizmi kryesor i inflacionit të tyre. Ai sot në të shumtën e rasteve vjen

nga frika e cenimit të interesave të ngushta vetjake, akrobllëqet e servilizmit. Mirëpo konformizmi është një ndër rreziqet e mëdha të personalitetit të njeriut. Lidhur me këtë Albert Ajnshtajn paralajmëron se rreziku i shkatërrimit të personalitetit nga ky faktor është “më i madh sesa rreziku atomik dhe ai i urisë”. Nga ana tjetër s’duhet harruar se mbledhjet edhe mund të **manipulohen**. Shqetësimet dhe çështjet e drejta të shprehura në një ose disa prej tyre jo rrallë ndodh që në rrugë e sipër bien viktimë e *lapsit të “mprehtë” të aparatçikëve*.

Shoku Ramiz Alia në fjalimin e tij që mbajti në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë thekson se: “Traditat e kuvendeve, e diskutimit fshatçe, e odave ku përfshihen jo vetëm pleqtë e burrat, por edhe gratë dhe të rinjtë është rrugë e sprovuar shumë popullore dhe demokratike”. Këtu fjala është për evokimin e një tradite të çmuar, *thellësisht demokratike*, me të cilën *shqiptari në shekuj* e mbajti dhe e ruajti mendimin e tij të lirë e të pavarur. E dogjën, e vranë, e prenë dhe e shkretuan gjatë historisë së tij të përpjekjeve, betejave dhe durimeve të mëdha, por mendimin kurrë nuk ia prishën. Të kujton e gjithë kjo fjalët e Sokratit që thoshte se “Anili dhe Meliti edhe mund të më vrasin, por kurrë nuk do të dinë të më dëmtojnë”.

Vërtet *odat e burrave* në dallim nga **mbledhjet tona** nuk kishin **presidiume imponuese**, nuk kishin shefa, drejtorë, sekretarë apo kryetarë, po s’duhet harruar se edhe ato kishin përbërje **heterogjene** dhe se edhe ato kishin pothuaj gjithnjë dinjitarë e ofiqarë të kohës së vet. E megjithatë **mendimi në to shprehej lirisht** dhe me një **kulturë të lartë komunikimi**. Pra **liria e mendimit dhe e shprehjes** së tij ishte *ligja e lashtë* e parë dhe e pandryshueshme e tyre. Pikërisht ky faktor u bëri të mundur atyre që, siç thonë studiuesit tanë, të luajnë “rolin e salloneve në vendet e tjera në mbarë Evropën

ku ndizej shkëndija e cila në kohë shndërrohej në flakë të revolucionit të shumta kombëtare dhe shoqërore”.

Mirëpo vetvetiu mund të shtrohet pyetja: kush ishte garanti i këtij **pluralizmi** të përkryer në këto oda? Në aparençë i zoti i shtëpisë dhe askush tjetër. Por kjo vetëm në aparençë. Sepse në realitet *garant i vërtet dhe i gjithëfuqishëm s'mund të ishte një njeri, cilido dhe sado i fortë që të ishte ai. I tillë ishte diçka tjetër që u përkonte të gjithëve dhe e mbrojnë të gjithë*. Ky ishte *kanuni, një, nga sistemet më të lashtë, më të prerë e më madhore juridike* që njihet gjer sot, që aq madhërishtëm shpallte shtëpinë e shqiptarit, shtëpi të mikut dhe të zotit dhe burrat shqiptarë si të **barabartë para ligjit** të tij të sertë. Ai, me gjithë mangësitë e tij të njohura, të lidhura me rrethanat e kohës, me nenet e tij **nuk ia mbylli gojën dhe s'ia topiti kurrë mendjen burrit shqiptar**, përkundrazi, ia zgjidhi gjuhën dhe ia mprehu mendjen.

Në asnjërin prej këtyre neneve mendimin e shprehur lirisht në odën e burrave apo në kuvend ai **nuk e konsideron krim social**, por nder, detyrë dhe **dinjitet njerëzor**. Duke iu siguruar kështu odave dhe kuvendeve tona një **pluralizëm** të tillë i cili jo që nuk pengoi, por ndihmoi në **marrjen e vendimeve të ekuilibruara politike** dhe në **hartimin e një strategjie e taktike të drejtë të lëvizjes kombëtare** që e shpëtoi *kombin* tonë pa rënë në Vrimat e zeza të historisë, *fat të kobshëm* që pësuan jo pak popuj të tjerë.

Gjithashtu, po t'i referohemi historisë, del e qartë edhe është e pamohueshme se **kuvendet e mëdha kombëtare** në të cilat janë marrë vendime historike për fatet e vendit dhe kombit kanë qenë **pluraliste edhe në rrafshin politik**. Po të këtilla kanë qenë edhe *kuvendet lokale të besëlidhjes* gjatë luftës në të cilat populli jepte besën për të luftuar pa kompromis *pushtetuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre*. Por edhe sot në këtë

traditë kuvendet popullore ne Kosovë me një *forcë morale* të paparë kthyen vesin në virtyt, fermerët shkatërrimtar të vëllavrasjes, të krimit dhe të dasisë e sublimuan në urtësinë, forcën dhe energjinë e faljes, *vëllazërimit e unitetit kombëtar* duke dëshmuar qartë se shqiptarët janë popull i pajtimit.

Pikërisht në **pluralizëm** populli ynë krijoi dhe zhvilloi *filozofinë dhe kulturën e tij kombëtare*, me një fjalë Shqipërinë që përbën mesazhin e tij universal, thelbin e shpirtit të çdo shqiptari, dhe *armën me të cilën ai u mbijetoi terreve të zgjatura që historia s'ia kurseu*. Prandaj shoku Ramiz Alia në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë thekson se në rast se shtrohen probleme politike, ekonomike, kulturore, rrahja e mendimeve dhe trajtimi **pluralist** i rrugëve për zbatimin e tyre është i natyrshëm.

Një *mbështetje e fuqishme* e proceseve të demokratizimit tek ne është pa dyshim edhe *shkalla e lartë* e humanizmit që ka populli ynë, popull që gjenitë e tij i ka kryesisht në këto fusha. **Demokracia** dhe **humanizmi** janë një *binom i pandarë* që nuk kanë lindur në trakte apo universitete, por për *djep* dhe *trua*ll kanë pasur ndjenjat dhe shpirtin e madh të njeriut. Duke konsideruar **njeriun si qenie supreme, humanizmi** sot, para së gjithash, nënkupton respektimin e të gjitha **të drejtave të tij**.

Në këtë shkrim preka këto probleme shkurtimisht jo për nostalgjinë time karrieriste, as dhe i shtyrë nga pasione etno-psikologjike, por vetëm për të shprehur besimin tim si *qytetar* se e sotmja dhe e ardhmja jonë kanë një trashëgim të çmuar demokratik, se në të vërtetë **popullit tonë edhe në rast se i ka munguar ndonjë strukturë legjislative e demokracisë, nuk i ka munguar ndonjëherë shpirti i saj**. Përkundrazi, ai ka qenë i garantuar me njërin prej kodeve më madhështorë e më të rreptë të së **drejtës njerëzore** dhe ka qëndruar e do të qëndrojë gjithnjë në themel të

idealit tonë demokratik kombëtar. Dhe kjo, padyshim, përbën për ne një mundësi, *thesar të çmuar* në zhvillimin dhe përsosjen e mëtejshme të demokracisë sonë.

5.3 Fjalorët e Berishës intelektual

Tabela 1: Gjuha e re
Demokratizimi
imperativë historike e kohës
marrëdhëniet dhe lidhjet e popullit tonë me popujt e tjerë
integritit
zhvillimet evropiane
proceset demokratike në vendin tonë janë njëkohësisht një ndihmë e çmuar për
luftën e vëllezërve tanë në Kosovë
frymën e tyre qytetare
diaspora shqiptare
demokratizimi
çështjen shqiptare
e unitetit moral dhe shpirtëror të kombit
rezultanteje kombëtare të qëndrueshme
<i>ne</i> , intelektualët
kombit
ndryshimin e njerëzve dhe të realitetit në një raport proporcional
demokratizimin

elementët antidemokratë
brezin që bëri luftën
pluralizmit të mendimit
monizmin
demokraci pa demokratë
uniforma e mendimit
karakterin e përjetshëm pluralist të mendimit njerëzor
moniste
Dogmatikët
mendimin e tjetrit
Proceset demokratike
demokracia si pushtet i popullit i ka trojet në popull e buron nga shpirti i tij
demokratizimi
agoni e vërtetë sociale
verbëri politike
studimet sociologjike dhe psikologjike
politike sociologjike
autocensurës
mikroreferendumi
votimit të fshehtë
votimit të hapur
mbledhjet, letrat e forma të tjera
manipulohen

mbledhjet tona
presidume imponuese
heterogjene
mendimi në to shprehej lirisht
liria e mendimit dhe e shprehjes
individët
pluralizmi
të barabartë para ligjit
nuk ia mbylli gojën dhe s'ia topiti kurrë mendjen burrit shqiptar
Në asnjërin prej këtyre neneve mendimin e shprehur lirisht
nuk e konsideron krim social
dinjitet njerëzor
pluralizëm
marrjen e vendimeve të ekuilibruara politike
hartimin e një strategjie e taktike të drejtë të lëvizjes kombëtare
kuvendet e mëdha kombëtare
pluraliste edhe në rrafshin politik
Pluralist
pluralizëm
Demokracia
humanizmi
njeriun si qenie supreme, humanizmi
të drejtave të tij

popullit tonë edhe në rast se i ka munguar ndonjë strukturë legislative e demokracisë, nuk i ka munguar ndonjëherë shpirti i saj
drejtës njerëzore
demokratizimit
kulturë të lartë komunikimi

Tabela 2: Gjuha e vjetër
shënojnë hapa të rëndësishme në thellimin
zhvillimin e pandërprerë e të pakthyeshëm
vendimtar për ardhmërinë tonë
ecjen dhe zhvillimin e shoqërisë sonë në rrugën e përparimit të gjithanshëm
forcojnë akoma më shumë
gjithnjë më të madh
pushtuesit serbomëdhenj
e pashembullt
jetik
detyrat e mëdha
hapësirat e reja
çelin para nesh
mobilizojmë forcat
t'ua përkushtojmë luftës për zbatimin, thellimin dhe përsosjen e pandërprerë
bibël

zot
linja e prerë e demarkacionit
qëndrimeve të reja
shfrytëzimin
fuqizimin
bazë të fuqishme
anakronike
Konsekuent
misionin e tij fisnik
paraardhësve të tij të ndritur
zotit
popull
tezën e Marksit se “historia nuk bën asgjë, njerëzit bëjnë gjithçka”
masat e gjëra
shumica dërrmuese e punonjësve
proces vendimtar
forcat konservatore
elementët
kuadro
privilegje
intolerantët
rigorozitet
vjelja e mendimeve

stadin aktual
lapsit të “mprehtë” të aparatçikëve
thellësisht demokratike
shqiptari në shekuj
E dogjën, e vranë, e prenë dhe e shkretuan gjatë historisë së tij të përpjekjeve, betejave dhe durimeve të mëdha
vetvetiu mund të shtrohet pyetja
fat të kobshëm
pushtetuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre
armën me të cilën ai u mbijetoi terreve të zgjatura që historia s’ia kurseu
mbështetje e fuqishme
shkalla e lartë
binom i pandarë
thesar të çmuar

Tabela 3: Gjuhë shkencore

të vërtetën	të vërtetën
kërkimin	Zbulimin
ekspozimin	afirmimin
riafirmimin	verifikimin
riverifikimin	e të vërtetave
gjysmë të vërtetat	artefaktet

të pavërtetat	pozitivizëm
metodave	teknikave
eksperimentimeve	të vërtetës
Studimet social-psikologjike të bazuara në teknikat sasiore e cilësore të analizës së mendimeve dhe opinioneve	mostra
kritereve rigorozisht shkencore	analizën në thellësi
mekanizmat sociale dhe psikologjike	analizën shkencore

Tabela 4: Gjuha ideologjike

odat e burrave
ligja e lashtë
garant i vërtet dhe i gjithëfuqishëm s'mund të ishte një njeri
u përkiste të gjithëve dhe e mbronin të gjithë.
kanuni, një, nga sistemet më të lashtë, më të prerë e më madhorë juridike
shpallte shtëpinë e shqiptarit, shtëpi të mikut dhe të zotit
kombin
edhe kuvendet lokale të besëlidhjes
traditë
forcë morale
vëllazërimit e unitetit kombëtar
filozofinë dhe kulturën e tij kombëtare
djep

truall
qytetar

5.4 Vështrim krahasues: diskuri i një ‘disidenti’ dhe një Presidenti

Nga artikulli i parë (disident) i Sali Berishës në shtator 1990, deri në fjalimin e zgjedhjes si President i Republikës, në prill 1992, kanë kaluar diçka më pak se dy vjet. Pas analizës diskursive të artikullit të parë, aty ku mjeku Berisha u vetëshpall, në njëfarë mënyre, *njeri politik* (political personae), do të analizojmë, me të njëjta mjete hulumtimi, fjalimin e parë (Berisha 1992: 1,2) si President i zgjedhur i Shqipërisë, i pari pas rënies së komunizmit. Sërish do të jemi në kërkim të gjuhës së re, gjuhë së vjetër, gjuhës ideologjike dhe asaj shkencore. Pasqyra diskursive që do dalë prej këtej do të na mundësojë, përveç një fjalori për secilën, edhe një krahasim: sa janë tkurrur apo fryrë ‘katër gjuhët’ e folura prej Berishës në artikullin e gazetës Bashkimi të thuajse dy viteve të shkuara. Analiza e diskurit do të na lejojë, jo vetëm për të përcaktuar, në sasi dhe cilësi, temat apo gjuhët por edhe për të kuptuar trajektoren e ‘njeriut politik’ që u shfaq, në një formë a tjetër, në artikullin prezantues.

Edhe këtu do të jemi në kërkim të ‘katër gjuhëve’, dhe po ashtu me secilën prej tyre do të hartojmë një fjalorth i cili do na lejojë një analizë krahasuese. Krahasim që do të na e mundësojnë edhe mungesat, nëse ato shfaqen

Klerikë të nderuar,

Të dashur zonja deputete,

Të dashur zotërinj deputetë,

Të nderuar zotërinj ambasadorë,

Të dashur të ftuar,

Të dashur qytetarë të Shqipërisë, bashkëkombas kudo që jeni;

Detyra e Presidentit të Republikës që populli shqiptar më beson sot mua, nëpërmjet përfaqësuesve të tij në Parlamentin e parë demokratik të Shqipërisë, është një nder i madh dhe një detyrë, sa me përgjegjësi aq dhe dinjitoze. Ajo është nder, se populli ynë *pas afër një shekulli lufte dhe përpjekjesh titanike* për liri, demokraci, të drejta njerëzore dhe kombëtare, më vendos sot mua nëpërmjet jush, me **vullnetin e tij të lirë**, në vendin e parë të shtetit demokratik Shqiptar. Por, detyra e Presidentit në *agimin e demokracisë* së Shqipërisë padyshim është tejet e vështirë. Kjo, sepse, unë zgjidhem sot President i njërit prej vendeve më të varfër të globit, ku në të kaluarën e afërt qindra pleq apo fëmijë vdiqën nga uria apo sëmundjet e lidhura me të, dhe sot akoma nuk janë të paktë ata që vuajnë nga kjo plagë. Ku janë të panumërt fëmijët që të zhveshur dhe të zbathur, të uritur nisen për në shkollë, ku qindra e mijëra të sëmurë nuk kanë ilaçe për t'u mjekuar. Papunësia është në nivele nga më të lartat që mund të jetë, ku qindra e mijëra familje në fshat nuk kanë një pëllëmbë tokë, as dhe mjete të tjera jetese. Industria është e një teknologjie jashtëkohore. 80 përqindëshi bren çdo ditë ekonominë shqiptare të paralizuar. Peizazhi natyror i vendit me bukuri mahnitëse e trishtojnë drurët e prerë dhe bunkerët. Këta të fundit simbol autentik i diktaturës së egër dhe gjysmëshekullore që përjetuam. E vërteta është se në Shqipëri koha ndaloi, dhe jo për një javë e vite, por për një gjysmë shekulli dhe kjo ka peshë dhe çmim të rëndë. Ligji nuk u respektua ndonjëherë, madje kohët e fundit, ai i lëshoi vendin kaosit, krimit të organizuar dhe anarkisë.

Zonja dhe zotërinj,

Gjatë gjysmë shekulli në Shqipëri, për mungesë së **lirisë së ndërgjegjes** dhe në bazë të **parimit amoral të luftës së klasave** qindra dhe mijëra shqiptarë *dhanë jetën dhe rininë* e tyre, fjalën e lirë për mendimin e lirë.

Ndërsa të tjerëve që nuk u burgosën apo internuan, **komunizmi u ndaloi liritë themelore të individit, mendimin, pronën dhe zotin**. Ai *zhyti vendin* në një ngujim dhe izolim që rëndoi shumë mbi shpirtin, psikologjinë, kulturën, ekonominë tonë.

Zonja dhe zotërinj,

Unë bëra këtë përshkrim, jo vetëm për të dënuar diktaturën të cilën përjetuam, por edhe për të rikujtuar këtu se në këto rrethana, askërkush nga ata që kanë luftuar për liri dhe demokraci, nuk besoj se do të lakmonte qoftë dhe një miligram pushteti, megjithatë unë e pranoj më kënaqësi dhe optimizëm detyrën e Presidentit të Republikës. Së pari sepse unë jam krenar se jam shqiptar. *Nënat tona së bashku me qumështin na mëkuan me krenarinë dhe dashurinë për kombin, kulturën, flamurin dhe historinë e tij të dhimbshme.*

Plagët e rënda që unë përmenda më sipër dhe që janë një trashëgimi tepër e hidhur, Shqipërisë nuk ia shkaktoi zoti, por komunizmi, të cilën në një festë, madhështore e demokratike, e varrosëm njëherë e përgjithmonë, ditën ditën e parë të kësaj pranvere të madhe.

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Shqipërisë,

Bashkëkombas të dashur,

Postin e Presidentit unë e pranoj, sepse kam besim të madh tek ju, kam *besim të pakufishëm* tek njeriu, *gjenia e tij krijuese*, aftësitë, talenti, mundësitë, idealet dhe *aspiratat* e tij.

Unë besoj dhe shpresoj se ata që mundën diktaturën e egër, ata do të dinë të ndërtojnë demokracinë, të ndërtojnë një Shqipëri demokratike, me një *ekonomi tregu* të zhvilluar, një vend të lirë *të qytetarëve të lirë*. Mendimi i lirë, *puna e lirë, inicitativa e lirë* do të punojnë për ne siç kanë punuar për të gjitha kombet e qytetëruar. Nga ana ime në këtë rast do t'ju garantoj se *do të angazhohem me të gjitha forcat* për stabilizimin e rendit dhe qetësisë, funksionimin e shtetit juridik, rifillimin e prodhimit në ndërmarrjet tona dhe rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare.

Klerikë të nderuar,

Detyrën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, unë e pranoj sepse kam *besim të madh tek zoti*. Ai na ka ndihmuar dhe do të na ndihmojë, në rrugën e gjatë dhe të vështirë drejt demokracisë.

Shqipëria sot ka tre fe.

Ato do të nderohen dhe do të vlerësohen gjithnjë si **tribuna të fuqishme hyjnore** që do të **pasurojnë shpirtin tonë, shqiptarinë**.

Zotërinj ambasadorë, dhe diplomatë të akredituar në Shqipëri,

Duke marrë detyrën e presidentit dua edhe një herë t'u konfirmoj, besimin tim të pa lëkundur, se vendet demokratike fqinje, Demokracitë e Europës, SHBA do të na ndihmojë në rrugën e demokracisë dhe përparimit.

Dua me këtë rast t'ju siguroj se ëndrra më e madhe e çdo shqiptari është **integrimi i Shqipërisë në Europë**.

Për këtë ne do të ndërtojmë **shtetin e të drejtës**, do të realizojmë **lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave dhe ideve**.

Me politikën e saj Shqipëria do të përpiqet që interesat e ndryshme të mos sjellin konflikte, por të zgjidhen me mirëkuptim dhe marrëveshje, mbi bazë të normave dhe *traditave* demokratike.

Në të ardhmen do të bëj përpjekje që sa më shumë qytetarë të huaj, biznesmenë dhe firma kryetarësh shteti të vizitojnë Shqipërinë, që Shqipëria të ndërrohet në një faktor paqe, mirëkuptimi në rajon dhe Europë.

Ndërmarrjet e përbashkëta ekonomike dhe investimet e huaja do të garantohen me një *legjislacion liberal* dhe demokratik.

Bashkombasit tanë në trojet e veta në Jugosllavi dhe kudo që janë, dua t'i garantoj se shteti shqiptar do të punojë me këmbëngulje për realizimin e **të drejtave të tyre njerëzore dhe kombëtare**. Unë kam besim të palëkundur se **çështja Shqiptare** është çështje e drejtë që mund të zgjidhet plotësisht në kuadrin e Aktit Final të Helsinkit dhe nismës së Komunitetit European për rajonin.

Shpreh bindjen se **nuk do të jetë e largët dita që shqiptarëve do t'u njihet e drejta për vetëvendosje dhe të drejta të tjera që u takojnë**. Nga ana tjetër dëshiroj të **siguroj minoritetin** në Shqipëri se do të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë individuale dhe kombëtare që u garanton kushtetuta jonë dhe aktet ndërkombëtare.

Do të përpiqem dhe shpresoj se edhe vendet e tjera do të mbajnë të njëjtin qëndrim ndaj pakicave tona.

Zonja dhe zotërinj,

Detyrën e Presidentit të Republikës e pranoj i vendosur që të realizoj me ju, **aktin e madh të pajtimit kombëtar**.

Komunizmi ishte përçarësi më i madh i kombit tonë. Pak ditë më parë ne varrosëm pushtetin e tij por jo doket dhe zakonet e tij.

Ato do t'i varrosim vetëm pasi t'i zëvendësojmë me *virtytet e larta* që ne trashëgojmë. Duke dënuar krimin e shëmtuar dhe diktaturën ne duhet të nderojmë, të duam dhe të çmojmë njëri- tjetrin.

Të gjithë ne kemi qenë bashkëpërgjegjës në shkallë të ndryshme për vazhdimësinë e diktaturës, së paku për votën në frikë 99,99 për qind që i akorduam asaj. Por **të gjithë kemi qenë bashkëviktima** të tij. T'na bashkojë vuajtja, dhimbja e njëri –tjetrit, përgjegjësia e përbashkët për të ndërtuar një shoqëri të civilizuar si Spanja dhe Portugalia.

Kombet me kulturë kanë shpirt të madh, dinë të falin, dinë të shprehin pendesën. Për hir të kulturës, së shpirtit, të fëmijëve dhe të ardhmes së tyre.

Zonja dhe zotërinj,

Në detyrën e vështirë të presidentit duhet t'ju garantoj se do të mbaj fort parasysh interesat e të gjithë shtetasve shqiptarë, të të gjithë qytetarëve shqiptarë, duke filluar që nga vogëlushët që na përcjellin çdo ditë me gishtërinjtë e tyre lart, mesazhi i shpresës së një kombi, te rinia që solli këtë ditë për vendin tonë, te burrat dhe gratë, të moshuarit dhe pleqtë, që nuk kursyen asgjë, fëmijët e tyre, as veten e tyre kur ishte fjala për liri dhe të drejtat kombëtare e njerëzore.

Një kujdes të veçantë do të tregoj për të gjithë ata që vuajtën. Vuajtjet dhe sakrificat e tyre janë çmimi njerëzor i lirisë që gëzojmë ne sot.

Zonja dhe zotërinj,

Në funksionin e komandantit të përgjithshëm do të punoj për transformimin e ushtrisë, të forcave të ruajtjes së Rendit dhe ShIK-ut në institucionet që garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e demokracisë.

Do të përpiqem që **Shqipëria të anëtarësohet në NATO**, si pjesë e programit të **integritetit të saj në Evropën e qytetëruar**.

Së fundi, dua t'ju njoftoj se si President i parë i zgjedhur nga ky Parlament do të ruaj përmasat e mia qytetare.

Shqipëria ka vërtet një **Pallat Presidential**, por si njëri prej vendeve më të varfra në botë, ajo nuk mund të ketë **president për pallat**. Do rri *mes jush se ndjehem më i fortë* se vetëm ashtu do mund të ruaj dimensionin njerëzor, si dimensionin themelor të politikës së re shqiptare.

Rroftë Shqipëria.

5.5 Fjalorët e Berishës politikan

Tabela 5: Gjuha e re	
Klerikë të nderuar	
vullnetin e tij të lirë	
Zonja dhe zotërinj	
lirisë së ndërgjegjes	
parimit amoral të luftës së klasave	
komunizmi u ndaloi liritë themelore të individit, mendimin, pronën	
zotin	
tribuna të fuqishme hyjnore	

pasurojnë shpirtin
Shqiptarinë
Zotërinj ambasadorë
integrimi i Shqipërisë në Europë
shtetin e të drejtës
lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave dhe ideve
Ndërmarrjet e përbashkëta ekonomike
investimet e huaja
Bashkombasit tanë në trojet e veta në Jugosllavi
të drejtave të tyre njerëzore dhe kombëtare
çështja Shqiptare
nuk do të jetë e largët dita që shqiptarëve do t'u njihet e drejta për vetëvendosje dhe të drejta të tjera që u takojnë
siguroj minoritetin
aktin e madh të pajtimit kombëtar
Komunizmi ishte përçarësi më i madh i kombit tonë. Pak ditë më parë ne varrosëm pushtetin e tij por jo doket dhe zakonet e tij
Të gjithë ne kemi qenë bashkëpërgjegjës në shkallë të ndryshme për vazhdimësinë e diktaturës
të gjithë kemi qenë bashkëviktima
Shqipëria të anëtarësohet në NATO
integritit të saj në Evropën e qytetëruar
Pallat Presidencial

njëri prej vendeve më të varfra në botë

president për pallat

Tabela 6: Gjuha e vjetër

pas afër një shekulli lufte dhe përpjekjesh titanike

në agimin e demokracisë

dhanë jetën dhe rininë e tyre

zhyti vendin

Nënat tona së bashku me qumështin na mëkuan me krenarinë dhe dashurinë për kombin, kulturën, flamurin dhe historinë e tij të dhimbshme

Plagët e rënda

zoti

besim të pakufishëm

gjenia e tij krijuese

aspiratat

virtytet e larta

mes jush se ndjehem më i fortë

do të angazhohem me të gjitha forcat

Tabela 7: Gjuha ideologjike

ekonomi tregu

të qytetarëve të lirë
puna e lirë,
iniciativa e lirë
besim të madh tek zoti
traditave
legjislacion liberal

5.6 Analizë sasiore: sa ‘i ri’, sa ‘i vjetër’, sa ‘ideologjik’ dhe sa ‘shkencor’ është

Berisha?

Gjetjet dhe përpjekjet më të shumta të këtij punimi kanë rrahur në drejtim të një analize cilësore e cila, pasi na njeh me kontekstin, mundohet të zbërthejë, në terma të cilësisë, edhe tekstin. Në këtë syth do të ndalemi te një krahasim i llojit sasior duke bërë një enumeracion të katër tipeve të gjuhës, për të kuptuar se cila peshon më shumë në diskurin e Berishës.

Këtu, numerikisht, fjalët apo termat e përdorur nga Sali Berisha do të klasifikohen në katër grupe të veçanta për të kuptuar fillimisht se cila prej gjuhëve rëndon më shumë në komunikimin politik të intelektualit shqiptar të fillimviteve '90 të shekullit të shkuar.

Në total teksti i shkruar nga Berisha përmban 2838 fjalë. Prej këtij totali 166 fjalë janë evidentuar dhe klasifikuar si terma që përkojnë me një prej katër kategorive të gjuhës të specifikuar për qëllimet e këtij punimi. Disa prej tyre nuk janë fjalë unike, pra nuk janë njësi më vete, por pjesë të fjalisë: këto janë evidencuar (më lart) si (1) një njësi, për llogari të një matjeje apo krahasimi shkencor. Në të njëjtën kohë edhe përsëritjet, pra përdorimi i një termi më shumë se njëherë është përlogaritur si pjesë e fjalorit. Kjo,

sepse edhe përsëritja e një termi flet, jo vetëm për bindje të folësit, por edhe për atë se me anë të termit vetë dhe të përsëritjes së tij ai ka dashur të arrijë një qëllim retorik apo politik.

a-Gjuha e re

Fjalët apo termat e klasifikuara si gjuhë e re në një tekst prej 2838 fjalësh, ku vetëm 166 janë mënjeluar si qëllim studimi, janë 66. Ato janë, kryesisht, terma që në kushte të tjera nuk mund të klasifikoheshin si më shumë se fjalë të zhargonit politik në një demokraci normale, por këtu na duhet të mbajmë parasysh kontekstin: një Shqipëri ende nën komunizëm. Fjalë të tilla janë *demokratizim, integrim, zhvillimet europiane, frymë qytetare, pluralizëm të mendimit* etj. Veç tyre do të gjeni fjalë që janë më shumë se zhargon dhe fusin në komunikimin politik koncepte të reja duke u bërë pararendëse, në njëfarë mënyre, të një ere që pritet të mbërrijë në diskurin e përgjithshëm politik e social të Shqipërisë. Të tilla mund të veçojmë: *diaspora shqiptare, ne intelektualët, demokracia pa demokraci, e të tjera.*

b-Gjuha e vjetër

Fjalët e koleksionuara në këtë seksion nga teksti i analizuar këtu janë kryesisht të idiomës komuniste të kohës. Burimi i tyre janë, sa dokumentet zyrtare, sa zhargoni i nomenklaturës, aq edhe ligjërimi i elitave kulturore të cilat, për 45 vjet, ushtruan ndikimin e tyre nëpërmjet asaj që u quajt 'letërsia apo arti socrealist'. 50 fjalë i përkasin kësaj idiome, 16 më pak se sa 'gjuha e re' e identifikuar më lart.

c-Gjuhë shkencore

Identifikimi i shkencës në diskurin e Sali Berishës, arsimimi dhe profesioni i të cilit në kohën kur është paraqitur ky artikull, ishte mjekësia, synon një raport të kësaj idiome në raport me politiken. Të këtij konfigurimi janë 25 fjalë apo terma dhe, në sasinë e cilësinë e tyre, dëshmojnë për një anim shkencor të intelektualit që do të bëhej së shpejti njeri politik, dhe një nga më të rëndësishmit e politikës shqiptare të tranzicionit.

d-Gjuha ideologjike/politike

Fjalët, interpretimi i të cilave mund të konfigurojë një tabelë gjuhësore apo komunikative, që këtu e emërtojmë ideologjike/politike, janë më të paktat, e njëkohësisht më ilustrueset. Për të mos e lënë shkencën të zhvlerësojë kontekstin, në këtu, më shumë se në gjuhët e tjera na duhet ta marrim parasysh atë. Termat politikë të përdorur nga Berisha janë 15 dhe, më shumë se ideologji si e tillë, janë ravgime antropologjike. Këtu ai i referohet Kanunit, një kodi ligjor të maleve shqiptare, odës së burrave, besëlidhjes, Zotit etj. Pra, i kthehet traditës. Si e tillë, si kthim te tradita mund të emërtohet kjo idiomë politike e Berishës.

e-Përfundime

Retorika është përdorimi i simbolizmit dhe gjuhës për t'u siguruar se një mesazh është koduar në mënyrën e dëshiruar nga komunikuesi. Komunikimi retorik është qëllimisht joshës, është kyç për propagandën dhe përdoret për të inkurajuar një ndryshim në sjelljen e audiencës (Lilleker, 2006). Retorika është një mjet i përdorur në komunikimin e të gjitha rrafsheve politike që nga koha e qytet-shteteve greke. Në pikëpamjen e Aristotelit 'retorika është një mjet për të përkulur vullnetin e njerëzve'.

Përfundimet cilësore që arrihen në përmbyllje të një analize sasimore të artikullit të Sali Berishës lidhen, në një masë të madhe, me atë që është quajtur ‘sukses i retorikës’ dhe sipas Lilleker (2006) ka të bëjë me të kuptuarit kompleks të audiencës, normave sociale, vlerave dhe frikës. Kur flasim për audiencë në rastin e shkrimit të analizuar këtu dhe të autorit të saj duhet të kemi parasysh të paktën tri të tilla.

E para është klasa politike në pushtet, e cila i përket një shteti autoritarist apo diktatorial komunist. Çfarë leximi do t’i bëjë ajo ‘gjuhëve’ të artikullshkruesit? Këtu mund të flitet edhe për ‘frikë nga audienca’ dhe jo për njohje të frikërave ta audiencës. Audienca e dytë, është publiku apo ai që, sipas rastit, mund të quhet ‘popull’ apo opinion publik. Çfarë do të gjejnë ata te artikulli i një intelektual si Dr. Berisha? Shpresë për të ardhmen? Qëndresë? Konformizëm? Rebelim? Kjo audiencë është e mbivendosur dhe ‘suksesi’ për të cilin flet Lilleker është i diskutueshëm. Audienca e tretë është ajo që mund të quhet inteligentsia, pra klasa e intelektualëve, elita e mendimit. Gjykimi i tyre do të ishte i një llojit tjetër dhe ata do të konsideronin ‘sukses’ retorik disa parametra të tjerë të artikullit.

Për këtë edhe ‘gjuhët’ e ligjërimit të artikullshkruesit janë disa: ai, me vetëdije ose jo, ka kërkuar që shtresat retorike të bashkohen në një, duke unifikuar kështu edhe audiencat. Gjuha e vjetër është një dedikim për klasën në pushtet; gjuha e re është të kërkuarit e partneritetit me *inteligentsian*; gjuha ideologjike është përpjekja për të ndërtuar vetes një profil politik; dhe, më e fundit, gjuha shkencore vjen në shkrim si ‘rudiment’ profesional i cili luan megjithatë rol duke e veshur me autoritet retorikën.

Duke ndjekur arsyetimin e Aristotelit, sipas të cilit mjetet e disponueshme të bindjes janë të bazuara në tri lloj provash: logos, ethos dhe patos mund të thuhet se Berisha i ka përdorur të tria për të arritur te ‘suksesi’ retorik i artikullit.

5.7 Berisha i krahasuar: teksti dhe konteksti

Klasifikimi si ‘gjuhë e vjetër’ apo ‘gjuhë e re’, përdorur më lart për të kategorizuar ligjërimin e Berishës, do të ishte i paargumentuar pa instrumentin e krahasimit. Pse duhet konsideruar ‘e re’ apo ‘e vjetër’ një gjuhë apo një diskur përkundër një tjetri. Një fenomen politik apo shoqëror bëhet i konceptueshëm apo i pranishëm vetëm pasi është shprehur me fjalë (Sheigal, 200:431). Ky përkufizim na ndihmon për të konceptuar praninë e gjuhës së re dhe të vjetër të përdorur nga Berisha, jo vetëm si fenomenologji politike, por edhe si akses te format e pushtetit. Një instrument tjetër janë të gjithë të kundërtat, politike, shoqërore e ligjërimore të objektit të studimit krahasuar me njësi, gjithashtu politike, shoqërore e ligjërimore.

Trupa ligjërimore prej nga kemi nxjerrë katër gjuhët e diskurit të Berishës është një analizë në gazetën Bashkimi të shtatorit 1990. Tezat, konceptet, njësitë diksursive të pranishme aty, janë analizuar jo vetëm ne vetvete, por edhe si përbërës të kontekstit. Sa prej tyre e interpretojnë këtë kontekst, dhe sa të tjerë ngulmojnë në konstruksionin e një konteksti të ri apo të ndryshëm. Sipas teorive të ‘gjuhës që ndërton’ dhe ‘gjuhës që interpreton’. Për të ‘peshuar’, apo për të matur, dendësinë e gjuhës interpretuese kemi marrë një copë nga konteksti, edhe pse të zhvendësuar përpara në kohë. Për efekt të analizës, me anë të krahasimit apo kontrastit, artikullin e Berishës të shtatorit ‘90 do ta krahasojmë me një ‘Letër të hapur’ të studentëve të Universitetit Bujqësor të Tiranës, botuar një vit e gjysmë më vonë (Zëri i Popullit, 1992: 3).

Artikulli i Berishës është botuar 6 muaj para zgjedhjeve të para pluraliste të marsit 1991, të cilat u fituan nga Partia e Punës së Shqipërisë, për shkak të mbështetjes së fortë në zonat rurale ku asokohe jetonte rreth 70 përqind e popullatës. PD mori të gjithë

qytetet e mëdhenj, por kjo nuk i mjaftoi për shumicën qeverisëse. Letra e hapur e studentëve është botuar 10 ditë para zgjedhjeve të dyta pluraliste të 22 marsit 1992, kur Partia Demokratike fitoi shumicën bindëse të deputetëve duke marrë pushtetin.

Krahasimi mes të dy njësive zhvendoset në tre nivele: të gjuhëve të përdorura nga secili prej komunikuesve (Berisha dhe studentët); kontakti apo koha politike kur janë konstruktuar të dyja; dhe, gjinia e diskurit të cilën ato formulojnë.

Nëse dy të parat janë të qarta, dallimi i tretë është më i mjegullt. Letra është e shkruar nga një grup studentësh të Bujqësorit të cilët e prezantojnë veten si ‘bijtë tuaj fshatarë’. Letra botohet në gazetën Zëri i Popullit, organ i Partisë së Punës (të saposhndërruar në Socialiste). Elementi kyç i dallesës është se komunikimi bëhet nga ‘fshatarët’, ata që i kishin siguruar Partisë së Punës, në zgjedhjet e para një viti, fitoren mbi forcat opozitare antikomuniste. Bashkimi i komunikuesit (studentëve fshatarë) me forumin (gazetën ZP) e identifikon si propagandë tekstin e analizuar këtu. Një ndarje me **bold** e fjalëve ‘të gjuhës së vjetër’ mundëson edhe një instrument tjetër krahasimi mes dy teksteve.

Mos e dëgjoni atë zë...është zëri i përçarjes

Të dashur prindër, motra dhe vëllezër!

Jemi një grup studentësh të Universitetit Bujqësor të Tiranës, të cilët **po ju shkruajmë** nëpërmjet kësaj gazete që **të sjellim tek ju të vërtetën**. Jemi **bijtë tuaj**, fshatarë, që vazhdojmë studimet **në kohën më të vështirë, më të errët**, larg jush po që **ju kemi gjithmonë parasysh. Jetojmë me halle dhe vuajtjet tuaja**. Jemi ne ata që nuk hanë mëngjesin për t’u mos ju shqetësuar, **jeni ju ata që ju dridhet buza për fatin e**

bijave dhe bijve tuaj. Mos u mërzitni. Çdo gjë do të rregullohet. **Do të vijnë ditë të bardha edhe për ju.** Dhe shpejt.

Po mbushet një vit që në Shqipëri u fut pluralizmi politik, liria e fjalës dhe e mendimit. Një vit plot ngjarje e emocione, plot vrasje e shkatërtime, plot kriza e shqetësime. Mijra nga **vëllezërit tanë morën rrugët e kurbetit.** Trishtimi u ngjall në Shqipëri, lotët mbushën rrugët. Deti u mbush edhe me të vdekur. **Nënat u veshën me të zeza.** Morëm **plagë në trup, në shpirt** që s' do të na shërohen një jetë të tërë.

Një vit që u formua Partia Demokratike, partia që do të sillte demokracinë, partia që do të sillte shtatë lloj bukësh, partia e Sali Berishës. Democracia është e bukur, ajo presupozon një jetë të lirë dhe me nivel të lartë ekonomik e kulturor, një jetë ku sundon paqja-urtësia dhe dituria. Për këtë ju jeni të bindur sepse keni parë dhe dëgjuar për botën rreth nesh.

Po Partia Demokratike që aq shumë shpresonim **ç'rrugë ndoqi?! Edhe këtë e provuam.** Ishte Partia Demokratike ajo që mbledhi rreth vetes-vrasës, hajdutë, imoralë; shkatërroi, vrau, dogji; **shau pushtetin në fuqi** për të fitur **pushtet për vete e populli e di mirë këtë.** Po përse i bëri Sali Berisha me partinë e tij këto? Donte popullin?! Jo, jo, nuk i pëlqente puna e kirurgut, nuk i pëlqente karrikja e profesorit, donte **kolltuk lluksoz,** donte emër politikani dhe ia arriti qëllimit. Sot Sali Berisha ka **dy makina në dispozicion.** Ka një shoqërues personal, Azem Hajdarin. **Paguhet me dollarë nga “Zëri i Amerikës”,** ndërsa **populli ha bukën thatë.**

Ishim ne studentët, prindërit tanë të dashur, që **u ngritëm të parët** për demokracinë. Dhe, **nëqoftëse demokracia do të shkelet,** atëherë ne nuk do të rrimë të qetë. **Do të ngrihemi përsëri,** dhe ju **mos u bëni merak,** ne **do të fitojmë! Na falni prindërit tanë**

për ndonjë shqetësim kur thërrsinim e brohorisnim për demokracinë, na **u fut në gjirin tonë edhe ndonjë provokator** si tipi i Sali Berishës, që një vit të tërë ju shau ju si monistë, si komunistë-kriminelë, si punistë të kuq pushtetmbajtës, etj. Shkuam edhe ne bijtë tuaj pas berihajës dhe e bashkuam zërin me atë të pseudodemokratëve. Tani **na u kthjellua mendimi dhe u kërkojmë falje**. Ju nuk jeni antidemokratë, **ju jeni e vërteta e Shqipërisë; ju jeni vetë demokracia**. Menduam dhe shpresuam për të mirën tuaj dhe tonën por **paskemi gabuar**, jemi gënjyer por **kurrë nuk do ta përsërisim**. Ishte Sali Berisha ai që na premtoi, që na gënjeu, ai që hapi varrin tonë, ai që na futi në luftë vëlla me vëlla, ai që sot qesh kur na sheh të rraskapitur, të mundur. Por këto nuk do të ndodhin më: **Vrasësi i demokracisë i ka ditët e numëruara** në atë tempullin ku ka hipur.

Të dashur prindër!

Ju kemi larg po e dimë që zëri i çjerrë i Sali Berishës është futur **në shtëpitë tona të varfra**. Mos e dëgjoni atë zë, ai është **zëri i përçarjes, i vëllavrasjes**; ai zë ngjall kriminelët, **ngjall pronarët e mëdhenj që do të na shtypin përsëri si dikur**.

Njerëz të thjeshtë dhe të vuajtur!

Ju drejtohem juve se ju na kuptoni se **edhe ne jemi si ju**. I njohim dhe **i vuajmë bashkë me ju hallet e rënda të kësaj kohe të zezë**. Shqipëria është futur në rrugën e sistemit pluralist. Duam edhe ne të bëhemi si Evropa, si gjithë bota; duam edhe ne të jemi të lumtur, **të kemi një krevat të butë ku të na prehen kockat** rehat, të pimë një gotë me prindërit, **motrat dhe vëllezërit tanë**, të jemi të qetë të mos na dhëmbi koka nga zhurmat e rrëmujat, nga **hallet që na kanë mbuluar tërë jetën**. Është Partia Socialiste ajo që do na sjellë demokracinë e vërtetë në Shqipëri. Partia, në programin e

së cilës **ne fshatarët gjejmë veten tonë**. Vetëm Partia Socialiste është **partia jonë**, partia që mendon për ne. Ajo tani nuk është më Partia e Punës, sepse ka hequr dorë përfundimisht nga diktatura e proletariatit dhe lufta e klasave. Ajo është një parti e rinovuar, me program të qartë politik dhe ekonomik. **Në radhët e saj** militojnë **bijtë dhe bijat më inteligjente të kombit tonë**. Partia Socialiste është **në luftë të hapur** me të gjithë ato forca politike apo individë që luftojnë për përçarjen e kombit, që nxisin vëllavrasjen, **që duan të kthejnë në pushtet pronarët e mëdhenj**. Ajo është partia më e qetë dhe e ekuilibruar që lufton për zhvillimin e proceseve demokratike në mënyrë graduale. Ajo nuk është parti e rrugëve, parti e britmave, e zhurmave dhe shkatërrimeve.

Të dashur baballarët tanë!

E dimë mirë që po vuani, që jeni të merakosur për ne. Krismat e “demokratëve” dëgjohen edhe aty dhe ia kanë shtuar edhe më shumë **peshën mjerimit që na ka pllakosur**. Mos u trishtoni, mos u frikësoni. **Ne jemi të fortë**, jemi të gjallë. **Pushteti n’a takon neve** dhe jo hajdutëve, kriminelëve dhe mashtruesve dhe imoralëve. **Këtij kombi asnjëherë nuk i kanë munguar burrat**.

Nënat tona të shtrenjta!

Ju drejtohem juve që sot gatuani bukën me lot në sy, ju që mezi na rritët me vuajtje e mundime, ju që na mëkuat e edukuat me frymën e dhembshurisë e respektit. Është Partia Socialiste ajo që mendon për ne, ajo **që do të sjellë ditë të bardha**, për ju e fëmijët tuaj. Merrni pjesë në votime, votoni për Partinë Socialiste! **Ditë të lumtura do të vijnë edhe për ne**.

Motrat tona të dashura!

Na vjen keq për ju, që **nuk ju pamë njëherë me rroba të reja**, që kjo kohë ju ka izoluar e **ju ka hequr çdo të drejtë njerëzore**. I njohim ëndrrat dhe dëshirat tuaja. U themi me bindje: çdo gjë do të rregullohet, ashtu si duam ne, **si e do populli** e jo si e duan “demokratët” që duan të luajnë me nderin dhe autoritetin tuaj. Votoni të bindura për Partinë Socialiste, ajo është **partia jonë, partia e njerëzve të thjeshtë**.

Të dashur vëllezër dhe bashkëmoshatarë!

Ju sot jeni të rinj, të fortë. E dimë se **jeni të papunë dhe heshtni të lënduar**. Edhe ju doni të shikoni botën, të punoni atje, **të jetoni të lumtur**. Vetëm Partia Socialiste na garanton një gjë të tillë. Do t’a shohim botën sa do të mërzitemi, do të bëhemi edhe ne të pasur e të lumtur një ditë. Mos harroni, është PD-ja ajo që nxiti operacionin “Fshesa” në Greqi e disa nga vëllezërit tanë i ktheu në arkivole. Votoni të bindur për PS! Tani ne jemi vend pluralist dhe rrugët janë të hapura. Do të shkojmë të punojmë në botë, por do të jemi emigrantë të rregullt. Me vizë e autoritar, që **të huajt mos të tallen me ne**. Këtë ua garanton vetëm Partia Socialiste nëpërmjet emigracionit të organizuar.

Të nderuar intelektualë!

Tregojini popullit të vërtetën. Mos e humbni toruan, tregohuni të matur, **ju jeni prijësit e demokracisë së vërtetë** në Shqipëri. Në këto momente të vështira, **më shumë se kurrë populli ka nevojë për ju**.

Të dashur prindër, motra dhe vëllezër në gjithë Shqipërinë!

Jemi bijtë tuaj që ju bëjmë thirrje:

Votoni për Partinë Socialiste!

Ajo është e vërteta që po e shikojmë me sytë tanë.

Jemi bijtë tuaj, jemi me ju.

Vlash Baba, Dritan Pershqefa, Gjergj Kola, Gramos Balla, Gjin Shqalsi, Alfred Çausi, Viktor Dharmo, Ilir Baçi, Ilir Naçi, Ilir Osmani, Artan Çela, Artan Arapi, Arben Skendo, Violeta Doda, Irakli Karakashi, Rezart Palla, Lulzim Aliaj, Anila Marudaj, Dhurata Muçaj, Adriatik Hasa, Moza Guri, Violeta Marku, Koço Halikaj, Flamur Mema, Etleva Koçi- studentë në Universitetin Bujqësor, Tiranë.

Zëri i Popullit, 11 mars 1992, f. 3.

5.8 Analizë e diskurit ideologjik të programit të një partie të djathtë

Sipas një studimi të NDI (National Democratic Institute-2013), faktorët kontekstualë që ndikojnë në formimin e identitetit të partive politike janë disa. Këtu përfshihen: niveli i zhvillimit ekonomik, sistemi elektoral, ligji (statuti) i partisë, struktura sociale, origjina e partisë dhe institucionalizimi. I njëjti studim bën një ndarje mes dimensioneve të identitetit të partisë, dhe këtu mund të dallojmë *partitë e udhëhequra nga personaliteti* dhe *partitë e udhëhequra nga programi*.

Kjo ndarje cilësore e identiteteve partiake takohet me fokusin e punimit tonë, i cili me anë të analizës së diskurit, mundohet të identifikojë ndikimin e kontekstit dhe të individit në zhvillimet politike dhe ligjërimit politik të Sali Berishës, gjatë periudhës 1990-1992. Teksti i analizuar më lart, ai i një shkrimi të Berishës në gazetën *Bashkimi*, nëpërmjet asaj që e kemi etiketuar si *gjuhë të re*, *gjuhë të vjetër*, *gjuhë ideologjike*, dhe *gjuhë teknike*, evidenton një ndarje ku personaliteti ngre peshë disi më shumë, por konteksti është gjithsesi ndikues, dhe në një masë të konsiderueshme.

Duke patur një provë sasiore të ndikimit të personalitetit të subjektit që studiojmë në diskurin politik, gjithashtu prurjet cilësore të kapitujve paraardhës, materializuar në kronikat dhe analizat e teksteve të asaj kohe, dhe atyre që flasin për atë kohë, do të marrim në analizë një variabël tjetër. Do të shqyrtojmë programin elektorale të Partisë Demokratike në zgjedhjet e 22 marsit 1992 (Rilindja Demokratike 1992: 1,4). Analiza e tekstit do të bëhet me parametrat e një *tabele të ideologjive* të politologut Andreë Heywood (2013). Nëse e pranojmë përkufizimin e studiuesve të NDI për *një parti të udhëhequr nga personaliteti (i liderit)*, konsiderojmë edhe faktin se, programi i Partisë Demokratike reflekton kontekstin politik e social të kohës, por në një masë të madhe edhe liderin e saj. Do të ndjekim të njëjtën teknikë evidentimi, nënvizimin e termave apo koncepteve politike dhe më poshtë dy fjalorë (i djathtë/ i majtë) që do nxirren nga këto *veçime*. Tabela e Heywood do të jetë parametri matës për të bërë ‘kryqëzimin’. Por jo i vetmi: përfundimet e arritura nga Boobio, Nisbet, Scruton e të tjerë, në kapitujt pararendës, do të jenë gjithashtu mjete të ‘kryqëzimit’ dhe identifikimit. Ndryshe nga tekstet e analizuara më lart në këtë kapitull, këtu do ndalemi vetëm te diskuri ideologjik. Pra, me anë të cilëve terma PD (Berisha) e paraqesin veten si të djathtë apo të majtë. (Programi i plotë, për shkak të kufizimeve që dikton punimi në kuptimin e infrastrukturës, nuk do të jepet i plotë këtu, por mund të gjendet në fund të punimit të Aneksi).

LIBERALIZMI

Tabela 8: Ndarja ideologjike sipas Heywood

Universalistët	Pluralistët
Arsye universale	Skepticism

Kërkim i së vërtetës	Synim i rendit
Vlera themelore	Pluralizëm vleror
Tolerim liberal	Politikë difference
Të drejta njeriu	Të drejta kulturore
Kulturë liberal-demokrate	Multikulturalizëm
Triumfalizëm liberal	Forma politike plural

Klasikët	Modernët
Liberalizëm ekonomik	Liberalizëm social
Individualizëm egoistik	Individualizëm zhvillimor
Maksimizim dobie	Rritje personale
Liri negative	Liri positive
Shtet minimal	Shtet aftësues
Ekonomi tregu të lirë	Ekonomi të menaxhuar
Drejtësi të bazuar te të drejtat	Drejtësi si ndershmëri
Meritokraci strikte	Kujdes për të varfërit
Përgjegjësi individuale	Përgjegjësi sociale
Mirëqenie- rrjete-sigurie	Mirëqenie- nga-djepi-në-varr

KONSERVATORIZMI

Pragmatikët	Libertarët
Pragmatikë	Ideologjikë

Tradicionalizëm	Radikalizëm
Detyrë sociale	Egoizëm
Shoqëri organike	Individualizëm atomistic
Hierarki	Meritokraci
Paternalizëm	Ndihmë vetjake
Përgjegjësi morale	Të drejta ekonomike
Rend natyror	Rend tregu
Ekonomi 'e rrugës së mesme'	Ekonomi <i>laissez-faire</i>
Mirëqenie e cilësuar	Kundër mirëqenies

Neo-liberalët	Neo-konservatorët
Liberalizëm klasik	Konservatorizëm tradicional
Atomizëm	Organicizëm
Radikalizëm	Tradicionalizëm
Libertarizëm	Autoritarizëm
Dinamizëm ekonomik	Rend social
Interes vetjak/sipërmarrje	Vlera tradicionale
Barazi mundësish	Hierarki natyrore
Shtet minimal	Shtet i forte
Internacionalizëm	Nacionalizëm protektiv
Pro-globalist	Anti-globalist

SOCIALIZMI

Social demokratët	Komunistët
Socializëm etik	Socializëm shkencor
Revizionizëm	Fundamentalizëm
Reformizëm	Utopizëm
Evolucion/gradualizëm	Revolucion
Kapitalizëm 'human'	Anti-kapitalizëm
Rishpërndarje	Pronësi e përbashkët
Përmirësim të konfliktit klasor	Shoqëri pa klasa
Barazi relative	Barazi absolute
Ekonomi mikse	Kolektivizim shtetëror
Menaxhim ekonomik	Planifikim i centralizuar
Parti parlamentare	Parti pararojë
Pluralizëm politik	Diktaturë proletariat
Shtet liberal-demokrat	Shtet proletar/popullor

Rruga e Tretë	Social demokratët
Pragmatikë	Ideologjikë
Globalizim	Shtet kombëtar
Shoqëri informacioni	Shoqëri industrial
Komunitet	Politikë klasore
Ekonomi tregu	Ekonomi mikes
Punësueshmëri e plotë	Punësim i plotë

Barazi mundësish	Barazi rezultati
Meritokraci	Kujdes për humbësit
Mundësi për të gjithë	Drejtësi sociale
Promovim i përfshirjes	Zhdukje e varfërisë
Të drejta dhe përgjegjësi	Të drejta sociale
Mirëqenie-për-të-punuar	Mirëqenie-nga-djepi-në-varr
Konkurrencë/shtet tregtar	Shtet reformator social

NACIONALIZMI

Qytetarët	Etnokulturore
Komb politik	Komb kulturor/historic
Përfshirës	Përjashtues
Universalizëm	Partikularizëm
Kombe të barabarta	Kombe unike
Racionalë/parimorë	Mistikë/emocionalë
Sovranitet kombëtar	‘Shpirt’ kombëtar
Voluntaristik	Organik
Bazuar në shtetësi	Bazuar në prejardhje
Besnikëri qytetare	Besnikëri etnike
Diversitet kulturor	Unitet kulturor

Liberalët	Ekspansionistët
Vetëvendosje kombëtare	Shovinizëm kombëtar
Përfshirës	Përjashtues
Voluntaristik	Organik
Progresivë	Reaksionarë
Racionalë/parimorë	Emocionalë/instinctive
Të drejta njeriu	Interes kombëtar
Kombe të barabarta	Hierarki kombesh
Konstitucionalizëm	Autoritarizëm
Pluralizëm etnik/kulturor	Pastërti etnike/kulturore
Kozmopolitizëm	Imperializëm/militarizëm
Siguri kolektive	Politikë pushteti
Supranacionalizëm	Anarki ndërkombëtare

ANARKIZMI

Individualistët	Kolektivistët
Ultra-liberalizëm	Ultra-socializëm
Individualizëm ekstrem	Kolektivizëm ekstrem
Individ sovran	Humanitet i përbashkët
Mosbindje civile	Revolucion social
Atomizëm	Politikë klasore
Egoizëm	Bashkëpunim
Detyrim kontraktor	Detyrë sociale

Mekanizëm tregu	Organizim i përbashkët
Pronësi private	Pronësi e përbashkët
Kapitalizëm anarkik	Komunizëm anarkik

FASHIZMI

Fashistët	Nazistët
Adhurim i shtetit	Shteti si venë
Nacionalizëm shovinist	Racizëm ekstrem
Voluntarizëm	Esencializëm
Madhështi kombëtare	Superioritet biologjik
Unitet organik	Pastërti racore
Anti-semitizëm pragmatik	Anti-semitizëm genocidal
Futurizëm/modernizëm	Ideologji fshatare
Korporatizëm	Ekonomi lufte
Ekspansion kolonial	Dominim botëror

FEMINIZMI

Barazitarët	Diferencialët
Androgjini	Esencializëm
Lidhje personash	Lidhje motrash
Të drejta njeriu	Të drejta grash
Barazi gjinore	Çlirim seksual

Zbutje difference	Festim difference
Dallim i seksit nga gjinia	Seksi baraz gjini
Kapërcim i biologjikes	Përqafim i biologjikes
Pro-njeriut	Pro-gruas
Burrat janë të përmirësueshëm	Burrat janë ‘problemi’
Bashkëveprim me burrat	Separatizëm feminist

Radikalët	Liberalët
Çlirim i grave	Emancipim i femrës
Patriarkat	Pabarazi gjinore
Lidhje motrash	Individualizëm
Personalja është politike	Politikë konvencionale
Transformim të sferës private	Dallim publike/private
Barazi gjinore	Akses në sferën publike
Politikë seksuale	Të drejta/mundësi të barabarta
Ndryshim revolucionar	Reformë/gradualizëm
Ndërgjegjësim	Aktivizëm politik

EKOLOGJIZMI

‘Të thellët’	‘Sipërfaqësorët’
Ekologjizëm	Ambientalizëm
Ekocentrizëm	Antropocentrizëm ‘i lehtë’

Misticizëm	Shkencë
Natyrë	Njerëzim
Holizëm radikal	Holizëm ngurues
Vlerë-në-natyrë	Vlerë instrumentale
Barazi biocentrike	Konservim i natyrës jo njerëzore
Të drejta kafshësh	Mirëqenie kafshësh
Anti-rritje	Rritje të qëndrueshme
Ndërgjegje ekologjike	Zhvillim personal

Tabela 9: Fjalori i djathtë

lirisë ekonomike
bashkimin e kombit
modelin enverist të stalinizmit
zëvendësim i shtetit
me partinë e vetme
ideve të partisë-shtet
lufta famëkeqe e klasave
ndalimi i mendimit të lirë
izolimi nga bota e qytetëruar
doktrinës së dështuar të komunizmit
kombit shqiptar
lirinë e individit

mbrojtjen e interesave kombëtare
iniciativën e lirë të shtetit
shqiptarëve
shfrytëzimin (e) potencialit njerëzor
investimet e huaja
familjen evropjane
forcimin e unitetit kombëtar
një shoqëri pluraliste demokratike dhe moderne
ndërtimin e shtetit juridik
mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të individit
të shenjtë e të paprekshme pronën private
kthimin (ose) kompensimin të pronave ish pronarëve
parimin e ndarjes së pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor
pjesëmarrjen e lirë të individit në jetën politike dhe ekonomike të shoqërisë
vetëqeverisjen e pushtetit gjyqësor
departizimi i të gjitha institucioneve
depolitizimi të vërtetë të ushtrisë
reformimin (e) pushtetit lokal
duke këputur njëherë e përgjithmonë, zinxhirët e centralizmit demokratik burokratik
autonomie të gjerë lokale
decentralizmit e të vetëqeverisjes
interesat e kombit shqiptar
demokracisë e ekonomisë së tregut

nxitjes dhe mbështetjes politike e ekonomike ndërkombëtare
ndërkombëtarizimin e çështjes mbarëshqiptare
prioritet bazë marrëdhëniet me SHBA dhe me vendet demokratike të Evropës Perëndimore
përfshirje të menjëhershme të Shqipërisë në procesin e integritit evropian
aleatët tradicionalë e historikë të vendit
zgjidhjen e çështjes kombëtare
komuniteti shqiptar në SHBA
integrimin e vendit në Komunitetin Evropian
NATO një garant të paqes dhe stabilitetit
anëtarësinë e Shqipërisë në këtë organizatë
garantimin e të tërë të drejtave të pakicave greke
ndjekjen e së njëjtës politikë ndaj popullsisë shqiptare (çame)
njohjen e së drejtës për riatdhesim të çamëve
respektimi i të drejtave dhe i vullnetit të kombit shqiptar në një republikë
problemin e shqiptarëve që banojnë në trojet e tyre në Jugosllavi
drejtim bazë të politikës sonë të jashtme
konsiderimin e shqiptarëve në Jugosllavi si komb shtetformues
njohim Republikën e Kosovës
të drejtën shtetformuese të shqiptarëve në Maqedoni
zgjidhjen e këtij problemi kombëtar
pakicave kombëtare të njëjtat të drejta me ato të shtetasve të tjerë
vlerave shpirtërore të shoqërisë shqiptare

shteti shqiptar (...) laik
riafirmimin e vlerave fetare dhe ndërtimin e institucioneve fetare
rikrijimin e shkollave fetare
komuniteteve fetare t'u kthehen pasuritë e konfiskuara
festat më të shënuara fetare të shpallen ditë pushimi të paguara
lëvizjen e lirë të shtetasve brenda dhe jashtë vendit
qarkullimin e të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë
pajtimin kombëtar
individët në të njëjtin start
mbylljen e dosjeve
Goditja...e mbledhjes së Mukjes
ekonomisë së tregut
agonia e ekonomisë së centralizuar
ekonomia e tregut e mbështetur në pronën private të individëve të lirë
konkurrencë të lirë dhe shkallmim të burokracisë së shtetit në ekonomi
afirmimin e plotë të pronës private
ekonomi singëll
integrim të ekonomisë sonë në ekonominë botërore për të lejuar investimet e huaja
liberalizimi i çmimeve
asnjë shpenzim parazitar
aparati administrativ shtetëror të kufizohet në minimumin
heqim subvencionet për ndërmarrjet parazitare
t'i nxisë iniciativën e lirë

frenojë parazitizmin
Taksa (...) stimuluese për sektorët privat
privatizimi, si i dyqaneve dhe mjeteve të transportit
kontroll rigoroz të Parlamentit mbi buxhetin për të ndaluar çdo abuzim administrativ apo keqpërdorim të arkës së shtetit
Në këtë mënyrë do të frenohet rigorozisht shtypja e monedhës dhe emëtimi i saj mbi bazë inflacioniste
konkurrencë të lirë
liberalizimi të plotë të çmimit
treg të lirë dhe me çmime të lira jo të komanduara nga qendra dhe të shtrembëruara
Liberalizimi i çmimeve
favorizuar tregun e lirë privat
privatizimit në bujqësi dhe tregti
liberalizuar (...) marrëdhëniet e eksport – importit
të pengohet krijimi i monopoleve që frenojnë konkurrencën e lirë
Sektorët privat do të stimulohen në maksimum.
privatizimi në industri
privatizimin e burimeve natyrore
Privatizimi me letra me vlerë falas do të kryhet edhe për banesat ekzistuese
rikthimin e banesave të konfiskuara ish pronarëve të tyre.
çlirojmë punën nga skllavëria e komunizmit e cila bënte që individi të punonte për shtetin dhe jo për vetveten
marrëdhënie pune të lira

investimet e huaja si kusht për rritjen ekonomike të vendit, punësimit, mirëqenies
bankat të japin kredi për investime në Shqipëri
Liberalizimi i investimeve të huaja
investimet e huaja në turizëm, duke mos lejuar shpërdorimin e ambientit
në lidhjen e marrëveshjeve me të huajt t'i nënshtrohet kontrollit permanent nga parlamenti
zhvillimit ekonomik në bazë rajonale
pavarësinë ekonomike të çdo zone të veçantë
pavarësi në buxhetet lokale
fund procesit të shkatërrimit të mjedisit
riaftësimin e mjedisit
ligje të rrepta për mbrojtjen e mjedisit
rikuperimi të vlerave ambientale si në ripyllëzime, eliminimin e lëndëve toksike nga atmosfera, në rikuperimin e ujërave
shpronësimin e shtetit dhe privatizimin e tokës
Shteti Demokratik do t'i garantojë me ligj ish pronarëve të tokave pavarësisht ku banojnë sot shpërblimin në vlerë, në një masë të mundshme të pronës tokësore të zotëruar para reformës agrare të vitit 1946
privatizimin edhe në kullotat dhe livadhet
privatizimin e ndërmarrjeve dhe mjeteve të peshkimit
Ne do të luftojmë që të realizojmë në bujqësi një ekonomi të fuqishme e të aftë për të konkurruar, duke e orientuar atë në funksion të tregut
kur toka është pronë private, ekziston mundësia reale e kooperimit me forma të njohura

ligjore midis fshatarëve të lirë
Fshatarët pronarë individualë do të jenë të lirë të organizojnë, sipas dëshirës dhe nevojave të tyre, çfarëdo lloj veprimtarie ekonomike bujqësore të kooperuar që bazohet në pronën private mbi tokën
ndërmarrjet e sotme shtetërore të ngritura
formave moderne aksioniste me pjesëmarrjen e kapitalit të firmave të huaja
bujqësia do të trajtohet si aktivitet i lirë profesional
subvencionet nëpërmjet koncensioneve
çmime që do të përcaktohen në bazë të kërkesës dhe ofertës
Bujku ynë në tokën e tij nuk do të prodhojë drithëra për nevojat e familjes së vet, por do të kultivojë bimë të tilla, që të sigurojë prej tyre fitim.
Mekanizimi i bujqësisë
çlirimi nga mundimi i krahut të punës
Kreditë e para afatgjata
mekanizmi privat
krijimi i shoqërive private të ujitjes
për kualifikimin e organizuar të punonjësve shqiptarë
të stimulohet emigracioni
emigrimi i organizuar i punëtorëve
Nxitjes për krijimin e fermave të vogla familjare
të drejtave e të shanseve të barabarta për çdo individ
respektimit të pronës private
lirinë e të drejtave e të shanseve të barabarta për çdo individ

çdo individ gëzon të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit
lirinë e të shprehurit, lirinë e shoqërimit dhe grumbullimit paqësor, lirinë e lëvizjes
të drejtën të njohë dhe veprojë në bazë të të drejtave
zgjedhje të lira
të drejtën e zotërimit të pronës
të hapë ndërmarrje private
lirinë e individit si kushtin themelor në realizimin e demokracisë së vërtetë
rritjes së investimeve të kapitalit të huaj e vendas
nxisim individualitetet
stimulojmë talentet
sektorit privat në shkencë
ç'ideologjizimin e arsimit
iniciativën private për financimin e shkollave
formim i lëndëve me zgjedhje
për të mos penguar nismat jo shtetërore për zhvillime fakultative të orëve të mësimi të fesë
krijimin e shërbimit shëndetësor privat
çdo qytetar të zgjedhë vet mjekun dhe institucionin shëndetësor ku do të mjekohet
hartimin e një politike shkencore për rregullimin e arkitekturës
asnjë kufizim të të rinjve që buron nga pozita e saj sociale apo prej të përndjekuri
i njohim çdo të riu shanse të barabarta për çdo nivel të arsimit, shanse të barabarta për punësim
Ndërmarrjet do të drejtohen nga këshillat drejtuese. Në ato ndërmarrje që me ligj do të

konsiderohen të rëndësishë strategjike shteti do të jetë palë me këshillat drejtuese të ndërmarrjeve

Do të punohet për kthimin e industrive ushtarake në industri civile

Tabela 10: Fjalori i majtë

drejtësisë shoqërore

ngritjes së nivelit material e shpirtëror

vlerësojmë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare

e bënë masat e gjëra popullore në emër të çlirimit të vendit, të një Shqipërie të pavarur e demokratike e të zgjedhjes së problemit kombëtar

zëvendësimin e dinastisë së Zogollit të parë me atë të Hoxhës së parë

krijimin e Kastës së aristokracisë së kuqe

ruajtjen e vlerave të vërteta të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

shpenzimet nëpërmjet buxhetit t'u sigurojnë një jetë sociale normale njerëzve

të paktën për një vit të mbajmë të kontrolluar një grup të kufizuar mallrash si bukën, vajin, sheqerin e energjinë elektrike, vajgurin e ndonjë mall tjetër për të cilat mendojmë që rritjen e çmimit t'ia kompensojmë punonjësve në paga

asistencë sociale të mjaftueshme

Latifondistët dhe çifligarët e mëdhenj do të kompensohen vetëm në masën e fshatarëve të mesëm

duke lejuar shitblerjen e tokës bujqësore vetëm për shtetasit shqiptarë

Nuk do të lejohet shitblerja dhe tjetërsimi i tokave personave të huaj fizik dhe juridik

një reforme të plotë dhe të studiuar agrare
e mbajti fjalën e dhënë duke e bërë fshatarin për jetë të jetëve, zot të tokës së vet
ngritjen e një rrjeti të dendur tregtar si dhe të qendrave grosiste private e shtetërore të grumbullimit dhe të furnizimit, të cilat do të thithin prodhimet bujqësore dhe blegtorale nga fshati si dhe do t'i pajisin prodhuesit individualë dhe kolektivë me farëra të zgjedhura, plehra kimike, ushqime për blegtorinë me kafshë të racës etj
shteti të garantojë gradualisht për të gjitha fshatrat pa përjashtim, bukën e grurit jo vetëm si sasi të mjaftueshme, por edhe në cilësi, nëpërmjet prodhimit të drithërave në vend, por edhe nëpërmjet importit. Gruas shqiptare të fshatit do t'i hiqet njëherë e përgjithmonë barra e rëndë e përgatitjes së bukës
Ne do të luftojmë që shteti të parashikojë investimet reale për çdo zonë në fshat, në afate të përcaktuara për zhvillimin infrastrukturës, duke vënë në plan të parë hapjen e rrugëve të reja automobilistike si dhe asfaltimin e atyre ekzistuese për lidhjen e të gjitha fshatrave të vendit. PD do të luftojë gjithashtu që të ngrihet një rrjet bashkëkohor telefonik, i cili do të përballojë edhe nevojat e familjeve fshatare.
detyrë urgjente sigurimin e ujit të pishëm për çdo familje fshatare
Do të organizohet kualifikimi i shpejtë brenda dhe jashtë vendit i specialistëve të bujqësisë
PD do të luftojë që intelektualët që punojnë në fshatra, ekonomistët, agronomët, zooteknikët, veterinerët, por edhe ata të sektorëve të arsimit, të mjekësisë dhe të kulturës, të trajtohen njësoj sikurse dhe kolegët e tyre europianë, në mënyrë që dhe ata t'u krijohen mundësitë për të siguruar një jetë të denjë si për vete ashtu edhe për të ardhmen e fëmijëve të tyre
Do t'u jepet përparësi kualifikimit dhe punësimit në qytetet e mëdha të anëtarëve të

familjeve që janë shpërngulur nga përmytjet, tërmetet etj.
Do të studiohen mundësitë e shpërnguljeve graduale të një pjese të kësaj popullsie drejt qyteteve, kantierëve dhe zonave të reja industriale
Do të jepen kredi për strehimin e familjeve që shpërngulen në qytete, me qëllim që të zhvillojnë aktivitet privat, të cilat nuk kërkojnë punësim
Do t'u krijojë mundësi për emigrim ekonomik të organizuar dhe privat jashtë vendit anëtarëve të familjes me prejardhje nga këto zona
Shteti për zhvillimin e blegtorisë në këto zona, do të japë kredi dhe do të krijojë mundësi për blerjen e kafshëve, krijimin e bashkësive blegtorale, baxhove, stallave, përmirësimin e kullotave etj
do të luftojë për zhvillimin e agroturizmit
Përkrahjes nga shteti
siguruar furnizimin me kafshë
Evitimi të katastrofave në komplekset e mëdha blegtorale, nëpërmjet sigurimit të sasive të nevojshme të ushqimeve dhe përmirësimit të teknologjisë ekzistuese
ngritjes së një sistemi shtetëror dhe privat, në shkallë kombëtare, fabrikash të prodhimit të ushqimeve koncentrate që u shërbejnë të gjitha kategorive të kafshëve
Ruajtjes dhe zhvillimit të racave të pastra të përshtatshme në kushtet e vendit tonë dhe të racave tashmë tipike shqiptare me aftësi të lartë prodhuese
Investimeve në shkallë kombëtare për rivendosjen e ekuilibrit biologjik dhe prodhues në masivet kullosore të shkatërruara ose të dëmtuara
Organizimi i qendrave didaktike, për kualifikimin e punonjësve të blegtorisë
Organizimi shkencor i prodhimit blegtoral dhe krijimi i shoqatave racore, si dhe krijimi i strukturave organizative

Do të organizohet në të gjithë territorin e vendit, ngritja e qendrave racore, të cilat do të marrin përsipër zbatimin jo vetëm të përmirësimit racor në blegtori, duke angazhuar për këtë qëllim specialistët zooteknik dhe ato veterinerë, por edhe shkrirjen e veprimtarisë së tyre në çdo fshat
e asistencës sociale për të gjitha shtresat shoqërore
emancipimin (e vërtetë) të gruas shqiptare
duke e çliruar (gruan) nga barra e dyfishtë e punëve shtëpiake dhe shtetërore
njohim barazinë e burrit me gruan
të ndalohen punët e rënda për gratë
kontrollin e lindjeve dhe planifikimin e familjeve
subvencione të rëndësishme në varësi të të ardhurave kombëtare
Krahas shkollave të financuara nga shteti demokratik
një strategjie shëndetësore të njëjtë për të gjithë
shërbimin shëndetësor falas për të gjithë të sigurvekshmit dhe ata pa mjete jetese
Ne do të luftojmë për specializimin dhe kualifikimin e gjithë personelit mjekësor si brenda ashtu dhe jashtë shtetit me synim rritjen e dukshme të nivelit tekniko- shkencor të tij
të marrim masat e duhura për ndalimin e hyrjes së SIDA-s
një brez të ri me idenë e integritetit në Europë
rëndësi të veçantë ruajtjes së ambientit

KAPITULLI VI

GJUHA INTERPRETUESE DHE NDËRTUESE

6.1 Çfarë ndërton Berisha me anë të gjuhës (7 detyrat ndërtuese të James Paul Gee)

Një prej qasjeve mbi të cilën jemi bazuar, metodologjikisht, për të hulumtuar diskurin politik të Sali Berishës (shih Hyrjen) është pjesë e *analizës kritike të diskurit*. Ajo evidenton si thelbësore, jo *funksionin e gjuhës*, dhe as *shpjegimit*, por *pjesëmarrjen*. Është ajo që thotë studiuesi James Paul Gee, theksuar në kapituj pararendës, se gjuha merr kuptim *në* e *përmes* praktikave sociale. Shkurt, me anë të gjuhës, ne ndërtojmë gjëra.

Nëse kërkojmë në gjuhën e Berishës një konstruksion të tillë (ndërtimtari, le të themi) duke u nisur nga përfundimi i Gee se me anë të gjuhës ne ndërtojmë (ose konceptojmë) shtatë gjëra ose zona të realitetit, këto janë disa prej përfundimeve:

-Domethënia: këtë detyrë gjuha e kryen kur do të fusë në zonat e domethënies së lartë akte apo dukuri që nuk janë domethënëse në vetvete si martesë, lindja e një fëmije, vdekja e një të dashuri, etj. Kur flet për diktaturën komuniste në Shqipëri, ligjërimi i Berishës e transmeton në këtë formë domethënien: *kjo diktaturë e izoloi vendin nga bota dhe bëri që bota ta harrojë se Shqipëria ekziston* (Berisha 1991: 1). Siç shihet, përdorimi dy herë i fjalës ‘bota’ e thekson ‘izolimin’, por domethënien më të madhe *aktit të fjalës* ia jep ‘harrimi’, vënë ky përballë së kundërtës së vet ‘ekzistencës’. Kontrasti mes këtyre dy koncepteve dhe dukurive, harresës dhe ekzistencës, e bën fjalën të veprojë dhe të krijojë domethënie. Këtu duhet mbajtur parasysh edhe konteksti ose vendi ku mbahet fjalimi, në Kongresin Amerikan, një institucion që ka bërë shumë në

luftën kundër komunizmit dhe është munduar të shkëpusë nga ‘harrimi’ dhe të fusë në ‘ekzistencë’ vende të izoluara si Shqipëria. Fjala në këtë rast vepron dhe formon domethënie të dyfishtë.

-Praktikat: këtë detyrë gjuha e kryen duke transmetuar një sjellje shoqërisht të njohur apo institucionalisht dhe kulturalisht të mbështetur si psh inkurajimi i një studenti, thirrja për aksion, e të tjera. Gjuha e Berishës gjen raste të shumta për të evokuar apo për t’u kthyer në praktikë, sidomos gjatë fjalimeve elektorale apo thirrjeve për mobilizim në ditët e fundit para zgjedhjeve. *...të intensifikojnë veprimtaritë e tyre; ...të marrin masa të gjithanëshme për kontrollin e rreptë dhe rigoroz të qendrave të votimit; ...nuk na lejohet të harrojmë se çdo mosvotim është votim për socialistët* (Berisha 1992: 2).

-Identitete: Berisha e përdor shumë gjuhën si mjet njohës, dhe kryesisht në një formë inverse duke i mveshur të tjerëve një identitet të cilin në fakt e ka ndërmend për veten. Këtë e bëjnë jo vetëm për të gjetur *common ground* (të përbashkëta) por edhe për të skicuar një profil të vetin nëpërmjet tjetrit apo të tjerëve. Si në rastrin e një takimi me rininë: *...ju dhjetorët e zinj ia shndërruat këtij populli në dhjetorë të bardhë; ...ju do t’i ktheni kombit virtytet e tij, kulturën, ju do ta bashkoni atë me Europën* (Berisha 1992: 1).

Një formë tjetër e identitetit me anë të gjuhës, bëhet edhe me anë të dallimeve krahinore. Një rast të tillë na e shërben paskajorja (ajo ka punue) e Berishës (1991: 1), me anë të së cilës ai ndërtonte identitetin e vet geg/verior. Për një dallim, që mund të jetë i formës apo i përmbajtjes, paskajorja ndeshet shumë rrallë në tekstet e Berishës ndërsa shfaqet me shumicë në të folurën e tij.

-Marrdhënie: gjuha na lejon të ndërtojmë apo të hamendësojmë një raport formal apo informal me tjetrin. Në rastin e objektit të studimit të këtushëm, gjuha zyrtare e Berishës është e mbushur me formalitete, kjo edhe për shkak të sferës publike, protagonist i së cilës është. Duke ditur këtë pritet të jetë e përherëshme ndeshja me këtë mënyre të të shpërfaqurit të raporteve, që vijnë në format: *zonja dhe zotërinj; të nderuar deputetë; zoti kryetar*, etj (Berisha 1991: 1). Ky formalitet i gjuhës kthehet në informalitet kur skena politike lëviz nga sallat e mbyllura, dhomat e takimeve, mjediset e konferencave apo aula e Kuvendit, në takime me popullin si nëpër sheshe, pallate sporti, ndërmarrje të ndryshme etj. Në këto raste gjuha e Berishës zhvishet nga ndërtimi i një marrdhënieje formale duke përdorur frazën e ngrohtë dhe familjare: *vëllezër e motra* apo *të dashur*...(Berisha 1992: 1) e me radhë.

-Politikat: (këtu në kuptimin e përdorur nga Gee-shpërndarje e të mirave sociale) diskuri i Berishës ‘interesohet’ për gjuhën që ndërton krahasime apo përthyerje të forta; ai me anë të gjuhës krijon hendeqe politike, morale a botëkuptimore të cilat, mund të grupoheshin edhe në kategoritë etike ‘e mira/ e keqja’. Si në rastin e një artikulli të gjatë, i cili që në titull e shfaq atë hendek të përmendur më lart (Aleancë e rrezikshme antishqiptare), dhe vijon për të krijuar me anë të gjuhës dikotomi të tipit e bardha/e zeza: *ndërrimi i sistemit, dmth kalimi nga socializmi real totalitar në shoqërinë e re demokratike, ka në bazë zëvendësimin e pronës shtetërore me pronën private; të punës së skllavëruar me punën e lirë* (Berisha 1991: 1, 5). E mira sociale që shpërndahet këtu është, në njëfarë mënyre, sistemike dhe i shkon pronës private (puna e lirë) përkundërt pronës shtetërore (puna e skllavëruar).

-Lidhje: të përdorurit e gjuhës për të bërë një lidhje mes dy gjërave apo fenomeneve në diskurin politik është një ‘mjet pune’. Në një intervistë të gjatë për RD,

Berisha bën një lidhje të tillë: *dëshiroj të theksoj se qeveria aktuale* (ajo e Stabilitetit-shënim im) *nuk është qeveri e PD, siç po e paraqet atë propaganda e Partisë Socialiste, enveristët dhe Sigurimi i Shtetit Shqiptar* (Berisha 1991: 1,6). Lidhjet dhe relevanca (qoftë edhe e hamendësuar) ndërmjet gjërave, e popullon me shumicë diskurin e Berishës, kjo me qëllimin e identifikimit të ne/ata, unë/ai, e mira/e keqja; progresivja/e prapambetura, e me radhë.

-Sisteme shenjash dhe dijesh: dy varietete të gjuhës mund të përkufizohen si pjesë e një ‘sistemi shenjash’: gjuha teknike (shkencore) dhe gegnishtja, e cekur më lart me shembullin e paskajores. Duke nga ardhur nga shkenca e mjekësisë, prezantimet e para të Berishës në publik, përveçse bëheshin me titullin formal të kardiologut, fusnin në diskur terma të shkencore si *kërkimin; zbulimin; ekspozimin; pozitivizëm; metodave; teknikave; eksperimentimeve; mostra; kritereve rigorozisht shkencore; analizën në thellësi*, e të tjera të ngjashme (Berisha 1990: 2,3). Gjuha shkencore apo e sistemeve të shenjave, ka ardhur duke u dobësuar në diskurin politik të Berishës, sa më shumë ai i largohej profesionit të parë dhe i dorëzohej ‘thirrjes’ së re, politikës.

6.2 Çfarë interpreton Berisha me anë të gjuhëve që flet (konteksti i Fairclough)

Në kapitullin I jemi prezantuar me teorinë e Norman Fairclough e cila i mëshon faktit se teksti nuk mund të studiohet jashtë kontekstit. Ai i konsideron si të të paplota analizat e diskurit që nuk marrin parasysh kontekstin që vepron ndërkohë që njerëzit shkruajnë apo flasin. Me pak fjalë, tekstet apo gjuha e përdorur, nuk janë gjë tjetër veçse një *interpretim i kontekstit* apo rrethanave. Këtu ndeshen pikëpamjet e Fairclough me të Gee-së. Ky i fundit mendon se bota ndërtohet me anë të tekstit (gjuha që ndërton realitete) ndërkohë që Fairclough mendon se konteksti (bota) e ndërton gjuhën.

Është e rëndësishme të risjellim përkufizimin e Fairclough të **gjuhës që interpreton**: *me anë të tekstit ne mund të interpretojmë (shenjojmë, imagjinojmë etj) botën shoqërore në mënyra të ndryshme, por nëse shenjimët apo interpretimet tona kanë efektin e ndryshimt të saj, kjo varet nga faktorë të ndryshëm kontekstualë-përfshirë formën në të cilën është ndërkohë realiteti shoqëror; kush e interpreton atë, e me radhë.*

Duke qenë se theksi ideologjik (i djathtë ose jo) është thelbi i pyetjes kërkimore të këtij studimi, është me vend që të ndalemi në interpretimin që Berisha, me anë të tekstit të tij, u bën dy politikanëve të viteve ‘20-‘30 të shekullit të shkuar, Fan Nolit dhe Ahmet Zogut, për të kuptuar **trysninë e kontekstit** (lexo: edhe të formimit) **në ndërtimin e tekstit**, por edhe atë që mund të quhet spostim apo vetëpërkufizim ideologjik të tij.

Në debutimin si *njeri politik*, në një intervistë të gjatë për gazetën *Drita*, Sali Berisha përdor në dy raste terminologji qendrore pezhorative të historiografëve komunistë: *antizogizmi* dhe *serbomëdhenjtë*. Gjuha që interpreton kontekstin dhe rrjedhimisht edhe *agjentin social* (Berishën) ndërton dhe i mëshon një teze politike antizogiste.

Në vitin 1925, serbomëdhenjtë sollën në fuqi Zogun dhe oborrin e tij, para tij Esat Pashën. Në vitin 1941, ishin ata që nxorën Enver Hoxhën në krye të Partisë Komuniste dhe përcaktuan suitën e tij. Ishin po ata që urdhëruan grisjen e marrëveshjes së Mukjes e cila shënonte një kthesë në historinë e kombit shqiptar (Berisha 1990: 5,6).

6.3 Berisha vs Zogu: rasti i ideologjisë që ndërton gjuhën

Në vijim të logjikës së ‘gjuhës së interpreton’, dhe për një ‘ndershmëri shkencore’, paragrafi i mësipërm, i shkëputur nga intervista e Berishës, duhet hulumtuar edhe në pjesën përmbyllëse, ku flitet për marrëveshjen e Mukjes si ‘një kthesë në historinë kombëtare’. Dilema shkencore bëhet: cilit kontekst t’i besojmë, atij *historik* apo atij *politik*? Brenda të njëjtit paragraf, diskuri i Berishës zhvendoset nga *i majtë*

(antizogizmi) në të *djathtë* (pro marrëveshjes së Mukjes). Një interpretim i tretë mund të jetë ky: në të dy rastet ‘gjuha që interpreton’ Berishën e konstrukton atë si të *djathtë*, duke qenë se ai pozicionohet si antizogist në rastin e një ‘tradhëtie të pandehur kombëtare’, dhe bëhet pro Mukjes si potencial për bashkim kombëtar që ofron kjo ngjarje e historisë së Shqipërisë. Kombi, siç është artikuluar në kapitujt e këtij studimi, është kolonë qendrore e së *djathtës*, përkundër një internacionalizmi të së majtës.

Një habi, që është sa shkencore aq edhe humaniste, mund ta shtyjë pyetjen drejt një formulimi që kërkon më shumë se një shtresë të gjuha, e cila e interpreton kontekstin me anë të një teksti që përcillet nga një *agjent social*. Duke qenë se agjenti social në rastin e studimit tonë është *political personae*, pyetja mund të shtrohet: a mos Berisha e sulmon Zogun dhe trashëgiminë e tij si taktikë apo strategji politike?

...Për këtë qëllim ata kanë gjetur edhe diktatorin. Ai nuk mund të ishte më i kuq, por ekstremist i djathtë, e ai është Leka Zogu. Dhe këtë e them, jo sepse ata e sollën të jatin në fuqi dhe se kurora e tij mbretërore vetëm në Shqipërinë (e sotme), por siç pohon edhe vetë ai në intervistën e gjatë të botuar në gazetën “Kosova”, ishte dakord me Titon që atë ç’ka nuk realizuan Aleksandri dhe Ahmeti ta realizonin Josifi dhe Leka....Por serbomëdhenjtë e dinë se populli shqiptar në mënyrë demokratike nuk do ta aprovojë kurrë kurorën e përgjakur me gjakun e demokratëve të tij, L. Gurakuqit, A. Rustemit, B. Currit, H. Prishtina e I. Totos e dhjetëra e qindra të tjerëve (Berisha 1991: 1,5).

Michael Freedon (2003) argumenton bazuar në një shkollë mendimi sipas së cilës, si diskuri ashtu dhe ideologjia kanë të bëjnë kryesisht me idenë e pushtetit, kështu që ‘diskuret janë praktikat komunikative nëpërmjet të cilave ushtrohet ideologjia’. Në këtë prizëm vlen të hulumtohet edhe qëndrimi i mëlartëm i Sali Berishës, ai i lidhjeve apo idesë së pushtetit. Interpretimi që ai i bën me anë të gjuhës kësaj ideje, komunikohet nëpërmjet diskurit herë si qëndrim i *djathtë* dhe herë të tjera si populist, apo në zhvendosje nga aksi ideologjik ku mund të grupoheshin konservatorët/liberalët/të *djathtët*.

Në gjurmë të këtij qëndrimi, paradoksal për logjikën bazike, por të përligjur si nga teoritë e diskurit ashtu dhe nga ideja e pushtetit, kryetari i Partisë Demokratike, i cili e identifikon grupin e tij politik si të qendrës së djathtë (Berisha 1991: 1,6), ‘marton’ në një fjali të vetme dy akse diskursive të cilat duke ndjekur si tabelën e ideologjive të Heywood apo edhe dijet më minimale për dallimet ideologjike, janë, njëri i majtë e tjetri i djathtë:

...Njerëzit e thjeshtë dhe komunistët e ndershëm nuk luftuan e sakrifikuan për zëvendësimin e dinastisë së Zogollit të parë me atë të Hoxhës së parë, as për krijimin e Kastës së aristokracisë së kuqe, por për një Shqipëri të lirë, demokratike e të përparuar, si dhe për idealin e bashkimit kombëtar (Rilindja Demokratike 1992: 3).

Dinastitë, si forma të feudales, monarkikes, aristokratikes, do të grupoheshin, menjëherë, nga Edmund Burke e të tjerë-shih kapituj parardhës- te paradigma e së djathtës, si artikulacione të konservatorizmit apo traditës. E njëjta gjë vlen edhe për termat ‘aristokraci’ dhe ‘kastës’ të përdorur po aty. Por, retoricieni ndërron kurs duke u zhvendosur nga e majta dhe futur në terrene diskursive të djathta, kur flet për ‘idealën e bashkimit kombëtar’. Kombi, duke qenë një vlerë aksiologjike e ligjërimit të djathtë.

Nëse dy teoritë e analizës diskursive të ndjekura dhe të ballafaquara në këtë studim i mëshojnë, njëra idesë së ndërtimit të realitetit nga ligjërimi dhe tjetra asaj të përfaqësimit apo interpretimit të tij, çfarë është duke bërë Sali Berisha kur artikulon, edhe pse lider i së djathtës, me ethos diskursiv pro revolucionar? A është duke e përfaqësuar apo ndërtuar realitetin me anë të diskurit?

...Ata janë pasardhësit e vërtetë të paraprijësve të mendimit e të veprimit demokratik shqiptar: Fan Nolit, Hasan Prishtinës e Bajram Currit, Avni Rustemit, Luigj Gurakuqit, Ismet Totos etj. Revolucioni demokratik i 1924 i jep Shqipërisë nderin e të parit vend me ideale demokratike në Ballkan. Këto ideale nuk mund të vdisnin më, pavarësisht nga stuhitë monarkike, fashiste e komuniste, që ndoqën njëra – tjetrën në këtë vend (Berisha 1991: 1,6).

Një dallim që bën Freeden mes teorive të diskurit dhe analizës ideologjike është se ideologjia është një formë e diskurit, por nuk mund të përfshihet e tëra brenda idesë së tij. Gjithashtu, nëse diskurin mund ta ndash si ndërtues dhe përfaqësues/interpretues, ideologjia i bën të dyja (Freeden, 2003: 79). Berisha si retoricien, sipas logjikës së Freeden, kur artikulon diskur të majtë apo të djathtë, është duke ndërtuar por edhe duke interpretuar realitete. Se cilin realitet ai beson, nuk është qëllimi i këtij studimi.

6.4 Në gjurmët e Berishës retorik

Në kapitullin I kemi paraqitur një përkufizim të Richard Tøye-t mbi atë se çfarë do të ishte një studim retorik i një diskuri ideologjik: ato figura të stilit që përdoren për theksimin e gjërave tona të mira dhe gjërave të tyre të këqija, si për shembull hiperbolat, eufemizmat, e të tjerë. Për të kuptuar implikimet ideologjike që kanë figuracione të tilla, na duhet të shqyrtojmë kuptimet që ato formojnë.

Hiperbola, që rrjedh nga fjala greke ‘teprim’, është një figuracion qendror i diskurit të Berishës, ideologjik ose jo, ndërtues apo interpretues. Shembuj të hiperbolizmit sillen rreth të *madhes* dhe *madhështores*. Ligjërimi i Berishës i ka me teprim këto ‘teprime’ dhe më cytëset ndër to janë *ditë e madhe* (e historisë; e demokracisë; etj.); *besimi i madh*; *shpartallimi* (Berisha, 1992: 1) etj.

Kur ligjëron për ‘ne’ përkundër ‘të tjerëve’, Berisha shpesh inkuadron aty edhe ‘popullin’: njerëzit janë në anën tonë, në anën e së mirës. Kjo ‘ne’ e dyfishtë e bën diskurin ndërtues të një realiteti thuajse absolut, megjithatë kjo bëhet me qëllimin e ndërtimit të një shumice abstrakte, ‘dërrmuese’, nëse përdorim edhe ne një hiperbolë. Një shembull i tillë diskuri gjendet te *populli shqiptar pas afër një shekulli lufte dhe*

përpjekje titanike, për liri (Berisha, 1992: 2), apo *...ju e dinit mirë se do të mundnit mijëra vjet diktaturë* (Berisha, 1992: 1).

Implikimet ideologjike, sidomos në periudha përmbysëse si ajo e fillimviteve '90, 'i fryjnë' diskuret e protagonistëve. Gjuha reformatore ose revolucionare, sa është e re aq edhe bazohet apo sendërtohet në shtratin e sloganeve të vjetra. Revolucionarët francezë përmenden nga Toye si bartës të 'frymës së denoncimeve' dhe zëvendësimin e 'Rroftë mbreti!' me 'Rroftë Franca!'. Revolucionari komunist shqiptar zëvendësoi 'Rroftë Shqipëria!' të kohës së luftës ose para saj, me 'Rroftë partia!' ose 'Për ideal të partisë!'. Berisha e risolli komponenten 'Shqipëri' në fund të fjalimeve të protagonistëve politikë duke rimarrë nga kohët e traditës 'Rroftë Shqipëria!', në vend të 'Rroftë partia!'. Në fund të fjalimeve ai, pothuajse gjithmonë, nuk harronte një komponente tjetër, me implikime ideologjike qartësisht të djathta, *Zoti e bekoftë Shqipërinë!*.

Metaforat janë, gjithashtu, bartëse implikimesh dhe nënkuptimesh apo mbikuptimesh, sa ideologjike aq edhe kulturore. Në diskurin e Berishës mund të dallosh metaforat letrareske, ato që dekodojnë një bagazh të caktuar kulturor që retoricieni do të demonstrojë apo të përdorë për qëllime nxitëse apo joshëse, (apo thjesht për stil të fjalimit), dhe metaforat politike, disi më të rralla. Këto të fundit përfaqësohen nga: *politika e dyerve të hapura* (Rilindja Demokratike, 1992: 1); *bastioni i demokracisë* (Berisha, 1991: 1), e ndonjë tjetër.

Ndër metaforat e grupit të parë ndeshim të tilla: *dhjetorët e zinj ia shndërruat në dhjetorë të bardhë* (Berisha, 1992: 1); *nata e gjatë mbaroi dhe ka lindur një ditë e re* (Berisha 1992: 4); *në Shqipëri koha ndaloi* (Berisha, 1992: 1) ; *përpjekje titanike* (po aty); *mëngjes i bardhë* (Berisha 1992: 1); *idhtar i izolimit* (Drita 1990: 5,6); *buzëqeshje*

politike (Berisha 1991: 1), e plot të tjera që popullojnë atë që mund të quhet *pathosi berishian në retorikë*.

Impostimi apo predispozita retorike e Berishës është e rrafshët sa i takon mjeteve shprehëse të përdorura në ligjërimin modern apo postmodern, dhe që përmenden nga Richard Toye në studimin e tij për retorikën. Të tillë janë *metadiksuri* (kur folësi i tregon audiencës se çfarë po bën, çfarë do të bëjë apo çfarë ka bërë, si për shembull, siç e demonstrova më lart); *prolepsisi* (kur folësi i paraprin objeksionit të audiencës duke e përmendur vetë dhe duke reaguar apo mbajtur qëndrim ndaj tij-sigurisht në favor të tezës së vet); *paralipsisi* (tërheqja e vëmendjes rreth një problemi të rivalit politik me anë të një ‘shmangieje’ të llojit ‘nuk e e shoh të përshtatshme të flas për problemet me alkoolin të kundërshtarit tim...)

Çfarë mund të thuhet për retorikën si ‘fenomen fizik’ (terminologji e Toye) apo për praninë e elementëve joverbalë ndihmës për të ndërtuar apo interpretuar. Te Berisha duhen dalluar së pari vetitë fizike personale: ai kontrastonte thellë me udhëheqësit e deriatëhershëm të Partisë së Punës. Ishte shumë më i ri; shumë më energjik dhe *me një kokë plot me flokë dhe me një hijeshi të ashpër* (Lucas 2009: 78). E gjitha kjo krahasuar me udhëheqësit sklerotikë komunistë të cilët ishin bërë subjekt barcaletash i punëtorëve dhe rinisë shqiptare të kohës.

Dallimit me nomenklaturën komuniste, edhe kjo përmasë fizike e retorikës, i shërbente edhe veshja e ‘prijësve’ të rinj të opozitës ku Berisha spikaste në mënyrën e vet. Pardesytë bezhë të Berishës, Pashkos, Selamit e të tjerëve u bënë emblematike dhe shprehëse e një ‘qarkullimit të elitave’ lajmëruar përmes një elementi të veshjes. Kjo ishte ‘estetika e lidërshiptit të ri’, e cila ndihmoi në krijimin e një imazhi të ndryshëm që plotësonte retorikën deliberative: në politikë edhe veshja, ashtu si gjuha, tundon.

Sa i takon veshjes:

...është një sistem shenjimi që, duke shtënë në punë një lëndë shprehjeje jo verbale, i sjell komunikimit politik shenjues të tjerë. Duke vëzhguar mënyrën e veshjes së personave politikë italianë të viteve të fundit, Pazzato [1997a] ka vënë në dukje se si veshja merr pjesë në ndërtimin ose ripërcaktimin e identitetit të tyre të përgjithshëm, duke u ndërthurur me faktorë të tjerë, si jeta private, mosha, gjinia dhe, së fundmi, ideologjia. (Marrone 2008: 227).

Po t'i referohemi Keneth Burke, deliberativja është cilësi e retorikës së vjetër, por veshja apo stili është pikërisht ajo që retorika moderne ka marrë nga e vjetra. Si çelës të retorikës moderne Burke sheh *identifikimin*, pra njëfarë territori të përbashkët, në kuptimin e diskurit.

PERFUNDIME

Një analizë cilësore dhe sasiore e diskurit të Sali Berishës gjatë periudhës 1990-1992 zbulon disa prirje kryesore dhe disa të tjera dytësore, apo më të zbehta, sa i përket përdorimit të ‘gjuhëve’ të specifikuara këtu si *gjuhë e re*, *gjuhë e vjetër*, *gjuhë teknike* dhe *gjuhë ideologjike*:

1. Retorika e përdorur nga Berisha që herët në komunikimin politik, përbëhet nga një fashë ligjërimi që mund të quhet ‘gjuhë e re’, e cila dallohet nga përpjekja për të futur në qarkullim terma të rinj të komunikimit duke krijuar kështu një *glosar të demokratikes*. Kjo zbulon, së pari, një vetëdije intelektuale dhe, së dyti, një përpjekje që me anë të tekstit të ndërtohet konteksti.
2. Kjo retorikë e re, e përmendur në pikën 1, nuk përjashton gjurmë të *gjuhës së vjetër*, të cilat janë të pranishme në diskurin e Berishës. Këtu bëjnë pjesë terma të zhargonit komunist të diktuar nga propaganda e kohës, fjalë gjenerike me kuptim të vdekur, e të tjera. Në këtë rast është konteksti që e shkruan tekstin.
3. Gjuha ideologjike e Berishës vjen e forcohet me kalimin e muajve: ajo kalon nga *neutraliteti ideologjik në theks ideologjik*.
4. Gjuha teknike apo shkencore e Berishës shfaqet në shkrimin e botuar në gazetën ‘Bashkimi’, në fillimet e protagonizmit politik të tij, për t’u zhdukur më pas. Mjeku ia lë vendin politikanit, dhe ky shndërrim merr me vete edhe gjuhën.

Sa i takon një analize diskuri që mundohet të identifikojë Berishën dhe ligjërimin e tij si ndikues apo si përçues, duke përdorur tezat e James Paul Gee dhe Norman Fairclough, këto janë disa përfundime:

1. Berisha e përdor komunikimin për të përçuar idetë, qëndrimet, vizonet apo emocionet e tij sociale, politike dhe kulturore. Me anë të kësaj, të tekstit të folur apo të shkruar, ai bëhet përcjellës i identitetit të vet në identitete të tjera me qëllim konstruksionin e një konteksti të ri. Për të përdorur termat e James Paul Gee ai fut në punë *gjuhën që ndërton*, pra ai *bën gjëra* me anë të gjuhës. Ndër *gjërat që bën* me anë të ligjërit, mund të përmendim:

a-paralajmëron lidërsipin e intelektualit (inteligentsias) duke e nxjerrë atë nga ‘vendi i tretë’ ku e kishte degdisur aparati komunist i propagandës dhe autoritetit sipas renditjes: -klasa punëtore; -fshatarësia kooperativiste dhe; - inteligentsia.

b- identifikon shpirtëroren (Zotin) si përmasë të re të diskurit kombëtar e politik duke kundërshtuar një traditë të gjatë ateizmi dhe linçimi të përmasës së besimit;

c- konturon lirinë: e sipërmarrjes; e besimit; e lëvizjes; e fjalës, e me radhë, si të qenësishme për konstruktin e diskurit politik dhe të një antroplogjie të re kombëtare, sociale, politike e kulturore;

d- paraqet Kombin apo çështjen kombëtare si prerogativë të ndryshimit dhe e përcakton politikën e re si përçuese edhe të kësaj variable të fshehur deri atëherë pas internacionalizmit komunist.

2. Diskuri i Berishës, përveçse i natyrës ndërtuese është edhe i formës *interpretative*. Ai e përdor *gjuhën që interpreton* për t'u pozicionuar politikisht, por edhe për të paraqitur botën (e vet apo atë të kontekstit social e politik). Prej kësaj mënyre të përdorimit të gjuhës dallohen disa shenja apo raste:

a-kujdesi për të mos sulmuar Partinë e Punës, Enver Hoxhën dhe Ramiz Alinë në fillimet e formulimeve të tij politike;

b-evidentimi i një *rreziku të së djathtës ekstreme*, po aq kërcënues (sipas Berishës) sa dhe komunizmi konservator;

c- përvetësimi i retorikës ndërkombëtare të kohës ku sundonte *antikomunizmi* dhe përdorimi i saj në kontaktet me të huajt (në ndryshim nga retorika e brendshme që u vu në dukje në pikat më lart, gjë që ndryshoi me kalimin e kohës).

d-identifikimi me *fannolizmin* dhe jo me *zogizmin*, duke përzgjedhur një eksponent të së majtës me qëllim interpretimin e një nënshtrese 'popullore' që e shihte Zogun me lentet e propagandës komuniste dhe Nolin si një vjershëtor, liberal, njeri të kulturës, etj.

Pas këtyre *gjurmëve retorike* të shfaqura gjatë këtij studimi dhe të përmbledhura në Përfundimet, mund të thuhet se ligjërimi (diskuri) i Berishës është *i përzier*. Pra, i përket një tipologjie që mund të konsiderohet si *mixed discourse* apo *mixed ideology*. Kur flet për *lirinë, kombin, besimin* (Zotin), *traditat, familjen*, Berisha ligjëron apo shfaqet si i djathtë. Kur flet për *pronën* (ndarjen e saj), *trashëgiminë politike* (Zogu vs Noli), apo kur *identifikon partitë tradicionale* si të esktrimit të djathtë, etj., ai i afrohet ligjërimin të majtë. Mund të debatohet për faktin nëse Berisha e përdor ligjërimin në favor të interesave politike, dhe ato nuk janë domosdoshmërisht në linjë me konstruktin e njëmendtë ideologjik të tij, por ky nuk është qëllimi i këtij studimi. Në finale, pavarësisht një zhbalance, ligjërimi politik i Sali Berishës mbetet *kryesisht i djathtë*.

BIBLIOGRAFIA

Botime dhe monografi shkencore

1. Glee, J.P. (2010) *An introduction to discourse analysis-Theory and Method*. Routledge: New York & London.
2. Gebremedhin, T. G & Tweeten, L. G. (1994). *Research methods and communication in the social Sciences*. Praeger: Westport.
3. Fairclough, N. (2003) *Analysing Discourse*. Routledge: London & New York.
4. Gupta, S. (2007) *Social Constructionist identity politics and literary studies*. Palgrave Macmillan: New York.
5. Bobbio, N. (1996) *E djathta dhe e majta: gjykime dhe kuptime të një dallese politike*. Botimet IDK: Tiranë.
6. Nisbet, R. (2002) *Konservatorizmi*. Botimet IDK: Tiranë.
7. Archer, M. (1995) *Realist Social Theory*. Cambridge University Press: Cambridge.
8. Thompson, J. (1990) *Ideology and modern Culture*. Stanford University Press: Stanford- CA.
9. Budini, B. (2009) *Edi Rama politikani pop(ulist) star*. UETPress: Tiranë.
10. Eco, U. (2006) *Si shkruhet një punim diploma (shkencat shoqërore)*. Dituria: Tiranë.
11. Scruton, R. (2016) *Si të jesh i djathtë*. UETPress: Tiranë.
12. Toye, R. (2013) *Rhetoric-a very short introduction*. Oxford University Press: Oxford.
13. Weaver, R. (1985) *Language is sermonic*. LSU Press: New Orleans.
14. Steinmann, M. (editor). (1967) *Rhetoric-Old and New*. Scribners: New York.
15. Orwell, G. (2013) *Politics and the English Language*. Penguin Modern Classics: London.
16. Finlayson, A.; Martin, J. (2008) *British Politics*. Palgrave Macmillan: London.

17. Barthes, R. (1977) *Image-Music-Text*. Fontana Press: London.
18. Schäffner, C. (1997) *Analysing Political Speeches*. Multilingual Matters: Tonawanda.
19. Wodak, R. (editor). (1989) *Language, Poëer and Ideology-Studies in political Discourse*. John Benjamin Publishing Company: Amsterdam/Philadelphia.
20. Huntington, S. (2015) *Vala e tretë*. AIIS: Tiranë.
21. Burke, E. (1981) *The Writings and speeches of Edmund Burke*. Oxford University Press: Oxford.
22. Thatcher, M. (1993) *The Downing street years*. Harper Press: London.
23. Roberts, J.M. (1999) *The Twentieth Century*. Viking: New York.
24. Brown, A. (2009) *The rise and fall of communism*. Harper Collins: New York.
25. Laker, U. (2003) *Europa në kohën tonë (1945-1992)*. Dituria: Tiranë.
26. Heywood, A. (2012) *Political Ideologies*. Palgrave Macmillan: New York.
27. Ash, T. G. (2002) *The polish revolution: Solidarity*. Yale University Press: New Haven.
28. Della Rocca, R. M. (2000) *Shqipëria rrënjët e krizës*. ShLK: Tiranë.
29. Pandolfi, M. (2002) *Myths and new forms of governance in contemporary Albania Albanian (Identity-Myth and History -editors Stephanie Schandner-Sievers and Bernd J. Fischer)*. Indiana University Press: Indianapolis.
30. Mustafaj, B. (1999) *Midis krimeve dhe mirazheve*. Onufri: Tiranë.
31. Abrahams, F. (2015) *Shqipëria e re*. Botimet Dudaj: Tiranë.
32. Biberaj, E. (2011) *Shqipëria në tranzicion (Botim i dytë i plotësuar)*. AIIS: Tiranë.
33. Alia, R. (2010) *Jeta ime-Kujtime*. Botimet Toena: Tiranë.
34. Pëllumbi, S. (2015) *Përmbysja e komunizmit*. UETPress: Tiranë.
35. Ngjela, S. (2013) *Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare (1991-1996)*. UETPress: Tiranë.
36. Gilbert, M. (2001) *History of the twentieth century*. Harpers Collins: New York.

37. Shanse, E.; Zh. P. (2000) *Shqipëria ose logjika e dëshpërimit*. ShB Elena Gjika: Tiranë.
38. Lucas, P. (2009) *Rumpalla*. Bota shqiptare: Tiranë.
39. Marrone, G. (2009) *Trupat shoqërorë-proceset komunikuese dhe semiotika e tekstit*. Botimet Dudaj: Tiranë.
40. Freedon, M. (2003) *Ideology-a very short introduction*. Oxford University Press: New York.
41. Laponce, J. (1981) *Left and right-the topography of political perceptions*. University of Toronto Press: Toronto.
42. Samara, M. (2008) *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*: Akademia e Shkencave të Shqipërisë: Tiranë
43. Lilleker, D. (2006) *Key Concepts of political communication*: Sage Publications: Los Angeles
44. Vehbiu, A. (2007) *Shqipja totalitare-Tipare të ligjërit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990*. Çabej: Tiranë.

Artikuj shkencorë

45. W. K. Wimsatt Jr; M. C. Beardsley (1946) *The Intentional Fallacy*. The Sewanee Review, Vol. 54, No. 3.
46. Stewart, G. (2016) *The great social-political divide: Left or right*. Palestine Chronicle, January 25.
47. Svec, M. (1988) *The Prague Spring: 20 Years Later*. Foreign Affairs: Summer 1988.
48. Garton Ash, T. (1990) *Eastern Europe: The Year of Truth*. New York Review of Books. February 15.
49. Bujak, Z. (1989) *Solidarity as a Social Movement*. Political Science Quarterly (104), Spring.

Artikuj shtypi

50. *Rilindja Demokratike* (1991) Fjala e mbajtur nga Prof. Dr. Sali Berisha në seancën e Komisionit të Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropian të Kongresit Amerikan, 29 maj.
51. *Rilindja Demokratike* (1992) Thirrje e kryetarit të Partisë Demokratike Prof. Dr. Sali Berisha, 21 mars.
52. *Tribuna Demokratike*, (1992) Ju që shembët diktaturën do të ndërtoni demokracinë, 19 mars.
53. *Rilindja Demokratike* (1991) Intervistë me kryetarin e PD-së Prof. Dr. Sali Berisha, 24 korrik.
54. *Rilindja Demokratike* (1991) Kjo qeveri meriton të mbështetet, 15 qershor.
55. *Tribuna Demokratike* (1992) Demokraci dhe paqe, paqe dhe demokraci-I humbur do të jetë vetëm komunizmi, 21 mars.
56. *Rilindja Demokratike* (1991) Aleancë e rrezikshme antishqiptare, 17 gusht.
57. *Bashkimi* (1990) Demokracia dhe humanizmi – binom i pandarë, 17 shtator.
58. *Drita* (1990) Intelktuali përballë detyrave të kohës, 20 maj.
59. *Rilindja Demokratike* (1991) Demokracia do të fitojë pa dhimbje-Raport i Komisionit Drejtues të PD, 25 shtator.
60. *Rilindja Demokratike* (1992) Platformë elektorale e Partisë Demokratike, 22 shkurt.
61. *Tribuna demokratike* (1992) Prof. Dr. Sali Berisha Presidenti i parë i Shqipërisë demokratike, 10 prill.
62. *Rilindja Demokratike* (1992) Shqipëria i tregoi botës se ishte një pjesë e pandarë e familjes së kombeve demokratike, 24 mars.
63. *Rilindja Demokratike* (1991) Pranvera e demokracisë po vjen, 30 mars.
64. *Observer* (1992) Appointment in Tirana, March 1.
65. *Mapo* (2014) Kukullat e dhjetorit, 11 dhjetor.
66. *Mapo* (2015) Shqipëria e re e Fred Abrahams. Më afër së vërtetës, 18 dhjetor.
67. *Shqip* (2013) Histori fiktive, 19 tetor.

68. *Zëri i Popullit* (1992) Mos e dëgjoni atë zë...është zëri i parçarjes, 11 mars.

Website

69. *Peizazhetëfjalës* (2013) Katovica e zbardhur, 19 tetor. Marrë nga:
<https://peizazhe.com/2013/10/19/katovica-e-zbardhur/>

70. The World Bank (1991) GDP per capita. Marrë nga:
<http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?page=4>

Të tjera

71. *National Democratic Institute* (2013) Political Parties and democracy in theoretical and Practical Perspectives. Washington, DC: National Democratic Institute.

72. *Fondacioni për Liri Ekonomike* (2015) Fjala e Donald Frost në Rrethin Liberal të Dardhës, 9 tetor.

73. *Socialist Institute for European Studies* (1991) *The left in Eastern Europe-a report on the post-Communist political landscape*, Brussels.

74. Sheigal E. I. (2000) *Semiotics of political discourse*. (Diss. doctor.phil.sciences) Volgograd.